



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Dytë, Master Profesional
në “Komunikim Marketingu”
“Kolegji Universitar “Bedër””**

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Dr. Arben Muka


Dr. Diana Kalaja

Korrik 2021

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Për Programin e studimit Master Profesional në "Komunikim Marketingu"

Nr.		
1	IAL aplikues:	Kolegji Universitar "Bedër"
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Shkencave të Komunikimit (Fakulteti i Shkencave Humane dhe Drejtësisë)
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master Profesional në "Komunikim Marketingu"
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMASR Nr. 351, datë 17.06.2019
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Urdhëri i regjistrimit të Formës së diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit pararendës:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli II
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	1 vit akademik
10	Kreditet në total (ECTS):	60 ECTS
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	Programi nuk ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera
13.1	• Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
13.2	• Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
14	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7
15	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	6 PAE / 1 PAK (86% PAE / 14% PAK)
16	Numri i studentëve:	19 studentë
17	Komente / të tjera:	



TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIN E STUDIMIT NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i studimit të ciklit të dytë Master Profesional në “Komunikim Marketingu” është programi më i ri në KU Bedër. Ai ka nisur këtë vit akademik (2020-2021) dhe shtrihet në dy semestra nga 16 javë secili. Ngarkesa e programit është në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, si dhe bazuar në Kartën e Bolonjës. Ngarkesa për 18 studentët që vijojnë ta ndjekin aktualisht programin ngarkesa është në total 1500 orë, me 60 kredite ECTS, 1 kredit ECTS është për 25 orë. Ndarja e ECTS-ve është në mënyrë të balancuar për të dy semestrat, si një shpërndarje efektive për ngarkesën e një studenti të kursit, që nga fillimi dhe deri në finalizimin e kryerjes së tezës së diplomimit për Master Profesional në “Komunikim Marketingu”.

Ideja për ndërtimin e këtij programi studimor të ciklit të dytë ka nisur prej vitit 2017 nga njësia bazë dhe ka qenë një proces i bazuar në përvojat që ka vetë KU “Bedër” me studimin e kërkimin shkencor, por dhe reflektim i përvojës së institucioneve të tjera të arsimit të lartë në Shqipëri, si edhe nga vendet e tjera. Shënjestra ka qenë dhe mbetet për kornizën e një programi master që të jetë tërheqës për studentët që kryesisht vijnë nga shkencat e komunikimit, nga studimet në ciklin e parë, por dhe nga degë e profile të ngjashme, për t’i ofruar ndjekësit të programit njohuri teorike të konsoliduara të harmonizuara me shprehje praktike, që ata të jenë të gatshëm për tregun në këtë fushë. Ata studentë që janë edhe në punë ndërkohë që ndjekin MP “Komunikim Marketingu” shtyjnë më tej dhe më thellë aftësimin e tyre, kurse për ata që nuk janë të sistemuar e shohin si një premisë për punësimin sa më të shpejtë.

Zhvillimi i kurikulës, ku përfshihen lëndë që janë të detyrueshme, si dhe nga ana tjetër lëndë që janë me zgjedhje për studentët – kjo krijon një kombinim për njohuritë dhe shprehitë e studentit që frekuenton programin, për formimin e tij me dije dhe njohuri të bollshme në fushën e komunikimit e marketingut, si dhe me aftësimin profesional për t’ju përgjigjur kërkesave që ka tregu i punës. Këtë bagazh teorik e praktik, studenti e merr nga zhvillimi i leksioneve e seminareve, nga kryerja e detyrave dhe temave të kursit, nga periudha e praktikës, si dhe nga përfshirja në aktivitete me karakter studimor e shkencor.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e nisi punën që në qershor 2021, me takimin e përbashkët dhe përcaktimin e detyrave kryesore që do të realizoheshin gjatë procesit të vlerësimit. Në bashkërendim midis dy ekspertëve të jashtëm të vlerësimit, ekspertës dhe stafit të ASCAL dhe me dakordësinë e KU BEDER u përcaktuan edhe datat e vizitave/takimeve pranë institucionit. Vizita u realizua fizikisht në datë 16 Qershor 2021, sipas një axhende të dakordësuar.

GVJ u njoh me të gjithë dokumentacionin e dorëzuar nga institucioni në proces akreditimi përmes platformës dhe kredencialet që secili nga vlerësuesit e jashtëm ka në www.ascal.al

Gjatë dy ditëve të takimeve online, u zhvilluan takime me Dekanin e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë, me Përgjegjësën e Departamentit të Shkencave të Komunikimit, me Grupin e Vlerësimit të Brendshëm, Stafin e programit në proces akreditimi, Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyrën e karrierës, të marrëdhënies me studentët dhe marrëdhënies me jashtë, etj. Po ashtu u vizituan edhe ambientet e reja ku është vendosur KU BEDER.

Gjatë takimeve nga grupi i vlerësimit të jashtëm u kërkua plotësimi me disa materiale të nevojshme për vlerësimin përfundimtar të programit të studimit. Materialet e kërkuara u plotësuan dhe u vendosën në platformën e ASCAL. Gjatë gjithë këtij procesi vlerësimi ka pasur një bashkëpunim shumë korrekt dhe mirëkuptues midis grupit të vlerësimit të jashtëm dhe stafit të KU BEDER.

Koordinator teknik nga ASCAL, në këtë vlerësim ka marrë pjesë ME. Renata Qatipi.

Më datë 22.07.2021, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 48/8 Prot., datë 22.07.2021 “Njoftim për dërgimin e Draft - Raportit të Vlerësimit të Jashtëm”, Kolegji Universitar “BEDËR” është njohur me Draft-Raportin e vlerësimit të jashtëm.

Me datë 27.07.2021, Kolegji Universitar “BEDËR” përcjell përmes sistemit AMS dhe zyrtarisht, me shkresë Nr. 227/1 Prot., datë 27.07.2021, “Komente në lidhje me Draft-RVJ të programit të studimit Master Profesional në “Komunikim marketingu”, përgjigjen për Draft-Raportin. Në këtë dokument institucioni nuk ka komente për Draft Raportin e Vlerësimit të jashtëm.

Draft Raporti kthehet në Raport përfundimtar.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në “Komunikim Marketingu”

I. OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi të ciklit të dytë “Master profesional” në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare.	Kolegji Universitar BEDER, në respekt të rregulloreve të tij të brendshme, misionit të tij për t’u dhënë studentëve një edukim cilësor, ofron programe studimi që përshtaten mjaft mirë me interesat kombëtare dhe zhvillimin e vendit.
Kriteri 2 Programet e studimit synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Siç theksohet edhe në Planin Strategjik Institucional, “ <i>Vizioni i Kolegjit Universitar “Bedër” synon që të jetë një institucion elitari i arsimit të lartë në vend dhe rajon për të qenë alternativa e parë e edukimit dhe kërkimit shkencor për shqiptarët, kudo që ndodhen.</i> ”
Kriteri 3 Programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	<p><i>Kolegji Universitar “Bedër” synon të shndërrohet në një institucion arsimor me karakter ndërkombëtar, duke ofruar mundësi studimi jo vetëm për shqiptarët, por edhe për të huajt, duke kontribuar në promovimin e Shqipërisë si një qendër rajonale e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor.”</i></p> <p>Programi i studimit Master Profesional në “Komunikim Marketingu” synon ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike dhe kulturore kombëtare. Kjo është e shprehur në rregulloret e brendshme të programit të studimit si edhe në statutin e institucionit dhe organizimin e departamenteve, fakulteteve.</p> <p>Këto citime të shkëputura nga dokumentet themelore të KU Beder përcaktojnë më së miri se ai është një faktor ndikues në krijimin e profesionistëve në industritë e ndryshme, duke përfshirë këtu edhe atë mediatikë dhe disiplinat e artit. Programi është hartuar në përputhje qëllimet dhe misionin e KU “Bedër”. Rregullorja e programit të studimit specifikon që programi përgatit specialistë, duke iu përshtatur kuadrin ligjor në fuqi për arsimin e lartë, nevojat sociale të vendit dhe ruajtjen e vlerave kulturore.</p> <p>Evidenca nr. 2 Statuti i Kolegjit Universitar Bedër Evidenca nr. 3 Rregullorja mbi organizimin akademik Evidenca nr. 6 Plani strategjik Institucional i KU “Bedër” 2018-2023 Evidenca nr. 7 Rregullorja e programit të studimit “Master profesional” në “Komunikim Marketingu”</p>
Kriteri 4 Programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.	<p>Zhvillimi ekonomik dhe social i vendit dhe nevoja për hapjen e këtij programi janë të studiuara edhe nga analiza që universiteti i ka bërë tregut të punës. Gjatë studimit janë evidentuar me të dhëna sasiore nevojat e tregut të punës, si edhe tendencat e zhvillimit të këtij tregu në rang vendi.</p> <p>Programi i studimit Master Profesional në “Komunikim Marketingu” ka targetuar atë pjesë të rëndësishme të rinisë që synon të përqafojë zhvillimet e</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

5

	<p>reja në ekonomi dhe në epokën e digjitalizimit. Marketingu janë ndër fushat e rëndësishme të komunikimit dhe ka marrë një rëndësi të veçantë në zhvillimet e reja ekonomike të vendit në epokën dixhitale.</p> <p>Ky program studimi është i lidhur edhe me faktin se vendi ka nevojë për specialistë marketingu edhe në kushtet e fushatave për zgjedhjet politike, si për pushtetin qendror dhe lokal, ashtu edhe sepse ai përballet me zhvillimet e reja edhe në rang kombëtar dhe ndërkombëtar ku komunikimi, veçanërisht ai online, është mjaft i rëndësishëm.</p> <p>Hapja e programit të studimit është e lidhur edhe me indikacionet e marra nga Strategjia kombëtare e punësimit dhe aftësisë 2019-2022.</p> <p>Evidenca nr. 2 Statuti i Kolegjit Universitar Bedër Evidenca nr. 7 Rregullorja e programit të studimit “Master professional” në “Komunikim Marketingu” Evidenca 26: Evidenca nr. 8 Strategjia kombëtare për punësim dhe aftësi 2019-2022</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.</p>	<p>Në dokumentin “<i>Plan Strategjik Institucional 2018-2023</i>” të hartuar nga KU Bedër jepen objektivat strategjike të tij si institucion dhe mënyrën e zbatimit të tyre. Arsimi cilësor dhe një zhvillim i qëndrueshëm në arsim, duke patur parasysh gjithnjë edhe komponentin e përgjegjshmërisë sociale, janë ndër objektivat kryesore të këtij programi.</p>
<p>Kriteri 2. Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.</p>	<p>Neni 4 i Statutit të KU Bedër, përcakton se “<i>Kolegji Universitar Jopublik “Bedër” ka për mision përgatitjen e individëve të kualifikuar, nëpërmjet një filozofie arsimimi që ka në thelb vlerat universale, si dhe mbështetja e kërkimit shkencor, me qëllim vënien në jetë të ideve dhe projekteve që ndikojnë në përmirësimin e jetës së njeriut dhe mbarë shoqërisë</i>”</p> <p>Gjithashtu përcaktohet se “<i>Traditat më të mira morale, kulturore, historike, arsimore dhe shkencore të vendit, janë baza e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, të ndërthurura me standardet dhe arritjet më të mira, ndërkombëtare në përgjithësi dhe ato evropiane në veçanti.</i>”</p> <p>Programi i studimit Master Profesional në “Komunikim Marketingu” në respekt të Statutit dhe Planit Strategjik të KU Bedër është në përputhje të plotë me interesat kombëtare duke synuar përgatitjen e specialistëve në fushën e marrëdhënieve me publikun dhe komunikimit marketing. Programi i studimit, i ndërtuar nga Departamenti të Shkencave të Komunikimit është në përputhje me qëllimet dhe misionin e KU Bedër dhe me misionin e tij. Edhe misioni i vetë Departamentit është “... përgatitja e individëve të kualifikuar në fushën e</p>

	komunikimit, të marrëdhënieve publike dhe komunikimit të marketingut, të marrëdhënieve me median dhe publikun, si edhe në fusha të ngjashme me to..."						
Kriteri 3. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.	<p>Në zbatim të ligjit për arsimin e lartë në vend institucioni ka hartuar rregulloren e tij themelore, statutin, organigramën dhe më pas edhe rregulloret zbatuese për secilin nga programet e studimeve.</p> <p>Edhe programi i studimit Master Profesional në "Komunikim Marketingu" është hartuar dhe realizohet në zbatim të këtyre akteve rregullatore të KU BEDER. Programi është pjesë e departament të Shkencave të komunikimit dhe Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë. Sipas rregullores së programit "Programi "Master Profesional në Komunikimi Marketingu", ofron përgatitje akademike të përparuar në fushën e Komunikimit të Marketingut, marrëdhënieve me publikun, reklamës, medias, imazhit të organizatave, marrëdhëniet e të punësuarve dhe fushatave publike etj.</p> <p><i>Të diplomuarit e këtij program studimi do të kenë përparësi në fushën e komunikimit të marketingut, reklamës, marrëdhënieve publike dhe median, si dhe do të kenë akoma më shumë përparësi në shkallët e karrierës drejt lidershit në këtë fushë, komunikimit të korporatave dhe menaxhimin e ngjarjeve."</i></p> <p>Të gjitha kompetencat profesionale që fitohen nga programi, përmbajtja, struktura, emërtimi, organizimi këtij programi studimi janë në përputhje me fushat dhe drejtimit akademike të institucionit.</p>						
Kriteri 4. Programet e studimit të ciklit të dytë "Master profesional" hartohen e zhvillohen në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe trendet globale të zhvillimit.	<p>Në hartimin e programit të studimit janë marrë në konsideratë strategjitë zhvillimore jo vetëm të institucionit, por edhe strategjitë kombëtare dhe tendencat rajonale të zhvillimit. KU Beder ka ndërtuar programin duke respektuar kërkesat e tregut të punës pas studimeve dhe përditësimeve periodike/frekuente që i bën këtij tregu. Programi studimor, ndjek principet e kartës së Bolonjës, dhe kuadrin rregullatore të ndërtuar nga Ministria e Arsimit.</p> <p>Evidenca 02: Statuti i Kolegjit Universitar Bedër Evidenca 03: Rregullorja themelore e KU Bedër Evidenca 06: Plani strategjik Institucional i KU Bedër 2018-2023 Evidenca 07: Rregullorja e programit të studimit "Master profesional" në "Komunikim Marketingu" Evidenca 26: Evidenca nr. 8 Strategjia kombëtare për punësim dhe aftësi 2019-2022</p>						
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

Standardi I.3

Programet e studimit "Master profesional" synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në përputhje me nevojat dhe kërkesat e tij.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimit "Master profesional" kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto	KU BEDER ka aprovuar rregulloren e programit të studimit Master Profesional në "Komunikim Marketingu". Rregullorja përcakton synimin e këtij programi që "...ofron përgatitje akademike të përparuar në fushën e Komunikimit të Marketingut, marrëdhënieve me publikun, reklamës, medias,

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

7

<p>programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale, që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato dhe me kërkesat e tregut të punës.</p>	<p><i>imazhit të organizatave, marrëdhëniet e të punësuarve dhe fushatave publike...</i>” të sigurojë përgatitje cilësore të studenteve.</p> <p>Bazuar në kurikulën e këtij programi, synimet e tij janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ✓ Të përgatisë të diplomuar të suksesshëm, me aftësi të thella profesionale, cilësi të larta morale dhe shoqërore për t'u kthyer në modele frymëzues dhe motivues për shoqërinë; ✓ Të përgatisë njerëz të aftë për të punuar në media dhe në sektorin e marketingut; ✓ Të përgatisë profesionistë të motivuar për të punuar në të gjitha zonat e vendit dhe më gjerë në fushën e komunikimit të marketingut; ✓ Të zhvillojë aftësitë e të menduarit kritik, të komunikuarit saktë dhe me kuptim të qartë të dimensioneve etike në profesion; ✓ Të përgatisë ekspertë të kërkuar nga tregu i punës; ✓ Të mundësojë një kualifikim shkencor dhe profesional të profesionistëve të rinj me njohuritë e thelluara të marketingut në tërësi. <p>Bazuar në syllabuset e lëndëve dhe tërësinë e programit lëndor, programi i studimit Master Profesional në “Komunikim Marketingu” krijon mundësinë e realizimit të objektivave të mësipërm. GVJ diskutoi edhe me pedagogët dhe gjerësisht me studentët, duke parë aftësitë dhe përgatitjen e studentëve për tregun e punës, kualifikimin profesional në fushën e marketingut dhe të menduarin e thelluar dhe analizues.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.</p>	<p>KU BEDER ka kryer një studim në tregun vendas të punës duke identifikuar se cilat janë potencialet që ka tregu për studentet e diplomuar në këtë program studimi. Studimi është gjithëpërfshirës dhe jep informacione statistikore si edhe vlerësime cilësore për tregun e marketimit dhe komunikimit. Në studim jepet statistika për:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Sektorin e reklamës dhe marketimit; ▪ Sektorin e marrëdhënieve me publikun ▪ Marketimin dixhital ▪ Tregtinë online <p>Studimi ka edhe një listë të zgjeruar të transmetuesve dhe prodhuesve audiovizivë si edhe portaleve online.</p> <p>KU Beder e ka ndërtuar në mënyrë ciklike studimin mbi tregun e punës. Departamenti i Shkencave të Komunikimit, ka pasur një studim mbi tregun e punës që në fillimet e tij, por sikurse u shprehen në takimin e GVJ me Dekanin e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë, ata e kane përditësuar në mënyrë të vazhdueshme studimin e tregut të punës, me elementë të rinj.</p> <p>Zyra e karrierës dhe e marrëdhënieve me studentët (si pjesë e Zyrës së Dekanit të studentëve) mban një dokumentacion mbi mundësinë e punësimit të</p>

	<p>studentëve pas mbarimit të programit të studimit dhe drejtimet që merr karriera e tyre profesionale.</p> <p>Nga takimi i GVJ me drejtuesit e departamentit të Shkencave të Komunikimit në KU Bedër, u vërejt dëshira e tyre për të zgjeruar pjesëmarrjen e studentëve në këtë program, nga trevat shqipfolëse jashtë kufijve. Departamenti duhet ta shoqërojë këtë me një pasqyrim të peizazhit të mediave në këto treva.</p>
<p>Kriteri 3. Objektivat formues struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxëniet garantojnë përfundimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që i përgjigjen nevojave të tregut dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>Bazuar në rregulloren e programit, si edhe nga diskutimi me studentë pjesëmarrës në program, gjatë vizitës së GVJ në institucion, kuptohet gjithanshmëria e programit që i përgatit ata për tregun e punës. Objektivat e përgjithshme të programit të studimit janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ✓ <i>T'u japë të diplomuarve arsimimin e duhur dhe trajnimin e thelluar në fushën e komunikimit të marketingut;</i> ✓ <i>T'u krijojë atyre një vizion të ri për komunikimin e marketingut në Shqipëri, në përputhje me përvojën e krijuar të plotësuar me konceptet evropiane;</i> ✓ <i>Të përpiqet për të realizuar një status të ri të profesionisti të reklamës dhe marrëdhënieve me publikun në kushtet dhe zhvillimet e reja ekonomiko-politiko-shoqërore si dhe transformimet teknologjike që janë krijuar në ditët e sotme;</i> ✓ <i>Programi do të shtrojë alternativa konkrete për zhvillimin e marketingut, reklamës, marrëdhënieve me publikun si dhe metodave të tjera të komunikimit të marketingut, dhe të japë ndihmesën e vet për krijimin e një elite të re në këtë fushë.</i> <p>Lista e lëndëve të formimit karakterizues dhe atyre me zgjedhje, ka gërshetimin e duhur midis njohurive praktike me ato teorike dhe kompetencën profesionale. Kjo i ndihmon studentët në gjetjen e hapësirave për të bërë një hyrje sa më të lehtë në tregun e punës.</p> <p>Edhe zhvillimi i praktikave profesionale si pjesë e kurikulës mësimore ndikon për një përshtatje sa më të mirë me tregun e punës.</p> <p>Evidenca nr. 7 Rregullorja e programit të studimit “Master professional” në “Komunikim Marketingu” Evidenca 11: Studim tregu i zhvilluar nga Departamenti i Shkencave të Komunikimit Evidenca 53: Syllabuset e lëndëve të programit</p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimeve përafrohen me programe studimi të ngjashme të ofruar nga institucione ndërkombëtare me qëllim lehtësimin e transferimit të studimeve apo punësimin e studentëve në të ardhmen në tregun ndërkombëtar.</p>	<p>Ndërtimi i programit të studimit është bazuar në “Kartën e Bolonjës”, rregulloret dhe legjislacionin në fuqi të Ministrisë së Arsimit, si edhe është mbështetur në projektet kërkimore ndëruniversitare që janë zhvilluar në kuadër të qendrave kërkimore. Përmes programeve të shkëmbimit midis universiteteve janë ofruar informacioni është synuar sjellja e praktikave dhe modeleve më të mira në zhvillimin e programeve studimore.</p> <p>Departamenti ka përvojë 10 vjeçare dhe ka hartuar këtë program bazuar në informacione nga shkëmbimet me universitetet e huaja që drejtuesi i</p>
<p>Kriteri 5. Programet e studimit hartohen në përputhje me</p>	

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

9

objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara mbështeten në përvojën disavjeçare të institucionit dhe praktikatat e mira të vendeve evropiane.	departamenti ka pasur ndër vite si edhe nga eksperiencia dhe nevojat e tregut të punës për profesionistë të kësaj industrie.
Kriteri 6. Programet e ciklit të dytë “Master profesional” përfshijnë aftësimin profesional në praktika profesionale të përputhura me qëllimin dhe objektivat e programit, si dhe në direktiva ndërkombëtare për profesionet e rregulluara.	Praktika profesionale është një pjesë me rëndësishme e kurikulës së studenteve. Nga syllabuset e lëndëve të përfshira në program vërehet orientimi praktik, drejt koncepteve themelore të nevojshme për studentin pas daljes së tij nga auditorët dhe përballjes me terrenin. Edhe specifikisht në “Praktika profesionale” e cila zhvillohet në semestrin e dytë, Kategoria D dhe ka 3 kredite jepen konceptet themelore si: <ul style="list-style-type: none"> ✓ Si të prezantohen para punëdhënësit me CV, letër motivim, në intervistë ✓ Etika në vendin e punës ✓ Ndryshimi mes teorisë së shkollës e praktikës në terren ✓ Si aplikohet teoritë që kanë mësuar ✓ Si është mjedisi i punës ✓ Çfarë synojnë për t’u rritur ✓ Si do të zbatojnë dijet teorike për të shkuar më tej
Kriteri 7. Në varësi të profilin të institucionit, në programet e ciklit të dytë “Master profesional” mund të përfshihen elemente të mësimdhënies, module, lëndë ose i gjithë programi në gjuhë të huaj me qëllim thithjen e studentëve të huaj dhe ndërkombëtarizimin.	Programi zhvillohet i tëri në gjuhën shqipe. Ndërkohë që pjesa kryesore e literaturës profesionale është në gjuhën angleze. Institucioni bën përpjekje për thithjen e studentëve nga trojet shqiptare. Një pjesë e përmbledhur e syllabuseve të lëndëve gjendet e përkthyer edhe në gjuhën angleze, por nuk është online, por në sistemin e brendshëm informatik të KU Beder. Në faqen online të KU Beder gjendet edhe guida e plotë në gjuhën angleze https://issuu.com/universitetibeder/docs/student_guide_eng që shpjegon të gjithë ecurinë dhe hapat që duhet të ndjekë studenti nëse vendos se do të zgjedhë nga oferta universitare e KU Beder. Të përmbledhura, edhe në format .pdf gjenden info kryesore për programin master edhe në faqen web. http://com.beder.edu.al/sh/content/default/master-in-communication-journalism-profile/354/356
Kriteri 8. Programet e ciklit të dytë “Master profesional” mund të hapen përkohësisht në funksion të plotësisht të nevojave për personel të	Programi është hapur në varësi të nevojave të tregut të punës për profesionet e marketuesve. Kjo ka qenë edhe një nga arsyt kryesore të inicimit të këtij programi dhe nevoja për ta lidhur sa më saktë me tregun e punës. Evidenca nr. 7 Rregullorja e programit të studimit “Master profesional” në “Komunikim Marketingu”

kualifikuar në një drejtim të caktuar.	Evidenca 11: Studim tregu i zhvilluar nga Departamenti i Shkencave të Komunikimit Evidenca 15: Rregullorja e Praktikës Profesionale Evidenca 53: Syllabuset e lëndëve të programit			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.4

Programet e ciklit të dytë “Master profesional” janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	<p>Departamentin i Shkencave të Komunikimit, në përbërje të në Fakultetin të Shkencave Humane dhe Drejtësisë është njësi bazë që ofron programin e studimit Master Profesional në “Komunikim Marketingu”.</p> <p>Përbërja e stafit akademik të angazhuar në këtë fakultet si edhe në departament si njësi bazë që ofron programin tregojnë se kanë kapacitetet e nevojshme për ofrimin e këtij programi studimi. Nga shikimi i CV të personelit akademik, si me kohe të plotë ashtu edhe stafi i ftuar të japë lëndë specifike, tregohet se janë burimet njerëzore të duhura për realizimin e një mësimdhënie cilësore në këtë program studimi. Stafit akademik ka eksperiencë akademike dhe përvoja profesionale në organizata biznesi, me know-how të përshtatshme për realizimin e këtij programi studimit. Lëndët specifike të programit të lidhura me informacionet praktike dhe punën e përditshme të një specialist realizohen nga ana përfshirja në mësimdhënie e ekspertëve të fushës së medias, komunikimit dhe marketingut. Kjo është një ndihmë e madhe për studentët.</p>
Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	<p>Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit Master Profesional në “Komunikim Marketingu” është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, fakultetit, si edhe atë të njësisë bazë, Departamentit të Shkencave të Komunikimit.</p> <p>Departamenti ofron edhe programe të tjera studimi si në nivel Bachelor edhe në nivelin Master, të gjitha të lidhura me shkencat e komunikimit të tilla si: (i) Bsc në Shkenca Komunikimi; (ii) Program Profesional në Multimedia dhe Grafik Dizajn; (iii) Msc Shkenca Komunikimi – profilet: Gazetari; Marrëdhënie me Publikun; (iv) Master Profesional në Komunikim Marketingu.</p>
Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të	<p>Lloji i programit të studimit dhe diploma që lëshohet me mbarimin e tij, Emërtimi i programit të studimit, gjuha e studimeve, forma e studimeve, periudha e referencës, kohëzgjatja e studimeve, aktorët e interesit, studimi i tregut përpara hapjes së programit dhe vlerësimi dhe përndarja e krediteve janë në përputhje me standardet e vendosura kombëtare dhe evropiane.</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

11

paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.									
Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program të ciklit të dytë “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohet nga institucionet partnere.	Programi i studimit Master Profesional në “Komunikim Marketingu” është në përputhje me profilin e departamentit dhe fakultetit. Evidenca 3: Rregullore mbi Organizimin Akademik Evidenca 6: Plani strategjik Institucional i KU “Bedër” 2018-2023 Evidenca 7: Rregullorja e programit të studimit “Master profesional” në “Komunikim Marketingu” Evidenca 53: Syllabuset e lëndëve të programit								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <tr> <td></td> <td>Përmbushet pjesërisht</td> <td>Përmbushet kryesisht</td> <td>Përmbushet plotësisht</td> </tr> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi I.5

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisve e personelit, marrjes së përgjegjësisve respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p> <p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p> <p>Kriteri 3. Për realizimin e programeve të ciklit të dytë “Master profesional”, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute, kompani, të fushës përkatëse, për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.</p>	<p>Njësia bazë e këtij programi studimi, Departamenti i Shkencave të Komunikimit bashkëpunon me njësitë e tjera brenda institucionin KU BEDER, si ato akademike ashtu edhe ato administrative për të siguruar mbarëvajtjen e realizimit me sukses të programeve të studimit. Departamenti bën ndarjen e detyrave dhe koordinimin mes personelit akademik të departamentit duke përcaktuar qartë përgjegjësitë si në nivel akademik ashtu edhe nga pikëpamja administrative.</p> <p>Departamenti bën edhe koordinimin dhe mbikëqyrjen e aktiviteteve të shkencore, workshope, seminare etj që mund të jenë pjesë e një lënde apo e disa grup lëndësh që zhvillohen në departament. Këshilli i Departamentit përcakton këshilltarët akademikë, përfaqësuesin e departamentit në zyrën e këshillimit të karrierës dhe zyrën e marrëdhënieve ndërkombëtare.</p> <p>Departamenti në mënyrë periodike bën analizimin e ecurisë së procesit mësimdhënës dhe realizimin e bashkëpunimit në funksion të procesit mësimor. Gjatë vizitës në KU Beder nga diskutimi me Dekanin dhe përgjegjësin e departamentit të Shkencave të Komunikimit, GVJ u informua rreth mbledhjeve mujore që bën Departamenti si për ecurinë e programit apo edhe për progresin e studentëve. Në disa nga këto mbledhje marrin pjesë edhe studentët e programeve të studimit në mbikëqyrjen e sektorit përkatës.</p> <p>Evidenca nr. 51 Procesverbal mbledhje departamenti, ku është trajtuar një temë e sjellë nga studentet dhe ku kanë qenë prezent përfaqësues të studentëve.pdf Shënimet e vizitës</p>

<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimit që ofron.</p>	<p>KU Beder ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe jashtë vendit, si dhe me organizma biznesi vendas ose të huaj. Në dokumentin “Marrëveshjet e bashkëpunimit (aktive) me organizata, institucione dhe aktorët e biznesit vendas dhe, ose të huaj dhe për praktikën profesionale” jepen të listuara disa nga bashkëpunimet themelore ndërsa në dokumentin “Lista e institucioneve me të cilat KU Beder ka marrëveshje partneriteti për bashkëpunime në fusha të ndryshme” jepen MoU e nënshkruara nga Departamenti i Shkencave të Komunikimit në kuadër të realizimit të programeve të studimit. Kështu KU Beder ka 67 marrëveshje të nënshkruara (Memorandum Bashkëpunimi) me IAL me vende të ndryshme, nga të cilat 51 janë MoU aktive.</p> <p>Gjithashtu, KU Beder ka nënshkruar marrëveshje me “New media communication”, “New media digital”, dhe “Iceberg communication” specifikisht për realizimin e praktikave profesionale të studentëve. Lista e plotë e marrëveshjeve të nënshkruar gjendet si një dokument plotësues i përcjellë nga institucioni.</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p> <p>Kriteri 6. Në mënyrë periodike njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Departamenti i Shkencave të Komunikimit bashkëpunon me njësitë e tjera brenda institucionin KU BEDER për realizimin e programit të studimit. Ai harton raportet periodike vjetore për ecurinë e punës së departamentit dhe programeve të studimit që mbikëqyren nga ai.</p> <p>Raportet vjetore janë të ndarë në kapituj dhe trajtojnë të gjitha programet e studimit si edhe aktivitetet e tjera. Psh. “Raporti vjetor i Departamentit të Shkencave të Komunikimit, viti akademik 2018-2019” trajton edhe veprimtaritë akademike, workshope, konferenca, seminare MarCom, seminarët “Studenti dhe Profesia” si edhe aktivitetet ekstrakurrikulare.</p> <p>Seminarët MarCom dhe ato “Studenti dhe Profesia” janë specifikisht të dizenuara për studentët e Masterit Profesional sipas tematikave të caktuara, dhe synojnë t’u japin informacione të nevojshme për tregun e punës dhe zhvillimin e karrierës së tyre.</p> <p>Evidenca 18: Rregullorja e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë Evidenca 23: Rregullore mbi Organizimin Akademik Evidenca 26: Marrëveshjet e bashkëpunimit (aktive) me organizata, institucione dhe aktorët e biznesit vendas dhe, ose të huaj dhe për praktikën profesionale Evidenca 27: Lista e institucioneve me të cilat KU Beder ka marrëveshje partneriteti për bashkëpunime në fusha të ndryshme Evidenca 49: Raporti vjetor i Departamentit të Shkencave të Komunikimit, viti akademik 2018-2019</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>
--	------------------------------	------------------------------	-----------------------------	--

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

13

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË MASTER PROFESIONAL

Standardi II.1	
Programet e studimit organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1 Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional “Komunikim Marketingu”, që është në fokus të këtij vlerësimi të ekspertëve të jashtëm, nuk e kishte mbyllur ende vitin akademik të parë në zbatim. Në kohën kur u shqyrtua dokumentacioni dhe u bë vizita e punës në KU Bedër, studentët që frekuentonin këtë program ishin në ditët e fundit të zhvillimit të semestrit të dytë, për të vijuar më pas me sezonin e provimeve.</p> <p>Ky program studimi është projektuar me një vit akademik, ku realizohen dy semestra, secili me 16 javë. Zhvillimi i leksioneve dhe seminareve ishin formatet kryesore të kryerjes së temave për lëndët. Por në kushtet e mësimit në distance nga pandemia Covid-19 janë dhënë dhe detyra kursi për studentët pjesëmarrës në këtë program.</p> <p>Nga shqyrtimi i dokumenteve dhe bashkëbisedimi me përfaqësues të departamentit, stafit akademik dhe studentët u identifikuan këto lëndë të përfshira në kurrikulën e programit: “Metodat e avancuara kërkimore”; “Reklama dhe promovimi”; “Konceptim dhe menaxhim fushatash”; “Aplikacionet multimediale”; “Strategji kreativiteti”; “Strategjia dhe menaxhimi i markës”; “Marketing dixhital”; “Lëndë me zgjedhje”; “Praktikë profesionale” dhe “Përgatitja & Mbrojtja e tezës”.</p> <p>Sa i takon zgjedhjes së alternativave, provim përfundimtar formimi apo, tezë diplome – studentët do të realizojnë alternativën e dytë.</p> <p>Programi, nisur nga natyra e lëndëve përbërëse përfshin: Lëndë bazë, me njohuri metodologjike dhe kulturë të përgjithshme; lëndë karakterizuese, me njohuri mbi disiplinën shkencore; lëndë ndërdisiplinore dhe me zgjedhje; lëndë plotësuese dhe detyrimi final (teza e diplomës). Ky konfigurim shkon në të njëjtin drejtim me ligjin nr.80/2015 datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Udhëzimin nr. 15 dt. 04.04.2008 “Për Organizimin e Studimeve në Institucionet e Arsimit të Lartë”, si dhe Vendimin e KM nr. 41, datë 24.01.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”. Gjithashtu lëndët dhe modulet janë të organizuara me kredite, sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve, ECTS. Në total janë 60 kredite, për të dy semestrat.</p> <p>Kohështrirja për të dy semestrat është 640 orë mësimi si ngarkesë brenda auditorit dhe 860 orë jashtë auditorëve.</p> <p>Evidence Shtojca 1: Plani mësimor i detajuar</p>

<p>Kriteri 2 Programet e studimit të ciklit të dytë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionale dhe specialitetesh.</p>	<p>Nga shqyrtimi i kurrikulës, por dhe gjatë kontakteve me studentë e pedagogë të këtij programi është evident fakti se në përfundim të vitit akademik, studentët që e ndjekin ju jepet rast për të marrë njohuri dhe shprehje në aspekte të komunikimit dhe prezantimit; të marrin konceptet bazë të fushës ku janë orientuar; të iniciojnë dhe të finalizojnë një projekt/ide/prodakt duke e zotëruar atë në mënyrë individuale ose në ekip. Ngarkesa në 32 javët që zhvillojnë programin ju jep studentëve mundësi për të përmirësuar njohuritë e shprehitë, për t'u bërë më tërheqës dhe konkurrues në tregun e punës.</p> <p>Evidence Shtojca 1: Plani mësimor i detajuar</p>
<p>Kriteri 3 Programet e studimit të ciklit të dytë japin njohuri të përparuar në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>Programi është vërtet profesional, por përfshin në kurrikul dhe pjesën e trajtimit dhe të diskutimit të lëndëve teorike e konceptuale, që shtyjnë dhe hapin hapësirën për studentët frekuentues që të njohin studime dhe pikëpamje në dimensione të ndryshme. Kjo i mban studentët në një ngarkesë të dyfishtë, proporcionale, duke alternuar teorinë me praktikën, njohuritë që ju hapin atyre më shumë horizont për të menduarin kritik nga njëra anë, dhe shprehitë që ata fitojnë nga konkretizimi në detyra apo angazhime konkrete, duke prekur procedura mbi realizimin e një produkti konkret, nga ana tjetër. Procesi i marrjes së njohurive shkencore duket si një garanci që ata të kenë predispozitë potenciale për të shtyrë më tej background-in në një fushë studimore, për të cilën vijon angazhimi dhe kontributi.</p> <p>Evidence Shtojca 1: Plani mësimor i detajuar Evidenca nr. 53 Syllabuset e lëndëve të programit.pdf</p>
<p>Kriteri 4 Programet e studimit të ciklit të dytë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Gjatë zhvillimit të bashkëbisedimit me studentët që ndjekin për këtë vit akademik programin MP “Komunikim Marketingu” ata kishin pjekur idenë e një kombinimi të kurrikulës me lëndë teorike dhe praktike. Ata pranuan se ndjeheshin mire në lëndët me karakter aplikativ si “Marketing dixhital”, “Konceptim dhe menaxhim fushatash” apo “Strategjia dhe menaxhimi i markës”, ndërkohë që vlerësonin dhe lëndën “Metodat e avancuara kërkimore”, këtë të fundit e shikonin si referuese, sidomos për procesin realizimit të tezës së diplomës.</p>
<p>Kriteri 5 Programet e studimit të ciklit të dytë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p>Programi që është në fokus të këtij vlerësimi funksionon bazuar në VKM nr. 41, datë 24.01.2018 (i ndryshuar) "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë". Kjo pasqyrohet në dinamikën e zhvillimit të programit; nga procedurat e pranimit të studentëve; tek përcaktimi paraprak i krediteve që fitohen në dy semestrat e vitit akademik; në ndarjen e lëndëve që hyjnë në grupin e detyrueshëm dhe ato që janë në grupin me zgjedhje; në qarkullim paraprak të syllabus-ëve nga drejtuesit e lëndëve dhe moduleve, në formatet e kontrollit të dijeve dhe shprehive praktike, në aplikimin e krediteve (sipas ECTS). Studentët e frekuentojnë programin me kohë të plotë dhe në gjuhën shqipe.</p> <p>Evidenca nr. 7. Rregullorja e programit të studimit “Master profesional” në “Komunikim Marketingu”.pdf</p>

	Evidenca nr. 14 Shembull i syllabusi- Syllabus i lëndës Reklama dhe Promocioni.pdf			
Kriteri 6 Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese, duke grupuar lëndët/modulet sipas kategorive të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.	Konfigurimi dhe raporti mes ngarkesës dhe krediteve për t'u fituar nga studentët janë në përputhje me kërkesat e legjislacionit dhe akteve nënligjore në fuqi: <ul style="list-style-type: none"> • Për lëndët bazë, mbi përgatitjen metodologjike dhe kulturën e përgjithshme, që përbëjnë 10% të ngarkesës, janë përcaktuar 6 ECTS; • për lëndët karakterizuese mbi përgatitjen për disiplinën shkencore, që përbëjnë 40% të ngarkesës, janë përcaktuar 24 ECTS; • për lëndët ndërdisiplinore, ku hyjnë nëndisiplina, profile dhe gruplëndë me zgjedhje, të cilat zënë 20% të ngarkesës, janë caktuar 12 ECTS; • për lëndët plotësuese, që zënë 10% të ngarkesës, janë përcaktuar 6 ECTS dhe • finalizimi i tezës zë diplomës, që zë 20% të ngarkesës për studentin, janë përcaktuar 12 ECTS. 			
Kriteri 7 Programet e studimit parashikojnë ngarkesën në kredite të dedikuara për praktikën profesionale, laboratorike e klinike me ekuivalentim sipas përcaktimeve në aktet nënligjore kombëtare dhe në përputhje me direktivat evropiane.	Megjithëse është herë e parë që aplikohet në këtë vit akademik (2020-2021) ky program studimi i ciklit të dytë, njësia bazë, por dhe Fakulteti i Shkencave Humane dhe Drejtësisë në KU "Bedër" kishin krijuar një listë të subjekteve që zhvillojnë veprimtari në të njëjtën fushë si ajo e programit, ku janë sistemuar për realizimin e praktikës profesionale studentët. Marrëdhëniet me këto subjekte janë një garanci dhe për vitet e ardhshme që studentët të vijojnë praktikën e tyre, por njëkohësisht ato janë dhe potencialisht fronte pune për ndonjë prej tyre që zgjon interesin e pronarëve dhe menaxherëve, si një rezultat konkret punësimi për ta. Vëndet ku zhvillohen praktikat janë të njëjtës natyrë të orientimit të këtij programi master profesional, që i ndihmon studentët në konkretizimin e njohurive dhe shprehive që marrin nga zhvillimi i lëndëve dhe moduleve të ndryshme. Evidence Shtojca 1: Plani mësimor i detajuar Evidenca nr. 53 Syllabuset e lëndëve të programit.pdf			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.	Kolegji Universitar Bedër, si njësi kryesore ku përfshihet program në fokus, ka arritur dy akreditime institucionale, të parin në vitin 2013 nga APAAL dhe të dytin në vitin 2017 nga agjencia britanike e akreditimit "Quality Assurance Agency", në bashkëpunim me ASCAL.

	<p>Programi i studimit Master Profesional “Komunikim Marketingu” është në vitin e parë akademik (2020-2021) të zbatimit, por puna për themelimin ka nisur nga njësia bazë, Departamenti i Shkencave të Komunikimit, që në vitin 2017. Vetë njësia bazë ka ardhur te hapja e këtij program në mënyrë organike, gjykuar nga struktura e ndërtimit të kurrikulave në ciklin e parë dhe të dytë, por dhe për faktin se programet që ofron (shih më lart) i ka të akredituara ose në proces akreditimi.</p> <p>Të dyja këto argumente përbëjnë një shtrat të sigurtë të zbatueshmërisë së legjislacionit dhe akteve nënligjore për vlerësimin dhe akreditimin e programit të i studimit Master Profesional “Komunikim Marketingu”.</p> <p>Evidenca nr. 30 Urdhër nr.28 dhe 29, datë 12.04.2019 “Për akreditimin periodik të programit të studimit të ciklit të parë dhe të programit të studimit të ciklit të dytë.pdf</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p> <p>Kriteri 4. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Nga pikëpamja e organizimit Fakulteti i Shkencave Humane dhe Drejtësisë është një prej fakulteteve përbërës të KU Bedër.</p> <p>Fakulteti i Shkencave Humane dhe Drejtësisë ka në përbërje të tij katër departamente:</p> <ul style="list-style-type: none"> (i) Departamenti i Shkencave të Komunikimit; (ii) Departamenti i Drejtësisë; (iii) Departamenti i Shkencave Islame; (iv) Departamenti i Edukimit dhe Gjuhës Angleze <p>Brenda këtij fakulteti funksionon dhe Departamenti i Shkencave të Komunikimit, si njësia bazë që administron programin master profesional që është në shqyrtim.</p> <p>Fakulteti përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike (jo me pak se tre departamente)</p> <p>Duke vërejtur organigramën e KU BEDER dhe organizimin strukturor të Departamentit të Shkencave të Komunikimit, i cili është përgjegjës për programin e studimit Bachelor në “Marrëdhënie Publike dhe Komunikim Marketingu”, vihet re se plotësohen kriteret ligjore të e përcaktuara për sa i përket organizimit dhe strukturën së tij akademike.</p> <p>Pra programi është pjesë organike organizimi dhe strukture akademike, brenda fakultetit dhe departamentit, dy hallka që kanë burime njerëzore të mësimdhënies dhe punës shkencore në fushën e shkencave të komunikimit, ku një aspekt është komunikimi i marketingut. Programi përfshihet natyralisht në angazhimet që ka departamenti dhe fakulteti.</p> <p>Evidenca nr. 31 Organigrama e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë.pdf</p>
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet ligjore për numrin dhe nivelin e kualifikimit të personelit akademik, raportet midis</p>	<p>Aktualisht, për vitin akademik 2020-2021, Departamenti i Shkencave të Komunikimit, si njësia bazë për menaxhimin e programit që është në fokus ka 20 anëtarë të stafit akademik, prej tyre 9 PAE (full time) dhe 11 PAK (part time). Tek stafi PAE janë 4 anëtarë të angazhuar me gradën “Doktor”, dhe 5 anëtarë me Msc.</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

17

personelit me kohë të plotë, të pjesshme dhe të ftuar.

Nga biseda me trupën akademike të Departamentit të Shkencave të Komunikimit, por dhe drejtuesit e Fakultetit të Shkencave Humane, ku përfshihet njësia bazë e programit që shqyrtohet GVJ mësoi se ambicia është për të ofruar personel tjetër full time me gradat Doktor, Prof. Assoc apo Prof. Dr. Për dy vitet e ardhshme akademike kjo do të përbëjë impuls për cilësinë e stafit të angazhuar, duke rritur ofertën për student, për të krijuar qëndrueshmëri në të gjitha programet e studimit për dy ciklet, përfshirë këtu dhe MP “Komunikim Marketingu”.

Njësia Kryesore/Fakulteti i Shkencave Humane dhe Drejtësisë ka: 32 PAE dhe 33 PAK, që sipas shkallës së kualifikimit/titujve janë:

Të dhënat për stafin e Fakultetit	Viti 2020-2021	
	PAE	PAK
Prof.Dr	1	1
Prof. Assoc.	1	2
Dr/PHD	13	11
Msc	17	19
Total	32	33

Njësia Bazë / Departamenti i Shkencave të Komunikimit ka 9 PAE dhe 11 PAK, që sipas shkallës së kualifikimit/titujve janë:

Të dhënat për stafin e Departamentit	Viti 2020-2021	
	PAE	PAK
Prof.Dr	-	-
Prof. Assoc.	-	1
Dr/PHD	4	4
Msc	5	6
Total	9	11

Tabela (shtojca 1)

Kriteri 5. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit angazhon personel akademik ndihmës për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike.

Për rastin e programit të studimit që po shqyrtohet për pjesën e menaxhimit të laboratorit të Multimedias, që është një infrastrukturë në dispozicion edhe për MP “Komunikim Marketingu” ka personel ndihmës, që asiston pedagogët e studentët gjatë kohës që merren me detyrat dhe praktikat, si pjesë e kurrikulës.

Kriteri 6. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.

Për programin studimor MP “Komunikim Marketingu” koordinatori është drejtuesi i Departamentit të Shkencave të Komunikimit. Kjo përzgjedhje ishte për faktin se programi meqë zbatohet në vitin e parë akademik, ka nevojë për mbështetje deri në detaj, për dinamikën në çdo hallkë, duke evidentuar dhe kapërcyer problematika të fillimit. Me kalimin e dy viteve të para, GVJ u informua se natyrshëm do të kishte një zgjedhje tjetër nga personeli akademik full time, për të ndjekur çdo etapë dhe element në ecurinë e programit të studimit.

Evidenca nr. 32 Vendimi i Këshillit të Departamentit për Emërimin e Koordinatorit të Programeve Master.pdf

Kriteri 7. Koordinatorin e programit raporton në mënyrë periodike te drejtuesit të njësive përgjegjëse dhe dokumenton çdo

Gjatë bashkëbisedimit me koordinatorin e programit të studimit që është në proces akreditimi u njohëm dhe me mënyrën e dokumentimit të ecurisë së kurrikulës, jo thjesht e ndarë në dy etapa kohore, (në dy semestret e vitit

informacion që lidhet me programin e studimit.	akademik), por duke u evidentuar për zhvillimin e lëndëve, praktikave, angazhimit shkencor, fazes së përgatitjes së tezës së diplomimit etj.		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi II.3

Programet e studimit të ciklit të dytë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe të organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të dytë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të dytë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	<p>Për funksionalitetin e programit që kemi në shqyrtim kemi shikuar, qoftë nga materiali i prezantuar nga njësia që ka realizuar vlerësimin e brendshëm për MP “Komunikim Marketingu”, qoftë dhe nga dokumentacioni që GVJ ju vu në dispozicion në vizitën në institucion, se ka një bazë të qëndrueshme të akteve nënligjore të miratuara nga KU Bedër, apo nga Fakulteti i Shkencave Humane dhe Drejtësisë, si dhe nga njësia bazë që menaxhon këtë program (Departamenti). Rregullorja themelore e KU "Bedër", rregullorja e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë, si dhe rregullorja e vetë programit në shqyrtim janë në sinkron dhe garantojnë ecurinë e procesit të rekrutimit të atyre studentëve që janë të interesuar; për zhvillimin e lëndëve/moduleve, për kryerjen e praktikave dhe detyrave të tjera, deri tek finalizimi me tezën e diplomimit. Ky kuadër rregullativ nënligjor është në bazueshmëri me ligjislacionin e miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë, apo me udhëzimet e vendimet e lëshuara prej Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.</p> <p>Evidenca nr. 18 Rregullorja e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë.pdf Evidenca nr. 33 Rregullorja e Zyrës së Sekretarisë Mësimore.pdf</p>
Kriteri 2. Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.	<p>Sipas vlerësimeve që janë bërë më sipër, programi studimor MP “Komunikim Marketingu” është organizuar sipas standardeve të legjislacionit që është në fuqi, duke u zhvilluar në një vit akademik, me dy semestra, secili nga 16 javë, ku përfshihen 10 lëndë (bashkë me praktikën e tezës e diplomimit), për secilën me përcaktime të ngarkesës dhe krediteve (ETSC).</p> <p>Bazuar në ndërtimin e kurrikulës lëndët zhvillohen përmes leksioneve, seminareve, (ku jepen dhe detyra dhe ushtrime që kanë lidhje me temat e trajtuara), si dhe praktika lëndore. Nga kufizimet dhe ndalimet për shkak të pandemisë nuk janë realizuar orë laboratorike.</p>
Kriteri 3. Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.	<p>Aplikimi i krediteve (ETCS) në programin që kemi në shqyrtim është i ndarë sipas ngarjesës dhe natyrës së lëndës/modulit, duke qenë në total 60.</p> <p>Ngarkesa për një student që ndjek MP “Komunikim Marketingu” është 1500 orë, për dy semestrat (nga nga 16 javë secili). Nga kjo ngarkesë totale, orët në auditor janë 519 orë mësimore, e barabartë me 34.6%, ndërkohë që pjesa tjetër 65.4% është orë jashtë auditorit (koha e studimit individual).</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

19

	<p>Nga bashkëbisedimi me studentët e programit ata shprehën dakordësinë për shpërndarjen e ngarkesës në semestrin e parë dhe në atë të dytë. Po këto vlerësime kishte dhe stafi akademik.</p>
<p>Kriteri 4. Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>Në programin që kemi në fokus plani mësimor që parashikohet të realizohet në dy semestret e vitit akademik ka një shpërndarje proporcionale për studentët, nisur nga kreditet për secilën lëndë, rrjedhimisht dhe orët e planifikuara (në auditor dhe jashtë auditorit). Gjithashtu në secilin syllabus të lëndës përfshihen dhe mënyra e frekuentimit, si dhe struktura e vlerësimit për studentët (pesha që zë psh., pjesëmarrja, plotësimi I detyrimeve testi ndërmjetëm, testi final etj.</p> <p>Programi duket se ka të njëjtin standard si programet e ngjashme në Fakultetin e Shkencave Humane dhe Drejtësisë, ku tek vlerësimi për studentit ndërtohet duke marrë në konsideratë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 5-10 % pjesëmarrja në orët mësimore; - 10-20 % plotësimi i detyrimeve (laboratorike, detyrave të kursit); - 20-30% testimet e ndërmjetme; - 40-50% teza diplomës. <p>Për frekuentimin e studentëve KU Bedër ka vendosur detyrim 70% për lëndët teorike dhe 80% për laboratorët.</p> <p>Sistemi i vlerësimit është i klasifikuar edhe me vlerësimin me pikë nga 0-100 edhe me sistemin respektiv me shkronja nga F deri në A.</p> <p>Kjo strukturë për vlerësimin nuk ka ndryshuar dhe në kushtet kur mësimi zhvillohet virtualisht, pasi dhe në këtë rast pedagogët evidentojnë pjesëmarrjen e studentëve në frekuentimin e lëndës/modulit.</p> <p>Shtojca 1: Tabelat Evidenca nr. 34 Rregullorja e Studimeve dhe Provimeve të Ciklit të Dytë.pdf</p>
<p>Kriteri 5. Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>GVJ vlerëson se në programin e studimit që shqyrtohet ka qarkulluar informacioni njohës mbi kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. Studentët që e ndjekin aktualisht këtë viti akademik në MP “Komunikim Marketingu” janë njohur së pari gjatë procesit të interesimit për këtë Master, pastaj gjatë javës së parë informuese të zhvilluar në semestrin e parë, apo dhe në vijimësi ku janë interesuar tek koordinatori i programit në njësinë bazë, apo në zyrat që mbulojnë këtë proces në KU Bedër.</p> <p>Studentët me të cilët GVJ bashkëbisedoi, pranuan se që para se të fillonte viti akademik, ata kishin marrë info mbi aspekte të ndryshme nga procesi mësimor, duke nisur nga njohja me syllabus-et për secilën lëndë, ngarkesën e orëve, mënyrën e frekuentimit, vlerësimit etj.</p> <p>Informacionet njohëse GVJ i ka hasur dhe në përmbajtjen e faqen online te KU Bedër, www.beder.edu.al.</p> <p>Evidenca nr. 35 Guida e Studentit.pdf</p>

<p>Kriteri 6. Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Jo vetëm përmes materialit njohës të përgatitur nga Grupi i Vlerësuesve të Brendshëm, por dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit në Departament, apo nga bashkëbisedimi me studentët e MP “Komunikim Marketingu” GVJ krijoi bindjen se syllabuset ishin vënë në dispozicion që në fillim të realizimit të një lënde apo moduli, si pjesë e kurrikulës. Syllabuset janë sipas një formati të miratuar. Në syllabuse janë dhënë informacionet e nevojshme lidhur me organizimin e lëndës në leksione/seminare/ushtrime/laboratore/ detyra kursi, si dhe ngarkesën përkatëse brenda dhe jashtë auditorit. Në syllabuse jepet informacion mbi titullarin e lëndës (emri, grada shkencore), kreditet (ECTS), një ekstrakt mbi përmbajtjen e lëndës dhe prezantimi i temave që do të zhvillohen gjatë semestrit, detyrimet për t’u shlyer, format e kontrollit gjatë semestrit, pjesa e literaturës se detyrueshme dhe ndihmëse. Informacion jepet dhe makro, dmth mbi lëndët që janë në semester, kohëzgjatja e procesit mësimor, periudha e provimeve etj. Syllabuset janë ndërtuar në përputhje me elementët e përcaktuar në shtojcën Nr. 2 të VKM Nr. 41, dt. 24/01/2018.</p> <p>Evidenca nr. 53 Syllabuset e lëndëve të programit.pdf</p>			
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>Programi që po vlerësojmë ka specifikë se është fillimet e veta (shpjeguar më sipër që është viti i parë akademik në zbatim), ndaj dhe nuk ka pasur procese të përmirësimit dhe aktualizimit. Por njësisia bazë i prezantoi GVJ objektivin se duke bashkëpunuar me Zyrën e Zhvillimit të Kurrikulave që në mbarim të këtij viti akademik do të ketë ndërhyrje përmirësuese, kjo e referuar nga mendimet e vlerësimet e studentëve apo stafit akademik të përfshirë në MP “Komunikim Marketingu”. Ky angazhim do të jetë periodik.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>X</p>

Standardi II.4

Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrin Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënës, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional në “Komunikim Marketingu” zgjat 1 vit akademik, me dy semestral, 16 javë secila. Ngarkesa për studentët që e ndjekin aktualisht këtë program është konvertuar me kredite (ECTS), ku 1 kredit është për 25 orë, ndërkohë që i gjithë programi shkon në total 1500 orë (ose 60 ECTS).</p> <p>Ndarja e ECTS-ve është në mënyrë të balancuar për të dy semestrat, si një shpërndarje efektive për ngarkesën e një studenti të kursit, që nga fillimi dhe deri në finalizimin e kryerjes së tezës së diplomimit për Master Profesional në “Komunikim Marketingu”.</p> <p>Ngarkesa e programit është në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi në vendin tonë, si dhe bazuar në Kartën e Bolonjës.</p> <p>Evidenca nr. 36 Vendimi i Këshillit të Departamentit për ngarkesën mësimore.pdf</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

21

<p>Kriteri 2. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë thellim të njohurive dhe aftësive dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>Ideimi dhe ndërtimi i këtij programi studimi të ciklit të dytë, nisur prej vitit 2017 nga njësisia bazë, ka qenë një proces i bazuar në përvojat që ka vetë KU Bedër me studimin dhe kërkimin shkencor, reflektim i përvojës së institucioneve të tjera të arsimit të lartë në Shqipëri, por dhe nga vendet e tjera.</p> <p>Shënjestra ka qenë dhe mbetet për kornizën e një programi Master që të jetë tërheqës për studentët që kryesisht vijnë nga shkencat e komunikimit nga studimet në ciklin e parë, por dhe nga degë e profile të ngjashme, për t'i ofruar ndjekësve të programit njohuri teorike të konsoliduara të harmonizuara me shprehi praktike, që ata të jenë të gatshëm për tregun në këtë fushë.</p> <p>Ata studentë që janë edhe në punë ndërkohë që ndjekin MP “Komunikim Marketingu” shtojnë më tej dhe më thellë aftësimin e tyre, kurse për ata që nuk janë të sistemuar si një premise për punësimin sa më të shpejtë.</p>
<p>Kriteri 3. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënimit dhe aftësimin profesional.</p>	<p>Zhvillimi i kurrikulës, ku përfshihen lëndë që janë të detyrueshme, si dhe nga ana tjetër lëndë që janë me zgjedhje për studentët – kjo krijon një kombinim për njohuritë dhe shprehitë e studentit që frekuenton programin, për formimin e tij me dije dhe njohuri të bollshme në fushën e komunikimit e marketingut, si dhe me aftësimin profesional për t’ju përgjigjur kërkesave që ka tregu i punës.</p> <p>Këtë bagazh teorik e praktik, studenti e merr nga zhvillimi i leksioneve e seminareve, nga kryerja e detyrave dhe temave të kursit, nga periudha e praktikës, si dhe nga përfshirja në aktivitete me karakter studimor e shkencor.</p> <p>Evidence: Tabelat e planit mesimor-Master Profesional ne komunikim marketingu.docx</p>
<p>Kriteri 4. Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit master dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Në vlerësim të kurrikulës për programin që është në fokus evidentohet proporcion i drejtë mes pjesës së lëndëve me karakter teorik dhe pjesës me karakter aplikativ, tregues që shkon në favor të rezultateve të pritshme të të nxënimit dhe aftësimin profesional. Ngarkesa për studentët është brenda natyrës së një programi studimor të ciklit të dytë universitar, e ngjashme me programe që zbatohen nga IAL të tjera në vendin tonë, apo dhe nga vendet e tjera.</p> <p>Megjithëse është në vitin e parë të aplikimit nga KU Bedër, programi do të krijojë qëndrueshmërinë dhe garancinë se do të jetë tërheqës për studentët dhe i dobishëm për të diplomuarit që dalin në tregun e punës.</p> <p>Referuar shqyrtimit të të dhënave që u morrën në Departamentin ku përfshihet program studimor në fokus, si dhe bashkëbisedimi me studentët e MP “Komunikim Marketingu”. Lëndet janë organizuar në zhvillimin e leksioneve, seminareve (ku përfshiheshin dhe ushtrime e detyra), si dhe realizimin e praktikave.</p> <p>Nisur nga rrethanat e masave dhe protokolleve të zbatuara kundër COVID-19 orët laboratorike nuk janë realizuar, por siç është spjeguar më sipër, laboratorit i multimedias dhe auditorët e pajisur me rrjet kompjuterash ku janë instaluar programe të ndryshme multimediale – kanë qenë në gatishmëri për t’u frekuentuar nga studentët që kanë pasur nevojë për të realizuar detyra a projekte të ndryshme, përfshirë dhe punimin e tezës.</p> <p>Nisur nga strukturimi kohor për zhvillimin e lëndëve në auditorë, ndarja ishte e tillë:</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

22

	<ul style="list-style-type: none"> • Leksione – 347 orë në auditor • Seminare – 68 orë në auditor • Praktikë profesionale – 15 orë në auditor • Përgatitja e tezës së diplomës – 64 orë në auditor • Orët e provimit 25 orë në auditor • Në total orët në auditor janë 519. <p>Nisur nga këto të dhëna, rezulton se sasia e 519 orëve në auditor është 34.6% e ngarkesës totale që student që ndjek këtë program studimi. Kurse pjesa tjetër, e orëve jashtë auditorëve (koha e studimit individual) është 65.4%</p> <p>Evidence: Tabelat e planit mesimor-Master Profesional ne komunikim marketingu.docx</p>
<p>Kriteri 5. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Gjykuar nga kompozimi i kurrikulës me lëndët bazë, (10%); karakterizuese (40%); ndërdisiplinore (20%); me lëndë me zgjedhje (20% dhe teza finalizuese e diplomimit (20%) – programi MP “Komunikim Marketingu” krijon balance në anën teorike dhe të shprehive profesionale e praktike që iu ofrohen studentëve. Nga shpërndarja e krediteve për secilin nga dy semestrat atyre ju mundësohen që brenda vitit akademik të arrijnë objektivat formues, si dhe të kenë akses për transferim të studimeve e mobilitet, dhe mbi të gjitha të kenë mundësi për t’u përfshirë në tregun e punës.</p> <p>Evidence: Tabelat e planit mesimor-Master Profesional ne komunikim marketingu.docx</p>
<p>Kriteri 6. Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>Vlerësimi për këtë kriter është vetëm për fazën e prezantimit që iu është bërë nga pedagogët e lëndëve/moduleve për studentët që frekuentojnë këtë program studimi të ciklit të dytë për literaturën e detyruar dhe atë ndihmëse.</p> <p>Nga shqyrtimi i syllabuseve konkrete ky aspekt përfshihej aty në të gjitha rastet, si një përbushje detyrimi nga stafi akademik. Aty mbisundojnë tituj librash të 5 viteve të fundit të publikimit. Kurse për përditësimin e programeve të lëndëve ky është një proces për të cilin nga njësia bazë u shpreh gatishmëri se do të kryhej në vijim.</p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfitim e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>Ndërtimi i kurrikulës, sikundër është shpjeguar edhe më sipër, është një sinkroni e marrjes së dijeve shkencore me shprehi praktike, një alternim që u jep siguri të diplomuarve në MP “Komunikim Marketingu” për ta kryer ciklin e dytë që t’u jape oportunitet ose që të vijojnë studime më të thelluara shkencore, ose dhe për të qenë të gatshëm për të kontribuar në tregun e punës.</p> <p>Kurrikula e këtij programi studimi nga përmbajtja e lëndëve që zhvillohen është cilësisht më lart, duke shtyrë më tej njohuri dhe shprehi praktike për ta, krahasuar kjo me kurrikulën që zhvillohet në nivelin e parë të studimit (Bachelor). Studenti ngre më shumë nivelin e dijeve për fushën që ka zgjedhur, njëkohësisht është më afër kapacitetit të nevojshëm për të filluar punë. Për ata që kanë ndjekur programin dhe njëkohësisht kanë punuar efektet e rritjes profesionale teorikisht dhe praktikisht janë evidente – sipas spjegimeve që na kanë bërë dhe vetë studentët gjatë bisedës në grup ose individualisht.</p>

<p>Kriteri 8. Organizimi i programit të studimit siguron aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.</p>	<p>Lista e partnerëve që ka afruar njësitë bazë ose KU Bedër, ku studentët e programit studimor MP “Komunikim Marketingu” është një garanci se frekuentuesve ju jepet shkas që praktikat profesionale të kryejnë si në kushtet reale. Studentët duke punuar gjatë kësaj periudhe në subjekte, sipërmarrje e institucione që janë brenda fushës ku ata studjojnë, ju ofron atyre sigurinë për të përfituar përmes një formimi të thelluar.</p>			
<p>Kriteri 9. Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Nisur nga kurrikula konkrete e programit MP “Komunikim Marketingu” shikohet kombinimi i anës teorike me shprehitë praktike profesionale me të cilat ata përballen gjatë vitit akademik.</p> <p>Ky investim te ata shkon për oportunitete për të ardhmen e afërt të tyre: ose të vijojnë një proces më të thelluar të studimeve shkencore (psh duke realizuar një master shkencor në një profil të ngjashëm ose të përfshirë, psh në marrëdhënie me publikun, gazetari etj., në programet e vetë KU Bedër, ose IAL-të të tjera të vendit, ose që të përfshihen në tregun e punës, për drejtimin që ata diplomohen në këtë cikël të dytë.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi II.5

Personeli akademik dhe ndihmës-akademik, që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik dhe profesional për garantimin e standardeve të mësimdhënies në kuadër të programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi.</p> <p>Kriteri 2. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohet në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës në KU Bedër, në kontaktin me stafin akademik me kohë të plotë dhe të pjesshme, por dhe nga shqyrtimi që bëme në dokumentacionin (dosjet) e tyre të depozituara. Për personelin akademik që ishte përfshirë në kurrikulën e programit të studimit MP “Komunikim Marketingu”, ishte me përvojë në fushën e studimit dhe kërkimit, por dhe në mësimdhënie në auditor.</p> <p>Ka sinkroni mes orientimit të tyre shkencor dhe angazhimit në lëndë apo module.</p> <p>Pedagogët me kohë të pjesshme ishin të profilizuar për njohuritë dhe shprehitë profesionale që kërkonte lënda/moduli që udhëheqin. Ka dhe përputhshmëri me kërkesën e gradës shkencore për personelin e angazhuar, ndërkohë që Departamenti i Shkencave të Komunikimit dhe Fakulteti i Shkencave Humane dhe Drejtësi pranuan se ishin në një fushatë për rekrutimin dhe të personelit shtesë, me synimin e gradave “Prof. Dr” apo “Prof. Assoc. Dr”. Paralelisht dhe për ngritjen me grada të personelit ekzistues - si një investim për cilësinë dhe përmirësimin e performancës së stafit akademik.</p> <p>Në realizimin e programit të studimit “Master profesional në “Komunikim Marketingu”” janë përfshirë personel akademik efektiv, personel akademik me kontratë dhe personel ndihmës akademik. Në vitin 2020-2021, angazhimi</p>

i personelit akademik në mësimdhënje dhe kualifikimi i tyre përkatësisht është si më poshtë:

Kualifikimi	2020-2021	
	PAE	PAK
Prof		
Prof As		
Dr.PhD	6	1
Dr proc		
Msc		
Totale	6	1

Nga të dhënat rezultojnë se stafi akademik ka kualifikim të nevojshëm, sipas kërkesave ligjore.

Nga verifikimi i të dhënave statistikore, u konstatua se për vitin 2020-2021 mbi 70% e ngarkesës mësimore është mbajtur nga personeli akademik efektiv.

Kriteri në lidhje me ngarkesën mësimore dhe numrin e moduleve që mund të mbaj një pedagog plotësohet.

Nga studentët e programit të studimit MP “Komunikim Marketingu” pati vlerësime për nivelin e mësimdhënies, suportin dhe komunikimin me pedagogët, qofshin me kohë të plotë apo të pjesshme. Studentët gjatë bashkëbisedimit, apo dhe në intervistat të veçanta e pranuan se zhvillimi i mësimin në distance nga masat e protokollit antiCovid-19, ishte një pengesë në aspektin e procesit të komunikimit me pedagogët, por dhe në kushtet virtuale ata kishin akses dhe mundësi për të shkëmbyer pikëpamje, për të marrë info, ose për të diskutuar me personelin akademik. Mjaft intensiv ishte komunikimi dhe ndërveprimi me koordinatorin e programit që ata ndiqnin. Shtojca 1 Tabelat

Evidenca nr. 37 CV-të e stafit.pdf

Kriteri 3. Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.

Referuar dokumentacionit në dosjet individuale, personeli akademik i përfshirë në programin e studimit MP “Komunikim Marketingu” ishte me përvojë punë në KU Bedër, por dhe në IAL të tjera, ose në institucione apo subjekte të profilit ku dhe anagazhohen me lëndë /module. Ata kanë depozituar dokumentacion mbi kualifikimet brenda lëmit të ekspertizës shkencore/kërkimore, ose në shprehitë profesionale.

Sikundër dhe u përmend më lart ata janë të përfshirë në program brenda specialitetit të fushës për të cilën bazohet dhe lënda/moduli – duke qenë efektivë në transmetimin e dijeve, njohurive teorike apo shprehive profesionale tek studentët.

Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për udhëzimin,

Departamenti i Shkencave të Komunikimit, si njësi bazë ku përfshihet programi MP “Komunikim Marketingu” ka punuar në dy rrafshet për rekrutimin dhe përfshirjen e personelit akademik. Duke shfrytëzuar nga burimet njerëzore që janë afruar prej vitesh nga KU Bedër në programe të tjera studimi të ngjashme, ose ku ka lëndë të ngjashme – sidomos nga personeli pjesë e Departamentit. Në këtë aspekt janë përzgjedhur pedagogë që janë të angazhuar në lëndë/module të ngjashme, për të garantuar

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

25

<p>udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>sinkroninë mes nevojave që ka programi me ofertën e aftësive dhe kapaciteteve të tyre. Rrafshi tjetër është afrimi në program i personelit që kontribuon vetëm për kurrikulën e programit MP “Komunikim Marketingu”, duke siguruar ekspertizën teoriko profesionale të lëndëve/ moduleve aplikative.</p> <p>Siç është përmendur në standardet e mëparshme dhe marrëdhëniet apo akordet me rrjetin e institucioneve, subjekteve, sipërmarrjeve – kryesisht për realizimin e praktikave profesionale- ndihmojnë në qëndrueshmërinë e mbështetjes për studentët e përfshirë në program në arritjen e qëllimeve dhe objektivave të planifikuara.</p> <p>Evidenca nr. 38 Procedura e Praktikës Profesionale.pdf</p>								
<p>Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmësmësimor-shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Për vetë natyrën që ka programi që është në fokus të këtij vlerësimi, personeli Ndihmës për stafin akademik është në mënyrë të veçantë tek hapësira më dinamike e praktikimit të studentëve, që është Laboratori i Multimedias një strukturë teknike dhe teknologjike multifunksionale, ku secili prej kompjuterave të instaluar është një post pune për studentët, si në kushtet reale të një redaksie, institucioni, apo sipërmarrjeje që ka sektor/njësi për marrëdhëniet me publikun për marketingun etj.</p> <p>Ata që përfshihen si personel ndihmës asitojnë stafin akademik, por dhe studentët, në informim – orientim për aspekte nga dinamika e realizimit të kurrikulës së programit MP “komunikim Marketingu”.</p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="576 994 756 1077"></th> <th data-bbox="761 994 970 1077">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="975 994 1184 1077">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1189 994 1422 1077">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="576 1084 756 1124"></td> <td data-bbox="761 1084 970 1124">x</td> <td data-bbox="975 1084 1184 1124"></td> <td data-bbox="1189 1084 1422 1124">X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht		x		X
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
	x		X						

Standardi II.6

Institucioni i arsimit të lartë inkurajon përfshirjen e studentëve dhe partnerëve në përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit dhe realizimin me sukses të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p>Rrjeti i subjekteve dhe institucioneve partnere që ka filluar të ndërtojë Departamenti i Shkencave të Komunikimit prej krijimit të vet, mbetet një vlerë që ndikon dhe tek programi MP “Komunikim Marketingu” që po mbyll vitin e parë të aplikimit. Ky rrjet tashmë është pasuruar duke pasur parasysh dhe nevojat specifike që ka programi që është në fokus.</p> <p>Duke ndjekur grafikun e realizimit të praktikave profesionale që kryejnë studentët, Departamenti është në kontakt me drejtuesit e menaxherët e subjekteve dhe institucioneve për të shënuar e marrë në konsideratë problematikat që ata ngrenë nga performanca e studentëve, si një impakt për përmirësimin e programit. Konsultat me partnerët nga tregu i punës, nuk janë spontane, por periodike për të reflektuar në kohë reale ndryshimet e nevojshme.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni inkurajon dhe përfshin në diskutime, në kuadër të përmirësimin të programit të studimit, edhe</p>	<p>Duke qenë viti i parë i aplikimit të programit nuk është se ka një histori përvoja për angazhimin e studentëve në ndonjë proces diskutimi për përmirësimin e kurrikulës, apo formave organizative dhe funksionale të MP</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

26

studentët dhe strukturat e tyre. Propozimet diskutohen dhe reflektohen nëse ato janë në funksion të përmirësimit të programit të studimit.	<p>“Komunikim Marketingu”. Por studentët e këtij brezi të parë që pritet të diplomohen kanë pranuar pjesmarrjen e përfaqësuesve të tyre në mbledhjet e departamentit, si njësi bazë, ndërkohë që në lëndë të veçanta janë përfshirë në diskutime me pedagogët e tyre, apo me koordinatorin e programit për aspekte përmbajtësore, organizative dhe administrative të MP “Komunikim Marketingu”. Ata janë ndjerë të lirshëm në propozimet dhe sygjerimet për stafin akademik ashtu dhe për Departamentin.</p> <p>Evidenca nr. 39 Vendimi i Senatit për Përfshirjen e Studentëve në Këshillin e Departamentit.pdf</p>			
Kriteri 3. Institucioni mban kontakte dhe konsultohet në mënyrë të vazhdueshme me studentët e diplomuar dhe merr prej tyre propozime për përmirësimin e programeve të studimit.	<p>Nuk ka të diplomuar ende në këtë program studimit të ciklit të dytë. Fakt është se studentët aktualë kanë dhënë mendime dhe vlersime në takimet në grup që kanë pasur në departament, por dhe në plotësimin e anketës në fund të semestrit të parë. Këto aspekte janë prezantuar nga studentët gjatë takimit që ekspertët për vlerësimin e jashtëm zhvilluan me ta gjatë vizitës në KU Bedër.</p> <p>Evidenca nr. 40 Rregullorja e Organizimit Administrativ.pdf</p>			
Kriteri 4. Në bashkëpunim me institucionet publike e private, njësitë e pushtetit vendor etj., institucioni përditëson, përshtat dhe riorganizon programe të posaçme në përputhje me kërkesa dhe nevoja specifike lokale dhe zhvillimi.	<p>Të paktën për këtë vit vijues akademik (2020-2021) kemi evidentuar që Departamenti ku përfshihet programi MP “Komunikim Marketingu” po përdor një rrjet me subjekte dhe institucione partnere (të fokusuara në fushën e programit) ku krijohen hapësira bashkëpunimi konkret për të afruar student në realizimin e praktikës profesionale, por dhe për detyra apo angazhime të tjera të tyre që lidhen me kurrikulën. Kjo është një hapësirë që ndihmon dhe mbështet studentët për përmbushjen e nevojave që ata kanë për të sendërtuar njohuritë teorike të fituara nga zhvillimi i lëndëve të ndryshme gjatë dy semestrave. Departamenti ka shprehur angazhim se do ta aktualizojë periodikisht këtë rrjetë partneritetit në përputhje me interesat dhe kërkesat e studentëve që pëfshihen në MP “Komunikim Marketingu”.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X
Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1

Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë harton udhëzues në nivel	Funksionaliteti i programit studimor të ciklit të dytë, MP “Komunikim Marketingu”, ndër programet më të reja që aplikon KU Bedër, garantohet nga

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

27

<p>institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>zbatimi i rregulloreve të vetë programit, të departamentit, apo dhe ato të Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësi, a KU Bedër. Këto akte, që sipas përfaqësuesve të Departamentit ku përfshihet programi që është në fokus, përmirësohen periodikisht bazuar në propozimet e sugjerimet e studentëve, stafit akademik apo partnerëve e bashkëpunëtorëve strukturojnë procedimin e hartimit dhe zbatimit të planeve të mësimdhënies, të përfshirjes në studimin dhe kërkimin shkencor, në aktivitete të ndryshme dhe brenda dhe jashtë auditorëve, në praktikat profesionale, në ideimin, realizimin dhe dorëzimin e detyrave të kursit, për ecurinë e përgatitjes dhe mbrojtjes së tezës së diplomimit etj. Ato janë shtysë dhe për aplikime bashkëkohore të mësimdhënies, të kontrollit të njohurive, të sistemeve efikase të vlerësimit në lëndë/module të ndryshme.</p> <p>Nga bashkëbisedimi me stafin akademik GVJ u informua mbi udhëzuesin e metodave dhe platformave të mësimdhënies në kushtet e mësimin virtual. Udhëzuesi është hartuar vitin e kaluar akademik, 2019-2020, më 24.03.2020, duke u ballafaquar me vështirësitë e pandemisë COVID – 19, me masat kufizuese dhe ndaluese të shpallura nga autoriteti publik shëndetësor, ku dhe mësimi kaloi nga auditorët në online. Udhëzuesi nuk e humb rolin dhe ndikimin me normalizimin e situatës së pandemisë, pasi mësimdhënia me të ftuar në audior përmes platformave online, por dhe veprimtari të ndryshme që lidhen direkt ose indirekt me zhvillimin e kurrikulës do të vijojnë si kanale komunikimi efikase duke zgjeruar aksesin e të ftuarve edhe nga universitete apo institucione të ndryshme akademike jashtë vendit.</p> <p>Evidenca nr. 41 Udhëzim mbi mësimdhënien në distancë.pdf</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Ka mekanizma monitoruese dhe vlerësuese mbi aftësitë dhe performancën e personelit akademik dhe ndihmës-akademik. Anketa e studentëve për kontributin e stafit akademik që përfshihen në programin e tyre, e zhvilluar në fund të dy semestreve, vlerësohet me përgjegjësi nga njësi bazë (departamenti), por dhe në hierkinë administrative akademike në KU. Gjetjet dhe problematikat e shprehura nga studentët bëhen objekt shqyrtimi nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, NJSBC, e cila përpilon informacione mbi situatën konkrete, që vlejnjë për ndërhyrje përmirësimi në metodat mësimdhënëse të ekipit akademik, qoftë më kohë të plotë, qoftë me kohë të pjesshme, por dhe për ndërhyrje në listen e personelit akademik të angazhuar, sipas lëndës/modulit që ata zhvillojnë.</p> <p>Edhe formularët e vetëvlerësimit që plotësohen nga vetë personeli akademik, i japin mundësi njësisë bazë apo strukturave të tjera hierarkike të njohin dhe vlerësojnë situatën me aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik. E njëjta gjë ndodh dhe me programin MP “Komunikim Marketingu” që GVJ ka në shqyrtim, ku mekanizmat e përshkruar më sipër janë aplikuar dhe në këtë vit akademik, që zhvillohet për herë të parë. (Në bashkëbisedim me studentët dhe personelin akademik GVJ u njoh dhe me një anketë të veçantë që ishte organizuar në këtë program ku në fokus ishte problematika e hasur nga kushtet dhe rrethanat e zhvillimit të procesit mësimor nën efektin e masave dhe protokolleve antiCovid-19, si një</p>

	<p>rast specifik për studentët, personelin akademik apo dhe administratën e institucionit).</p> <p>Evidenca nr. 42 Formular i vlerësimit të performancës së stafit.pdf Evidenca nr. 43 Rregullorja e anketave dhe vlerësimeve.pdf Evidenca nr. 44 Anketa e posaçme realizuar në kushtet e pandemisë Covid-19.pdf</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>Studentët, siç është përmendur më sipër, kanë akses për të dhënë mendime, perceptime a vlerësime konkrete mbi format e metodave të mësimdhënies nga personeli akademik dhe ai ndihmës. Anketa që ata plotësojnë në fund të dy semestrave është një hapësirë që shfrytëzohet nga Departamenti për tërheqjen e mendimit të tyre, për dinamikën e zhvillimit të kurrikulës (orët e leksioneve, seminareve, dorëzimi i detyrave të kursit, aktivizimi te Laboratori i Multimedias, përballimin e praktikës profesionale, apo periudha e përgatitjes dhe mbrojtjes së tezës së diplomimit etj), ka ndikim në përmirësimin e cilësisë dhe përshtatjes me kërkesat e tregut të punës.</p> <p>Gjatë bashkëbisedimit me studentët, ose në intervista të lira me ta, ata pranuan se dhe për raste të ankesave apo çështjeve individuale që kërkojnë të ngrenë, gjejnë suport tek kordinatori i programit, që bëhet garant për përcjelljen në instancat përkatëse.</p> <p>Për rastet e ankesave në vlerësimin e njohurive ndiqej një procedure me afat të përcaktuar, mbi mënyrën se si studenti paraqet ankesën për vlerësimin si dhe ngritjen e komisionit për shqyrtimin e rastit në diskutim. Gjatë semestrit të parë nuk ishte regjistruar rast i tillë, por gjithësesi studentëve iu ish in bërë të njohura procedurat.</p> <p>Evidenca nr. 45 Anketa vlerësuese për lëndën dhe pedagogun nga studentët.pdf Evidenca nr. 46 Raport i Këshillit studentor.pdf Evidenca nr. 7 Rregullorja e programit të studimit “Master professional” në “Komunikim Marketingu”.pdf</p>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>Gjetjet dhe rezultatet e vlerësimit që bëhet për sigurimin e cilësisë së mësimdhënies kanë destinacion: secilit prej pedagogëve iu shkon në mënyrë të individualizuar; treguesit në përgjithësi për të gjithë IAL-në janë pjesë e raportit vjetor që adresohet në Ministrinë e Arsimit, Sporteve dhe Rinisë. Ky shkarkohet virtualisht dhe në faqen online të KU Bedër. NJSBC-ja koordinon punën mes njësisë bazë dhe hallkave hierkike që për rastet kur kërkohet ndërhyrje përmirësimi për lëndë/module të veçanta për të mos cënuar aspektet e cilësisë në mësimdhënie. NJSBC-ja bazuar në raportet vlerësuese që vijnë nga departamentet të hartohet material përmbledhës në rang KU Bedër.</p> <p>Evidenca nr. 47 Procedura e vlerësimit të performancës së stafit akademik.pdf</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Mekanizëm nxitës për nxitjen dhe inkurajimin e personelit akademik në përmirësimin e cilësisë është trajnimi sipas fushës së ekspertizës ku ata janë përfshirë. Trajnimet dhe kualifikimet që menaxhohen nga afër nga NJSBC-ja afishohen në rang fakulteti dhe Departamenti, por në tërësinë e tyre shkarkohen dhe në faqen virtuale të KU Bedër. Funkcionaliteti i Komisionit</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

29

	<p>Përhershëm për Garantimin e Standardeve të Cilësisë Institucionale dhe të Programeve të Studimit është një tjetër instrument monitorimi, vlerësimi dhe asistencë për personelin akademik, qoftë me kohë të plotë, qoftë me kohë të pjesshme. KU Bedër si institucion, apo njësi përbërëse të tij janë përfshirë në programe dhe projekte ndërkombëtare, ose me partnerë të huaj, që ndihmojnë në ngritjen e potencialit kërkimor shkencor të trupës akademike, në shkëmbim përvojash por dhe evidentimin e promovimin e shembujve dhe praktikave më pozitive dhe efikase në shërbim të realizimit të kurrikulës së planifikuar.</p> <p>Evidenca nr. 48 Vendim i senatit për miratimin e ngritjes së komisioneve të përhershme.pdf Evidenca nr. 49 Raporti vjetor i Departamentit të Shkencave të Komunikimit, viti akademik 2018-2019.pdf Evidenca nr. 50 Certifikata pjesëmarrje të personelit akademik në aktivitete ndërkombëtare.pdf Evidenca nr. 24 Raporti vjetor i Departamentit të Shkencave të Komunikimit, viti akademik 2019-2020.pdf</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2

Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë: leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Nisur nga tiparet e funksionalitetit të programit të studimit MP “Komunikim Marketingu” mësimdhënien, mësimnxënien dhe transmetimi i dijeve dhe shprehive bazohet tek realizimi i planifikuar i leksioneve, seminarëve, detyrave të kursit, projekteve, praktikës profesionale apo orët e hapura. Këto forma janë përshtatur në këtë vit akademik që ende nuk është finalizuar (2020-2021) edhe me masat dhe protokollet kundër përhapjes së Covid-19, duke stimuluar zhvillimin e procesit në distancë.</p> <p>Për një program studimit MP, ku gjithmonë pjesa e aplikimeve ka një peshë të konsiderueshme në kurrikul, kjo i ka vështirësuar proceset nga distanca mes studentëve dhe pedagogëve të lëndëve/moduleve. Por nga bashkëbisedimi me studentët që ndjekin programin MP “Komunikim Marketingu” ata pranuan se ishin përshtatur në kushtet e auditorit virtual, duke realizuar lëndët e planifikuara sipas programit, me aplikimin e metodave interaktive në marrëdhëniet me stafin akademik, qoftë me kohë të plotë, qoftë me kohë të pjesshme dhe duke shfrytëzuar në maksimum aksesin dhe opsionet e platformës online që ka vënë në dispozicion KU Bedër.</p> <p>Tabelat e planit mesimor-Master Profesional ne komunikim marketingu.pdf</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'i përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma,</p>	<p>Reflektimi ndaj diversitetit dhe nevojave të studentëve në format e mësimdhënies dhe mësimnxënies bazohet në marrjen në konsideratë të mendimeve, perceptimeve dhe propozimeve të tyre, qofshin këto nga</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

30

<p>mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti, reagimet e studentëve dhe është i hapur për të përmirësuar mësimdhënien e tij.</p>	<p>përgjigjet që ata japin në anketat e fundsemestrit, apo dhe kur ato adresohen për koordinatorin e programit në Departament.</p> <p>Kanal komunikimi për dëgjimin e zërit të studentit janë dhe nga përfaqësimi i tyre në mbledhjet e departamentit. Në konsideratë merren dhe raste të atyre studentëve që kanë nevoja të veçanta, duke i krijuar dhe akses për orë dhe vëmendje shtesë, por dhe metodologji të përshtatshme për kryerjen e detyrave dhe projekteve prej tyre.</p> <p>Evidenca nr. 34 Rregullorja e Studimeve dhe Provimeve të Ciklit të Dytë.pdf Evidenca nr. 7 Rregullorja e programit të studimit “Master professional” në “Komunikim Marketingu”.pdf</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni duhet të mundësojë përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>Përmirësimi i metodave inovative për zhvillimin e kurrikulës, shikohet nga anëtarët e stafit akademik si një proces që përmirësohet kohë pa kohë, si vetëreflektim i vetë pedagogëve, në rishikimin e syllabuseve e futjes së metoda të reja të prezantimit dhe diskutimit mbi tematikën e lëndës/modulit, por dhe nga propozimet e problematikat që ngrenë studentët. KU Bedër ka një traditë të konsoliduar në aktualizimin e programeve të studimit, duke ndërhyrë për përmirësime që të maksimalizohet kontributi i stafit akademik dhe pjesëmarrja e studentëve në gjithë procesin e zhvillimit të kurrikulës, si alternativim mes dijeve e njohurive teorike me shprehi praktike profesionale.</p> <p>Evidenca nr. 6 Plani strategjik Institucional i KU “Bedër” 2018-2023.pdf Evidenca nr. 52 Lista e trajnimeve të organizuara për stafin 2014-2020.pdf Shtojca 1: tabelat</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>Studenti që frekuenton programin MP “Komunikim Marketingu” njihet me format e zhvillimit të lëndëve që në syllabus-et që shpërndahen nga pedagogët përkatës që në fillim të vitit. Njohja dhe familjarizimi me temat përbërëse të lëndës/modulit. Nga ana tjetër, ka përpjekje nga KU Bedër, që në programet e studimit të ketë pjesmarrje të pedagogëve që kanë grada dhe tituj shkencorë dhe të ketë sinkroni mes natyrës së lëndës/modulit me fushën e ekspertizës së pedagogut, aty ku ai ka kualifikime dhe përvoja më të thelluara.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Mendimet dhe propozimet e studentëve mbërrijnë në departament, si njësi bazë, por dhe në instancat e tjera hierarkike të KU Bedër, përmes angazhimit të tyre në realizimin e anketave periodike të fundsemestrit, apo dhe kur ato adresohen për koordinatorin e programit. Hapësirë e drejtpërdrejt e komunikimit për dëgjimin e zërit të studentëve janë dhe nga përfaqësimi i tyre në mbledhjet e departamentit.</p> <p>Evidenca nr. 45 Anketa vlerësuese për lëndën dhe pedagogun nga studentët.pdf Evidenca nr. 47 Procedura e vlerësimit të performancës së stafit akademik.pdf Evidenca nr. 44 Anketa e posaçme realizuar në kushtet e pandemisë Covid-19.pdf</p>
<p>Kriteri 6. Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi duke i bërë tërheqëse orët e mësimin.</p>	<p>Sikundër u përmend në vlerësimet e mësipërme, zhvillimi i programit këtë vit akademik në auditorët virtualë, kjo nuk ka penguar personelin akademik me kohë të plotë ose të pjeshme, që në forma të përshtatura me komunikimin në distancë të përmbushë realizimin e temave/aspekteve të planifikuara. Studentët pranuan se zhvillimi i orëve të leksioneve, seminareve dhe</p>

	<p>prezantimeve kishte interaktivitet mes tyre dhe drejtuesve të lëndëve/moduleve, duke iu siguruar orientimin efektiv për procesin e përgatitjes për shlyerjet, detyrat e kursit dhe provimet. Kontaktet e tyre me pedagogët vijonin dhe në kontakte të veçanta përmes përdorimit të platformës, në sqarimin e çështjeve me karakter specifik. Komunikimi në distancë, nuk pengoi dhe pjesmarrjen përmes platformës virtuale dhe të ftuarve, si ekspertë dhe profesionistë në tema të caktuara të programit, duke plotësuar dhe konkretizuar njohuritë dhe shprehitë e studentëve.</p>								
<p>Kriteri 7. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Programi që kemi në shqyrtim lë hapësira për punë të pavarur nga studentët, për të nxitur mendimin dhe vlerësimin e tyre kritik mbi tema që diskutohen brenda dhe jashtë, për të shtyrë vetvëprimin e tij në produktet konkrete që kryen gjatë dy semestreve të vitit akademik (detyra kursi, prezantime, realizimi i praktikës profesionale apo te procesi i konceptimit dhe zhvillimit të tezës së diplomimit).</p> <p>Kurrikula e organizuar në propozicion me zhvillimin e pjesëve teorike shkencore, me qasjen drejt lëndëve të profilizuara, apo me kryerjen e detyrave praktike profesionale krijojnë vend dhe për rolin drejtues e menaxhues të pedagogut, po ashtu dhe pavarësinë në performancën e studentit, në ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p> <p>Evidenca nr. 53 Syllabuset e lëndëve të programit.pdf Evidenca nr. 54 Guida e Stafit.pdf Evidenca nr. 35 Guida e Studentit.pdf</p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi III.3 Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional, duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Procesi mësimor e shkencor, realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.</p>	<p>Programi i studimit MP “Komunikim Marketingu” zhvillohet në të njëjtat mjedise ku zhvillojnë mësimin dhe programet e tjera në dy ciklet të KU Bedër, një godinë me dy pjesë, që sapo është rikonstruktuar dhe mirëpërshtatur për aktivitet universitar, me arredim dhe interior funksional në vendosjen e përshtatshme të grupeve dhe kurseve, varësisht nga natyra e kurrikulës që ndjekin. GVJ i vizitoi mjediset ku është lokalizuar dhe programi i studimit që është në fokus dhe u identifikuan hapësira, sistemet e ndriçimit dhe të ngrohje – ftohjeve, por dhe inventarin kolektiv dhe individual në shërbim të studentëve, elementë që janë të mjaftueshëm dhe krijojnë komfort për studentët, stafin akademik apo personelin administrative të institucionit.</p> <p>Evidenca nr. 55 Udhëzimi nr.11, datë 28.02.2011 MASH.pdf Evidenca nr. 56 Kontrata me kompaninë Albpastrim.pdf Shtojca 1 Tabelat (tabela 16_Mjediset e fakultetit)</p>
<p>Kriteri 2. Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë</p>	<p>Gjatë vizitës në mjediset ku zhvillon kurrikulën MP “Komunikim Marketingu” GVJ identifikoi dhe faktin që brenda auditorëve krijoheshin</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

32

<p>funkionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor dhe praktikave.</p>	<p>kushte mbështetje për qëndrimin, për prezantimet (me tekst, audio, video), si dhe linja për internet free (wireless) – të cilat i shërbejnë komunikimit, interaktivitetit dhe procesit të kërkimit. Logjistika është e përshtatshme për punën në kushtet individual ose në grup, të ngjashme me mjediset reale të punës në subjekte e institucione publike dhe jo publike.</p> <p>Shtojca I Tabelat Evidenca nr. 57 Rregullorja mbi marrjen e masave higjeno-sanitare për parandalimin e përhapjes së infeksioneve respiratore akute përfshirë dhe Covid-19.pdf</p>
<p>Kriteri 3. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesin mësimor.</p>	<p>Në kushtet e masave dhe protokolleve antiCovid-19, të cilat diktuan në të gjithë sistemin universitar të vendit zhvillimin e kurrkulës në distance. Po kështu dhe në KU Bedër, përfshirë dhe programin e studimit që është në fokus. Infrastruktura IT është shumë e rëndësishme veçanërisht për vijimin në kushte të tilla.</p> <p>Adresa e emailit që hapet nga KU Bedër @beder.edu.al është një standard i detyrueshëm për çdo student pas aktit të regjistrimit në një program studimi. Përmes kësaj adrese ai vendos komunikimin me studentët e tjerë, me pedagogët e lëndëve/moduleve, me administratën e institucionit, të departamentit etj., në shkëmbimin e informacionit për udhëzimet, funksionalitetin, vlerësimet e testeve e detyrave etj. Përmes kësaj adrese studenti aksesohet në Sistemin Interaktiv Beder (BIS); gjithashtu dhe aksesohet në platformën virtuale G-SUITE, që KU Bedër ka aplikuar për zhvillimin e kurrkulës në kushtet e masave dhe protokolleve anti-Covid-19 të autoritetit shëndetësor. Falë asistimit teknik dhe teknologjik të dy akseset kanë qenë funksionale dhe kanë lehtësuar proceset e zhvillimit të kurrkulës - pohuan studentët e MP “Komunikim Marketingu” gjatë bashkëbisedimit me ta.</p> <p>Evidenca nr. 58 Udhëzues i sistemit informativ (BIS).pdf Evidenca nr. 59 VKM nr. 418, dt. 10.05.2017.pdf</p>
<p>Kriteri 4. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.</p>	<p>Programi i studimit MP “Komunikim Marketingu” zhvillohet në shqip, por lëndë të veçanta kanë pjesën më të mirë të literaturës në gjuhë të huaj. Që në fazën e shpërndarjes së syllabus-eve titullarët e lëndëve/moduleve njohin studentët dhe me pjesë e literaturës bazë dhe ndihmëse, duke shpjeguar aspekte të pjesëve dhe temave më të rëndësishme që janë si referencë për dijet dhe shprehitë profesionale që marrin.</p> <p>Paralelisht me ndjekjen e këtij procesi, departamenti ku përfshihet programi ndjek dhe pasurimin e bibliotekës së institucionit me ato tituj publikimesh në shqip dhe gjuhë të huaj, për të pasur disa kopje të këtyre botimeve në shërbim të studentëve, por dhe stafit akademik, me kohë të plotë ose të pjesshme.</p> <p>Evidenca nr. 16 Marrëveshja me JSTOR.pdf</p>
<p>Kriteri 5. Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira</p>	<p>Përveç informacionit që ka dhënë grupi që ka punuar me hartimin e raportit të vlerësimit të brendshëm të programit në fokus, GVJ vizitoi mjediset e bibliotekës, duke i ndalur më shumë tek oferta e publikimeve për studentët e Shkencave të Komunikimit në përgjithësi dhe posaçërisht ata të MP</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

33

<p>të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>“Komunikim Marketingu”. Pjesa më e madhe e publikimeve është në shqip, por ka dhe në gjuhë të huaj, më shumë në anglisht.</p> <p>Mjediset e bibliotekës janë konfort për të punuar, apo kërkuar material që ke interes, ku non stop mund të lundrosh në internet nga Wi-Fi, ndërkohë që punonjësi i bibliotekës orienton studentët apo personelin akademik që është në ato mjedise. Ndarja sipas fushës së studimit në raftë krijon lehtësi në orientimin e tyre. Fondi ka nevojë për tituj të rinj dhe të publikuar në vitet e fundit që nevojiten për studentët e PS MP në “Komunikim Marketingu”.</p> <p>Gjatë vizitës në bibliotekë GVJ u njoh dhe me nismën pasuruese për fondin e saj, nga zbatimi i projektit studentor "<i>Libri është i vetmi kopsht që mbillet për të tjerët</i>". Kjo ishte një fushatë sensibilizimi për pasurimin e fondit të bibliotekës, e ndërmarrë nga studentët e Departamentit të Shkencave të Komunikimit, me efekt grumbullimin e rreth 10 mijë librave. Një pjesë e tyre u përdor për pasurimin e bibliotekës së institucionit, ndërsa pjesa tjetër u dhurua për shkolla, institucione të tjera dhe grupe në nevojë. Nga një sasi librash të dhuruar nga Ambasada e SHBA-ve në Tiranë, 218 libra ishin specifike për Departamentin e Shkencave të Komunikimit.</p> <p>Gjatë gjithë kohës së masave dhe protokolleve shtrënguese nga përhapja e koronavirusit biblioteka ka qenë e hapur, për t'i shërbyer studentëve dhe personelit akademik.</p> <p>Evidenca nr. 60 Buxheti i Departamentit të Shkencave të Komunikimit.pdf Evidenca nr. 16 Marrëveshja me JSTOR.pdf</p>
<p>Kriteri 6. Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>Biblioteka e KU Bedër ka sistem të automatizuar të ofertës, duke listuar dhe skeduar elektronikisht inventarin që ka gjendje. Por sistemi automatizuar jep akses për studentët që të shfrytëzojnë dhe bibliotekën dixhitale JSTOR, e krijuar 25 vite më parë që qarkullon përmbajtje kërkimore dhe studimore nga vende e autorë në fusha të ndryshme, mes tyre dhe e Shkencave të Komunikimit. Aksesimi për studentët asistohet me shpjegime dhe udhëzime nga punonjësit e bibliotekës, ose nga personeli akademik.</p> <p>Evidenca nr. 60 Buxheti i Departamentit të Shkencave të Komunikimit.pdf Evidenca nr. 16 Marrëveshja me JSTOR.pdf</p>
<p>Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike, shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</p>	<p>Pjesë e infrastrukturës ku punojnë studentët e Shkencave të Komunikimit (përfshirë dhe ata të MP “Komunikim Marketingu”) janë dy salla të mirëpajisura me rrjet kompjuterash ku janë të instaluar aplikacione e programe të nevojshme për detyrat dhe funksionet e domosdoshme gjatë zhvillimit të kurrikulës. Sallat kanë qenë hapur dhe të gatshme për t'u shfrytëzuar (duke respektuar masat e protokollit anti-Covid-19) gjatë periudhës së pandemisë. Ato po ju vlejnë aktualisht studentëve të programit që është në fokus dhe për shkrimin e tezës së diplomimit.</p> <p>Shtojca I Tabelat (tabela 16_Mjediset e fakultetit)</p>
<p>Kriteri 8. Në funksion të mësimdhënies, personelin akademik përdor platforma on-line</p>	<p>Kjo ka qenë e detyrueshme në kushtet kur mësimi gjatë vitit akademik 2020-2021 u zhvillua në distancë. Studentët dhe personeli akademik ka përdorur</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

34

(elearning) dhe mbështet e nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.	platformën virtuale G-SUITE si dhe sistemin e brendshëm të komunikimit BIS.								
Kriteri 9. Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirë vetjake të dedikuar.	Masat dhe protokollet antiCovid-19 gjatë këtij viti akademik nxorrën në pah domosdoshmërinë e shfrytëzimit të platformës virtuale G-SUITE, përmes të cilës realizohej niveli i komunikimit në distance student – pedagog, student – administrate e institucionit/ departamentit, qoftë në nivel bilateral, qoftë dhe në nivel grupi. Zhvillimi i seanceve virtuale të mësimi, organizimi i quiz-eve, prezantimeve, diskutimeve në grup etj., realizoheshin falë aftësive multifunkionale të ofruar nga G-SUITE. Nga ana tjetër për qarkullimin e informacionit mbi zhvillimin e kurrikulës, syllabus-ve, vlerësimeve të detyrave/testeve, apo njoftime korrente, teste ishte sistemi i komunikimit të brendshëm, BIS. Evidenca nr. 58 Udhëzues i sistemit informativ (BIS).pdf								
Kriteri 10. Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave, asistion dhe mbështet në zhvillimin e tyre.	Orientimi i personelit akademik për përzgjedhjen e tezave të diplomimit ka filluar që në gjysmën e semestrit të parë, por me fillimin e semestrit të dytë ky interesim u intensifikua më shumë që në fillim të semestrit të dytë, duke arritur te objektivi që secili prej studentëve të pajiset me temën dhe ka përcaktuar pedagogun udhëheqës. Pikërisht ky i fundit ndjek duke e orientuar dhe mbështetur më shumë studentin në procesin e shkrimit të tezës së diplomimit dhe për të arritur te mbrojtja para komisionit. Evidenca nr. 62 Syllabus lënda “Teza”.pdf								
	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përbushet pjesërisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>		Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht				X
	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht						
			X						

Standardi III.4

Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë, aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.	KU Bedër ka ndërtuar një infrastrukture në mbështetje të nxitjes së përmirësimit të cilësisë në mësimdhënie. Menaxheri kryesor është Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), e cila bashkëvepron me çdo hallkë shkencore dhe administrative në institucion. Tjetër është dhe Komisionin i Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë Institucionale, që si organ kolegjal, orientohet të kryejë angazhime konkrete në favor të garantimit dhe qëndrueshmërisë për standardet e cilësisë institucionale në programet e studimit në KU Bedër.
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë është përgjegjëse për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.	Në mënyrë hierarkike kontributi i këtyre dy hallkave të rëndësishme kapet nga këshilli i departamentit, që vepron në mënyrë kapilare, në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Sikundër u përmend dhe në kriterin e mëparshëm, njësia bazë, departamenti vepron në mënyrë kapilare për përmirësimin e cilësisë në mësimdhënie.

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

35

	<p>Anketat me studentët, që realizohen në fund të dy semestrave të vitit akademik janë një bazë e mire gjetjesh dhe treguesish për gjendjen dhe për mënyrën se si dijet dhe shprehite profesionale mbërrijnë të studentët. Duke ja përcjellë këto rezultate dy hallkave në rang institucional: Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Komisionit të Përhershëm për Sigurimin e Cilësisë Institucionale, problematikat dhe nevojat e shfaqura vendosen në axhendën e punës së të gjitha njësive për ndërhyrje aty ku duhet në favor të masave efikase që çojnë në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe performances kërkimore e shkencore.</p> <p>Evidenca nr. 63 Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e KP për garantimin e standardeve të cilësisë.pdf Evidenca nr. 64 Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e NJSBC.pdf Evidenca nr. 65 Shkresa nga NJSBC te HR.pdf Evidenca nr. 43 Rregullorja e anketave dhe vlerësimeve.pdf Evidenca nr. 44 Anketa e posaçme realizuar në kushtet e pandemisë Covid-19.pdf Evidenca nr. 45 Anketa vlerësuese për lëndën dhe pedagogun nga studentët.pdf Evidenca nr. 46 Raport i Këshillit studentor.pdf Evidenca nr. 47 Procedura e vlerësimit të performancës së stafit akademik.pdf Evidenca nr. 66 Anketa Vlerësuese nga Stafi Akademik ndaj institucionit.pdf</p>
<p>Kriteri 3. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>Në realizimin e ciklit të leksioneve dhe orët e seminareve, personeli akademik aplikon metoda inovative që të tërheqin sa më shumë interesin e studentëve, ta bëjnë edhe më interaktive orën e mësimin, duke i ndërtuar prezantimet në forma grafike dhe të animuara për të theksuar aspekte dhe çështjet më relevante gjatë trajtimit të temave të ndryshme.</p> <p>Në kushtet e mësimin në distancë nga masat dhe protokollet antiCovid-19, kur komunikimi për realizimin e kurrikulës është zhvilluar përmes platformës virtuale format e mësimdhënies janë përshtatur për të siguruar vëmendje dhe më të madhe për studentët.</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik dhe ai mbështetës kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Duke bashkëpunuar me Zyrën e Kërkimit Shkencor dhe me Departamentin ku përfshihet, personeli akademik dhe ai mbështetës ndjek periodikisht agjenda për kualifikimin në fushën e kërkimit dhe studimit shkencor, për të ndikuar në përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. Pjesëmarrja në projekte kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare, ndjekja me prezencë dhe punime në konferenca, seminare, workshope a evente të ndryshme shkencore janë një mundësi konkrete për aktualizimin dhe thellimin e njohurive të fushës së angazhimit, është një mundësi për të shikuar dhe vlerësuar performancën e njësive, institucioneve të tjera ndërkombëtare, si dhe për vendosjen e urave të komunikimit dhe bashkëpunimit të qëndrueshëm me to. Gjatë takimit me personelin akademik u prezantuan raste kur KU Bedër ka ndihmuar dhe mbështetur pedagogët për pjesëmarrje dhe kontribut në evente të tilla shkencore jashtë vendit.</p> <p>Evidenca nr. 6 Plani strategjik Institucional i KU "Bedër" 2018-2023.pdf Evidenca nr. 67 Procedura e mbështetjes së pjesëmarrjes në konferenca nga KU Beder.pdf Evidenca nr. 49 Raporti vjetor i Departamentit të Shkencave të Komunikimit, viti akademik 2018-2019.pdf</p>

	Evidenca nr. 24 Raporti vjetor i Departamentit të Shkencave të Komunikimit, viti akademik 2019-2020.pdf
Kriteri 5. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajtojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.	<p>Sikundër dhe shpjeguar në kriterin e mësipërm, pjesmarrja në projekte kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare, ndjekja me prezencë dhe punime në konferenca, seminare, workshope a evente të ndryshme shkencore janë një mundësi konkrete për aktualizimin dhe thellimin e njohurive të fushës së angazhimit, është një mundësi për të shikuar dhe vlerësuar performancën e njësisve, institucioneve të tjera ndërkombëtare, si dhe për vendosjen e urave të komunikimit dhe bashkëpunimit të qëndrueshëm me to. Kjo jep ndikim të drejtpërdrejtë për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.</p> <p>Evidenca nr. 52 Lista e trajnimeve të organizuara për stafin 2014-2020.pdf</p>
Kriteri 6. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimit dhe angazhohen për përmirësimin e mësimdhënies dhe implementimin e metodave të reja.	<p>Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik i kushtojnë rëndësi realizimit të ciklit të leksioneve dhe orëve të seminareve, duke synuar aplikimin e metodave bashkëkohore që të tërheqin sa më shumë interesin e studentëve, ta bëjnë edhe më interaktive orën e mësimin, duke i ndërtuar prezantimet në forma grafike dhe të animuara për të theksuar aspekte dhe çështjet më relevante gjatë trajtimit të temave të ndryshme.</p> <p>Në kushtet e mësimin në distancë nga masat dhe protokollet antiCovid-19, kur komunikimi për realizimin e kurrikulës është zhvilluar përmes platformës virtuale, format e mësimdhënies janë përshtatur për të siguruar vëmendje dhe më të madhe për studentët.</p> <p>Evidenca nr. 2 Statuti i Kolegjit Universitar Bed ½r.pdf Evidenca nr. 6 Plani strategjik Institucional i KU “Bedër” 2018-2023.pdf Evidenca nr. 36 Vendimi i Këshillit të Departamentit për ngarkesën mësimore.pdf</p>
Kriteri 7. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.	<p>Duke qenë se aplikohet për herë të parë këtë viti akademik, 2020-2021, me mbarimin e tij, do të organizohet nga Departamenti ku përfshihet programi studimor dhe nga Fakulteti i Shkencave Humane dhe Drejtësi një analizë e thelluar mbi rezultatet dhe problematikat e identifikuara. Kjo do ta ndihmojë këtë program të ri që të jetë në shtrat të sigurtë për cilësinë e mësimdhënies. Do të merren në konsideratë dhe vlerësimet e studentëve të shprehura në dy anketat e këtij viti akademik, si dhe gjetje të monitorimeve të drejtpërdrejta që ka kryer njësisia bazë, departamenti.</p>
Kriteri 8. Institucioni në kuadër të bashkëpunimeve dhe përfshirjes së partnerëve në procesin mësimor angazhon në faza të ndryshme të programit të studimit lektorë dhe kërkues shkencorë për shkëmbim të ideve dhe metodave të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.	<p>Në Shkencat e Komunikimit, ku pëfshohet dhe programi i studimit që është në fokus në mënyrë sistematike ftohen të jenë lektorë apo të prezantojnë tema me karakter kërkimor dhe shkencor përfaqësues të institucioneve akademike si dhe nga subjekte e sipërmarrje në industrinë mediatike. Ata kontribuojnë për trajtimin e temave specifike, që janë brenda natyrës së fushës që mbulon programi, duke ndikuar dhe ndihmuar në thellimin e njohurive për studentët, duke nxitur debatin në rradhët e tyre dhe personelit akademik mbi dukuri e prirje të aktualitetit dhe të perspektivës. Kjo mbetet një vlerë e shtuar për investimin që bën programi në përgatitjen e studentëve duke injektuar promovimin dhe pasionin për punën individuale dhe në grup në drejtim të kërkimit shkencor. Situata e Covid-19 ka dhënë impakt jopozitiv për</p>

	<p>realizimin e një kalendari të tillë shkencor të të ftuarve në auditor, duke u përpjekur që ky standard të vijojë aq sa mundet përmes takimeve të organizuara virtualisht.</p> <p>Evidenca nr. 68 Lista e aktiviteteve me partnerë të jashtëm.pdf</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi III.5

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësiwe profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësiwe profesionale përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Mbi kriteret dhe mënyrat e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësiwe profesionale studentët e KU Bedër njihen parapakisht që para se ata të regjistrohen në programin studimor që dëshirojnë të përfshihen. Edhe në javën e parë të fillimit të vitit akademik, ata marrin në mënyrë të detajuar info dhe njohuri të shumëanshme mbi kurrikulën, ku një aspekt është dhe kriteret e mënyrat e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësiwe profesionale, shoqëruar dhe me prezantimin e të gjitha akteve nënljgore (rregullore, vendime, udhëzime etj.) që lidhen me këto aspekte. Publikimi “Guida e Studentit 20” është përmbajtje orientuese dhe familjarizuese me angazhimin e tyre brenda dhe jashtë auditorëve. Shfletimin e këtij botimi student mund ta bëjë në çdo kohë pasi është shkarkuar në website-n zyrtare të KU Bedër.</p> <p>Duke shqyrtuar përmbajtjen e rregullores se programit që është në fokus të këtij vlerësimi, si dhe rregulloren themelore e KU Bedër, të fakultetit, si dhe rregulloren e studimeve dhe provimeve të ciklit të dytë evidentohet se informacioni është shumë i bollshëm dhe i dobishëm, që ndihmon studentët të jenë të njohur me kriteret dhe mënyrat e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësiwe profesionale.</p> <p>Evidenca nr. 35 Guida e Studentit.pdf Evidenca nr. 69 Model Kontrate.pdf</p>
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësiwe profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Fillimi i semestrit, që përkon dhe me fillimin e zhvillimit të lëndëve/moduleve të planifikuara është dhe momenti kur studentët pajisen me syllabus-et e titullarit të lëndëve/moduleve, duke marrë informacion krahas temave dhe aspekteve që do të trajtohen, edhe metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësiwe profesionale e shkencore. Kjo shoqërohet dhe me detyrimet konkrete që duhet të realizojë studenti para se të zhvillojë provimin, duke sqaruar dhe strukturën e ndërtimit të notes, ku:</p> <ul style="list-style-type: none"> • 5-10% e ka pjesëmarrja; • 10-20% e ka plotësimi i detyrimeve; • 20-30 % e kanë testimet e realizuara gjatë vitit akademik dhe • 40-50% e ka teza e diplomës.

	Në çdo kohë studenti mund të konsultohet me detajet e këtij informacioni, duke u aksesuar në hapësirën virtuale në dispozicion, qoftë në sistemin BIS, apo përmes lëndës së website-t zyrtar të KU Bedër. Shtojca 1 Tabelat (15) Evidenca nr. 14 Shembull i syllabusi- Syllabus i lëndës Reklama dhe Promocioni.pdf								
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Nga fillimi i zhvillimit të lëndës/modulit studenti kalon në forma të ndryshme testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore deri sa mbërrin te provimi final. Nga bashkëbisedimi me studentët e programit MP “Komunikim Marketingu” ata pranuan se gjatë zhvillimit të kurrikulës në të dy semestrat ishin përfshirë në forma të ndryshme të kontrollit të njohurive, si testi pjesor, detyra kursi, projekte individuale ose në grup dhe prezantime. Këto forma ishin një skanim i njohurive të përfuara prej tyre dhe pedagogët e kishin dhe më të qartë ecurinë e secilit prej tyre para se të zhvillohej provimi final për lëndën, por dhe ndihmonin studentët që të përshfaqnin dijet dhe kompetencat e fituara. Kjo mënyrë vlerësimi në forma të ndryshme dhe në momente të ndryshme gjatë zhvillimit të lëndës/modulit krijonin besim dhe siguri për studentët për rezultatin e fituar, bazuar në rezultatet që kishte arritur. Evidenca nr. 53 Syllabuset e lëndëve të programit.pdf Shtojca 1 Tabelat (15)								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi III.6

Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar.	Studentët e programit MP “Komunikim Marketingu” kanë marrë informacion paraprak për mbi testimin dhe vlerësimin e dijeve në lëndë/module, që në javën e parë të fillimit të vitit akademik, nga set-i i syllabuseve që kanë marrë apo nga sqarimet e pedagogëve të lëndëve. Tek të gjitha lëndët kanë pasur të paktën dy kontrole dijesh, një testi i ndërmjetëm, dhe tjetri testi final (provimi). Por në varësi të ndërtimit dhe organizimit të lëndës nga pedagogët format e kontrollit të dijeve kanë përfshirë dhe detyrat e kursit, prezantimet etj., të cilat janë një bazë e mirë për pedagogun (titullarin e lëndës/modulit) për të arritur tek vlerësimi përfundimtar. Kjo ndihmon dhe studentin që të jetë gjatë gjithë semestrit i angazhuar dhe mobilizuar për përballimin e formave të ndryshme të kontrollit të dijeve dhe për t’ja lehtësuar përballimin e provimit final të lëndës. Evidenca nr. 3 Rregullorja themelore e KU Bedër.pdf Shtojca 1 Tabelat (15)
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat	KU Bedër për komunikimin e brendshëm mes studentëve dhe titullarit të lëndës/modulit përdor sistemin BIS, ku lëshohen individualisht njoftimet e studentit për vlerësimin në provime, po ashtu dhe ruajtja e tyre. Përmes

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

39

<p>eliminonjë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>platformës virtuale G-Suite në lëndë/module të ndryshme realizohen teste dhe kontrole online që nuk lënë shteg për abuzim dhe kanë transparencë.</p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi përfundimtar i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë, ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Në standardin e KU Bedër testimi e vlerësimi përfundimtar i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga një komision që ka në përbërje dy anëtarë, njëri prej të cilëve është titullari i lëndës. Kontrolli për detyrat e kursit, prezantimet apo produkte të ndryshme bëhen nga pedagogu titullar dhe asistenti i tij. Ndërsa për tezat e diplomës, të cilat nuk janë kryer për këtë vit akademik ende, do të ketë një komision me tre anëtar, njëri prej të cilëve është udhëheqësi i tezës. Komisioni zgjidhte nga këshilli i Departamentit dhe ju bëhet me dije paraprakisht studentëve, të paktë një muaj para.</p> <p>Evidenca nr. 34 Rregullorja e Studimeve dhe Provimeve të Ciklit të Dytë.pdf Evidenca nr. 70 Vendim për ngritjen e jurive të tezave master.pdf</p>
<p>Kriteri 4. Testimi i vlerësimit të njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.</p>	<p>Në kushtet e masave dhe protokolleve antiCovid testimet u realizuan virtualisht, por duke aplikuar forma të kontrollit dhe monitorimit të zhvillimit të tyre. Nuk ka qenë e mundur për rastet e testeve virtuale format e sekretimit dhe kodifikimit që aplikohen në kushtet normale në KU Bedër (para peridhës së pandemisë Covid-19).</p>
<p>Kriteri 5. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/ feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënies për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>Gjithmonë para evidentimit (dokumentimit) të rezultateve të testeve ato ndahen me studentët. Titullari i përgjigjet interesimit të studentëve për aspekte ku ai nuk është i qartë për vlerësimin e bërë, apo pretendon një rezultat të ndryshëm. Argumentimi konkret ndihmon studentin të kuptojë për ato pjesë që nuk janë asimiluar mire, duke mbështetur atë të përmirësohet në të ardhmen. Pas këtij njoftimi paraprak që bën titullari për rezultatin e studentit, ai evidentohet (dokumentohet).</p>
<p>Kriteri 6. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik evitojnë dhe nuk tolerojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Departamenti i Shkencave të Komunikimit ju jep udhëzime studentëve të programeve të studimit (përfshirë dhe MP “Komunikim Marketingu”) për respektimin e rregullores për disiplinën e studentëve, ku dënohet kopja në provime dhe detyra, si dhe plagjiatura. Për këtë të fundit aktualisht ka në dispozicion aplikacioni shqyrtimit antiplagjiaturë që në pak kohë nxjerrin në pah raste potenciale të përdorimit pa reference ose pa të drejtë të përmbajtjeve të autorëve të tjerë. Shqyrtimi i rasteve të identifikuara bëhet përmes një komisioni që cakton Departamenti i cili propozon dhe masën përkatëse.</p> <p>Evidenca nr. 71 Rregullorja për disiplinën e studentëve.pdf</p>
<p>Kriteri 7. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Data e provimeve dhe koha e marrjes së vlerësimit janë të përcaktuara për programin studimor MP “Komunikim Marketingu”. Grafiku i datave të provimeve hartohet duke marrë dhe mendimin e studentëve, për renditjen e lëndëve në sezon. Realizimi i provimeve përmes platformës virtuale që përdor i gjithë KU Bedër jep mundësi për kontroll preciz dhe duke mënjanuar abuzimet apo stimulimet e notave të pamërituara. Dhe njoftimi për notat, sipas rregullores së Departamentit, bëhen me dije maksimumi brenda 1 jave, ku aplikohet, siç përmendëm më sipër, dhe njoftimi paraprak të çdo studenti për rezultatin individual në provim.</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

40

	Evidenca nr. 34 Rregullorja e Studimeve dhe Provimeve të Ciklit të Dytë.pdf			
Kriteri 8. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	E shpjeguar dhe më lart se, sipas standardit që aplikon KU Bedër, edhe në programin MP "Komunikim Marketingu" ka njoftim paraprak të vlerësimit të studentëve para se të evidentohet. Bazuar dhe në rregulloren e programit shikohet çdo rast që ka kontestim apo paqartësi për vlerësimin në provim, për të cilët departamenti ngre komision të posaçëm shqyrtimi. Nga bashkëbisedimi me studentët u pranua se deri më tani nuk ka pasur ndonjë rast të raportuar kontestimi mbi vlerësimin në provim.			
Kriteri 9. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.	Megjithëse nuk ka pasur deri më tani kontestim apo ankim për vlerësimin e studentëve (edhe për faktin se MP "Komunikim Marketingu" është një program studimi që ka filluar të zabtohet këtë vit akademik), Departamenti i Shkencave të Komunikimit pranë Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë ka procedura të qarta për t'u ndjekur. Ku i jepet e drejtë studentit të bëjë kërkesë dhe në afate të përcaktuara ngirhet komisioni për shqyrtimin e rastit. Evidenca nr. 7 Rregullorja e programit të studimit "Master professional" në "Komunikim Marketingu".pdf			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.7

Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuri të thelluara të kompetencave profesionale e shkencore.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	<p>Nga shqyrtimi i hollësishëm i kurrikulës, duke iu referuar lëndëve/moduleve përbërës dhe ngarkesës për secilën, si dhe nisur nga mendimet dhe qëndrimet që kanë studentët apo stafi akademik, krijohet bindje se MP "Komunikim Marketingu" ka të harmonizuar pjesën teorike, që zhvillohet në leksione e seminare, me pjesën e profilizuar dhe aplikative për praktikën profesionale, si dhe detyrat e kursit, prezantimet, orët e hapura etj. Kjo u ofron studentëve një set njohurish dhe konceptesh të domosdoshme për fushën ku janë përqëndruar, por dhe shprehi të punës profesionale e angazhimit që i ndihmon për të qenë sa më të gatshëm e konkurrues në tregun e punës.</p> <p>MP në Komunikim Marketingu" u ofron studentëve njohuri dhe dije bazë dhe specifike në këtë fushë. Krahas njohurive shkencore teorike, programi synon aftësimin praktik të studentëve nëpërmjet laboratorëve dhe praktikave. Aksesit që studentët kanë për të zhvilluar praktikën në institucione ose subjekte që janë afër natyrës së fushës së studimit ku po studjojnë është një investim i rëndësishëm për ta që të kontribuojnë aty si në kushtet e punës reale.</p> <p>Evidenca nr. 7 Rregullorja e programit të studimit "Master professional" në "Komunikim Marketingu".pdf Evidenca nr. 24 Raporti vjetor i Departamentit të Shkencave të Komunikimit, viti akademik 2019-2020.pdf</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

41

	Evidenca nr. 49 Raporti vjetor i Departamentit të Shkencave të Komunikimit, viti akademik 2018-2019.pdf
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, të komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	<p>Vetë shkencat e komunikimit dhe gazetaria janë drejtime që nga zhvillimi i vullshëm teknologjik dhe përhapja në shkallë të gjerë e internetit po ndryshojnë vullshëm (si e tillë dhe profili <i>komunikim marketingu</i> ku janë përfshirë studentët) ndaj dhe programi që është në fokus i përgjegjet kërkesave për nxitjen e aftësive të studentëve në teknologjinë e informacionit.</p> <p>Si laborator i multimedial, apo dhe sallat kryesore të zhvillimit të kurikulës garantojnë kushte për aplikimin e metoda bashkëkohore, duke vënë në përdorim aplikacione e programe që mundësojnë mjaft procese, që janë të ngjashme me kushtet e punës reale të së nesërme ku studentët aspirojnë, por dhe u jep atyre mundësi për vijimësinë e aktivitetit dhe produktit në kërkimin e studimit shkencor. Programi zhvillohet në gjuhën shqipe, por një pjesë e literaturës që ata përdorin është në gjuhë të huaj, kryesisht në anglisht.</p>
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.	<p>Jo vetëm nga anketa semstrale që zhvillohet me studentët për ecurinë e programit, por dhe nga diskutimet që organizon Departamenti, krijohen hapësira që përmes analizimit të situatës të ketë vlerësime realiste mbi gjendjen dhe të shikohen ndërhyrjet përmirësuese.</p> <p>MP “Komunikim Marketingu” është program i ri, por në Departament pranohet se ashtu si në programet e tjera të studimit për të dy ciklet, Bachelor dhe Master, do të ndiqen standardet e analizës për çdo element që lidhet me zhvillimin e kurikulës.</p> <p>Evidenca nr. 72 Anketë vlerësimi e menjimit të studentëve ndaj institucionit.pdf</p>
Kriteri 4. Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre dhe testin përfundimtar.	<p>Sqaruar në kriterin e mësipërm, që dhe për MP “Komunikim Marketingu” (sin ë programet e tjera të studimit) krijohen hapësira që përmes analizimit të situatës të ketë vlerësime realiste mbi gjendjen dhe të shikohen ndërhyrjet përmirësuese.</p> <p>Evidenca nr. 24 Raporti vjetor i Departamentit të Shkencave të Komunikimit, viti akademik 2019-2020.pdf Evidenca nr. 49 Raporti vjetor i Departamentit të Shkencave të Komunikimit, viti akademik 2018-2019.pdf</p>
Kriteri 5. Personeli akademik (i brendshëm ose i ftuar) realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.	<p>Veç organizimit të orëve të hapura me të ftuar ekspert dhe njohues të mire të fushës, për studentët e programit MP “Komunikim Marketingu” ka qenë dhe cikli i seminareve “MarCom” (Marketing & Komunikim) dhe cikli “Studenti dhe profesioni”, si akses edhe për student të tjerë nga programet e studimit që menaxhohen nga Departamenti i Shkencave të Komunikimit në Fakultetin e Shkencave Humane dhe Drejtësisë.</p> <p>Evidenca nr. 73 Plani i Aktiviteteve të Departamentit.pdf</p>
Kriteri 6. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.	<p>Vështirësitë e krijuara nga masat dhe protokollet e pandemisë Covid-19 dhe zhvillimi në distancë, nuk kanë penguar aksesin që kanë pasur studentët e MP “Komunikim Marketingu” për të shfrytëzuar infrastrukurën e Laboratorit të Multimedias, apo sallat funksionale që janë të pajisura me kompjutera ku janë të instaluar aplikacione e programe të dobishme që lehtësojnë e mbështesin</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

42

	detyrat, prezantimet, si dhe në konceptimin, shkrimin dhe mbrojtjen e tezës së diplomimit. Evidenca nr. 76 Marrëveshja me AIESEC.pdf
Kriteri 7. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/ çështjeve të caktuara.	Gjatë bashkëbisedimit me studentët dhe stafin akademik të programit që është në fokus, morrëm informacione mbi organizimin dhe të diskutimeve të hapura, në aspekte të brendshme të departamentit, ashtu edhe për çështje të ndryshme me karakter social apo në lidhje me komunitetin. Evidenca nr. 51 Procesverbal mbledhje departamenti, ku është trajtuar një temë e sjellë nga studentet dhe ku kanë qenë prezent perfaqësues të studentëve.pdf
Kriteri 8. Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështet.	Gjatë zhvillimit të programit, pedagogët titullarë të lëndëve, me kohë të plotë a të pjesshme, japin nxitje dhe motivim për studentët që ata të përfshihen në diskutime për qarkullimin dhe zbatimin e ideve innovative, si dhe për promovimin e studimeve të thelluara të fushës. Megjithëse natyra e MP është specifike për balancën teori-shprehi praktike dhe për kohëzgjatjen, punohet individualisht me studentë që ka në prirje dhe gatishmëri për studime më të thelluara shkencore për t'i mbajtur në tonus dhe për t'i integruar ata në këto synime të së ardhmes së afërt. Evidenca nr. 74 Rregullorja mbi kërkimin shkencor.pdf Evidenca nr. 75 Syllabus Lënda "Konceptim dhe Menaxhim Fushatash".pdf
Kriteri 9. Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	Angazhimi i studentëve për zhvillimin e ideve inovative apo studime të avancuara kërkimore e shkencore është një nga mundësitë e studentëve në MP "Komunikim Marketingu". Pavarësisht se kurrikula e tyre është një miks mes marrjes së njohurive të thelluara dhe të profilizuara me ushtrimin e shprehive profesionale, për të qenë sa më shpejt prezent në tregun e punës, për ata studentë që kanë prirje dhe tërheqje më shumë nga studimi e kërkimi shkencor programi krijon një themel dhe për këtë kontigjent që të shtojnë më tej njohuritë dhe shprehitë e thelluara. Sipas bashkëbisedimit me studentët më mirë ata e ndejnë veten në konferencat studentore që realizon KU Bedër, ku prezantojnë punimet dhe aftësitë e tyre. Shtojca 1. Tabelat
Kriteri 10. Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Departamenti i Shkencave të Komunimit, sikundër dhe për programet e tjera të studimit, edhe në rastin e MP "Komunikim Marketingu" influencohet nga praktikatat më të mira të institucioneve partnere për të aplikuar një kurrikul sa më efektive për studentët, që t'u krijojë atyre dhe mundësi konkrete mobiliteti. Duke shfrytëzuar faktin se KU Bedër ka marrëveshje dypalëshe mobiliteti për stafin dhe studentët në kuadër të programit Erasmust, etj., me: <ul style="list-style-type: none">- Universitetin Aurel Vlaicu Unversita of Arad, Rumani në kuadër të programit Erasmus⁺,- College of Applied Sciences, "Lavoslav Rurilta" in Vukovar, Kroaci. këto janë opsione të hapura dhe për studentët e këtij programi. Edhe Programi Global i Shkëmbimit Undergraduate (Global UGRAD), i cili ofron bursë për një semestër të studimeve akademike në një kolegji ose

	universitet në SHBA është një opcion tjetër për ata studentë me potencial në leadership. Evidenca nr. 76 Marrëveshja me AIESEC.pdf Shtojca 1. Tabelat			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.8

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfitimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	Megjithëse në kushtet jo normale të zhvillimit të kurrikulës për vitin 2020-2021, nga shkak i përhapjes së Covid-19, departamenti ku përfshihet programi MP “Komunikim Marketingu” arriti ta verë në funksionim të plotë rrjetin e subjekteve dhe institucioneve partnere për realizimin e praktikave profesionale. Gjithashtu studentët e këtij programi – sipas informacioneve që dhanë gjatë bashkëbisedimit me GVJ - kishin në dispozicion dhe Laboratorin e Multimedias, apo dy sallat e tjera ku janë instaluar dhe ka akses në internet, të mjaftueshme për kryerjen e detyrave apo prezantimeve të ndryshme nga lëndët/modulet e zhvilluara. Për kryerjen e praktikave profesionale Departamenti i Shkencave të Komunikimit ku përfshihet program studimor në fokus shfrytëzon kooperimin me partnerë të përzgjedhur, subjekte publike dhe jopublike ku studentët kanë mundësi të zhvillojnë këtë pjesë të kurrikulës. Për ata studentë që janë dhe në marrëdhënie pune, me aprovimin e tyre, ata e realizojnë po aty pjesën e praktikës profesionale.
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin sa më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	Në bashkëpunimin me partnerët në realizimin e praktikave profesionale KU Bedër ka përvojë të konsoliduar, sidomos në programet e studimit të ciklit të parë dhe të dytë që menaxhohen nga Departamenti i Shkencave të Komunikimit. Kjo vlen dhe për programin MP “Komunikim Marketingu” edhe pse është në vitin e parë të aplikimit, apo dhe nga vështirësitë e pengesat nga situatë me pandeminë e koronavirusit. Evidenca nr. 77 Marrëveshja me Iceberg Communication.pdf
Kriteri 3. Praktikave profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	Në rastin konkret të programit që është në fokus, praktika profesionale është planifikuar të zhvillohet gjatë semestrit të dytë të vitit akademik, pasi studentët kanë marrë një “shtrojë” me dije e njohuri të thelluara dhe të profilizuara, të nevojshme për t’u konkretizuar më pas gjatë realizimit të praktikës. Praktika ka 3 kredite (ECTS) dhe zhvillimi i saj bazohet në rregulloren e Praktikës Profesionale dhe Procedurën e Praktikës Profesionale. Pjesa më e madhe e studentëve në këtë vit akademik e kanë zhvilluar praktikën profesionale në vendet e punës ku janë. Evidenca nr. 15 Rregullorja e Praktikës Profesionale.pdf

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

44

Shkalla e përmbushjes së standardit	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.9

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.</p>	<p>Për këtë vit akademik Departamenti i Komunikimit në akord dhe me mendimet e studentëve të MP “Komunikim Marketingu” ka vendosur që hapi final për kurrikulën të jetë përgatitja dhe mbrojtja e tezës së diplomimit. Kjo është e qartë për të 18 studentët që vijojnë aktualisht programin (nga 19 që u regjistruan në fillim të vitit akademik), atyre u janë dhënë informacione të drejtpërdrejta nga kordinatori, por udhëzime të plota mbi shkrimin e tezës dhe mbrojtjes ata kanë dhe në faqen zyrtare të KU Bedër.</p> <p>Pjesa e shkrimit dhe mbrojtjes së tezës së diplomës përfshihet dhe te rregullorja themelore dhe ato të posaçme që ka miratuar KU Bedër, edhe këto të shkarkuara dhe të aksesuara në faqen zyrtare të institucionit. Pegagogët që udhëheqin kanë zhvilluar seanca informimi, të shkëmbimit të ideve për strukturimin dhe burimet në literature, një proces që vijon deri në dorëzimin e tezës nga studentit në department, e gatshme për mbrojtje para komisionit.</p> <p>Evidenca nr. 34 Rregullorja e Studimeve dhe Provimeve të Ciklit të Dytë.pdf Evidenca nr. 7 Rregullorja e programit të studimit “Master professional” në “Komunikim Marketingu”.pdf Evidenca nr. 78 Manuali për përgatitjen e tezës dhe kriteret e vlerësimit të tezës për studentët e ciklit të dytë.pdf</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.</p>	<p>Departamenti i Shkencave të Komunikimit ndjek ecurinë e procesit të përgatitjes së tezave të diplomimit nga studentët e programit MP “Komunikim Marketingu”. Pedagogët me kohë të plotë apo ata me kohë të pjesshme që janë udhëheqës të tezave të diplomimit raportojnë çdo javë (periudha kur po bëhet ky vlerësim) mbi dinamikën e kësaj faze shumë të rëndësishme. Studentëve ju ofrohen edhe takime ose konsultime për diskutim të çështjeve për të cilat ata kanë nevojë për sqarime dhe shpjegime e orientime të mëtejshme.</p> <p>Standard është që të paktën 5 <i>seanca konsultimi</i> duhet të kryen nga udhëheqësit, dhe për to lihet informacion në Departament. Studentët gjatë bashkëbisedimit ose intervistimit pranuan se ndjeheshin të mbështetur gjatë kësaj faze të zhvillimit të kurrikulës së tyre.</p> <p>Evidenca nr. 36 Vendimi i Këshillit të Departamentit për ngarkesën mësimore.pdf Evidenca nr. 62 Syllabus lënda “Teza”.pdf Evidenca nr. 78 Manuali për përgatitjen e tezës dhe kriteret e vlerësimit të tezës për studentët e ciklit të dytë.pdf Evidenca nr. 79 Formulari i ecurisë së tezës.pdf</p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final,</p>	<p>Që studentët e programit të studimit MP në “Komunikim Marketingu” do të kryejnë në fund të vitit akademik tezë diplomimi, kjo është vendosur në</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

45

<p>bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>bashkëpunim mes studentëve dhe Departamentit të Shkencave të Komunikimit. Atyre iu është sqaruar nga koordinatori, nga pedagogët udhëheqës, por dhe nga udhëzimet që janë lehtësisht të aksesueshme duke shfletuar përmbajtjet e faqes online të KU Bedër mbi procedimin e përzgjedhje së temës, të shkrimit dhe mbrojtjes, afatet, kontakti me udhëheqësin etj. Për atë pjesë të literaturës që është kontigjent në bibliotekën e KU Bedër, ata hyjnë në kontakt drejtpëdrejt ose virtualisht.</p> <p>Evidenca nr. 7 Rregullorja e programit të studimit “Master professional” në “Komunikim Marketingu”.pdf</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të studimit/diplomave.</p>	<p>Koordinatori për programin e studimit MP “Komunikim Marketingu” si dhe pedagogët e Departamentit të Shkencave të Komunikimit kanë asistuar studentët që në fazën e mendimit dhe përzgjedhjes mbi temën e tezës, duke konsultuar fokusin dhe nevojat e kërkimit shkencor për secilën prej tyre. Bazuar në natyrën e tezës së pëcaktuar, me propozim dhe të studentit është bërë përcaktimi i udhëheqësit. Me caktimin e udhëheqësve të tezave të diplomimit kanë qenë më pas ata që kanë vijuar angazhimin më të madh dhe të drejtpëdrejt për fazën e shkrimit dhe të mbrojtjes para komisionit.</p> <p>Evidenca nr. 62 Syllabus lënda “Teza”.pdf</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p> <p>Kriteri 6. Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t’u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Për vetë profilin e programit të studimit që është në fokus, veç udhëheqësit të tezës së diplomës, ndihmëse për studentin janë dhe Laboratori i multimedias si dhe biblioteka e KU Bedër.</p> <p>Me asistencën e pedagogut udhëheqës, studenti përdor me efektivitet ofertën multifunksionale të Laboratorit, si dhe fondin e kopjeve print apo ato virtuale të botimeve që ka biblioteka e institucionit. Edhe gjatë periudhës së pandemisë, laboratori dhe biblioteka ishin funksionale për studentët e interesuar, kundrejt rregullave dhe masave të miratuara nga autoriteti publik shëndetësor për parandalimin e Covid-19.</p> <p>Nga bashkëbisedimi apo me intervistat e lira që GVJ zhvilloi me studentët e programit MP “Komunikim Marketingu” ato pohuan se gjatë fazës së punës për shkrimin e tezës së diplomimit po mbështeteshin nga udhëheqësit e tyre në aspekte të tilla si strukturimi i çështjeve që do trajtoheshin, kërkimi në literature, si dhe respektimin e udhëzimeve për kryerjen e punimit me standard. Udhëheqësit i mbetet dhe përgjegjësia e raportimit në Departament, nëse studentit që ndjek është i gatshëm për mbrojtjen para komisionit përkatës. Këtë vlerësim paraprak ai ja ka bërë dhe studentit që ndjek.</p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studentit vlerësohet me notë.</p>	<p>Kriteri për vlerësimin e studentit me note në shkrimin dhe mbrojtjen para komisionit të tezës së diplomimit është bërë i njohur studentëve që ndjekin MP “Komunikim Marketingu”. Faktikisht ata do ta realizojnë shkrimin dhe mbrojtjen e tezës së diplomimit pas kryerjes së vlerësimit të jashtëm në kuadër të akreditimit nga ekspertët e jashtëm.</p> <p>Evidenca nr. 70 Vendim për ngritjen e jurive të tezave master.pdf</p>

Kriteri 8. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.	Për rastin që po vlerësohet, kjo nuk ka ndodhur ende, pasi programi i studimit MP “Komunikim Marketingu”, që zhvillohet për herë të parë është ende në proces. Evidenca nr. 34 Rregullorja e Studimeve dhe Provimeve të Ciklit të Dytë.pdf			
Kriteri 9. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Për studentët e programit MP “Komunikim Marketingu” ky proces nuk ka ndodhur ende, pasi ky vit i parë akademik ende nuk është finalizuar. Por përvoja e Departamentit të Shkencave të Komunikimit me programet e tjera që menaxhon, apo për raste të programeve të tjera në KU Bedër, cilido student në përfundim të kurrikulës, i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.			
Kriteri 10. Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet, rast pas rasti, informacione për studentët nëse kërkohen.	Për studentët e programit që është në fokus, nuk është se ka deri më tani arkivë të depozitimit të tezave të diplomës të përgatitura dhe të mbrojtura, pasi një gjë e tillë nuk ka ndodhur ende, pasi, siç dhe e kemi shpejguar më sipër ky është viti i parë akademik që aplikohet programi i ciklit të dytë të studimit MP “Komunikim Marketingu”. Por përvoja e Departamentit, ku përfshihet programi, dhe e KU Bedër në përgjithësi është ndjekja e procedurës strikte të arkivimit të tyre, si dhe lëshimit të dokumentacionit të kërkuar nga secili student i interesuar (për vërtetim ose dëshmi), sipas legjislacionit në fuqi. Evidenca nr. 80 Rregullorja e Arkivës.pdf			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X
Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1 Institucioni i arsimit të lartë mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë	KU Beder mban pranë zyrës së Burimeve Njerëzore, dosjet e plota për të gjithë stafin akademik të programeve të studimit. Dokumenti “Rregullorja e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë” jep të përcaktuar veprimtarinë e stafit akademik të këtij fakulteti dhe specifikon rolin e tyre. Ai bazohet edhe në dokumentin themeltar “Rregullorja themelore e KU Bedër”

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

47

<p>në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ.</p>	<p>Sipas dokumenteve të sipërcituar KU Beder ka të specifikuar (i) Procedurat e punësimit të personelit; (ii) Praktikat e ndjekura për punësimin e personelit akademik; (iii) Planin e trajnimeve të personelit.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion GVJ u njoh me dosjet e personelit akademik (sipas një përzgjedhje rastësore). I gjithë informacioni përmbledhet dhe ruhet në Zyrën e Burimeve Njerëzore, me dosje individuale për të gjithë stafin. Nga vizita në institucion pranë sektorit të burimeve njerëzore, u shfletuan dhe u panë dosjet me zgjedhje rastësore, si për staff Akademik PAE dhe PAK.</p> <p>Dosja përmban elementët e domosdoshëm si: (i) Informacionin mbi nivelin e kualifikimeve dhe arsimin; (ii) Informacionin mbi kualifikimet dhe publikimet /botime; (iii) Informacionin shëndetësor; (iv) Dokumentet e identitetit/.</p> <p>Dosjet janë të plota dhe ruajnë informacionin e domosdoshëm dhe plotësues për personelin akademik.</p> <p>Evidenca 3: Rregullorja themelore e KU Bedër Evidenca 17: CV-të e stafit akademik të angazhuar në programin e studimit Evidenca 18: Rregullorja e Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësisë Evidenca 83: Procedura e punësimit të personelit Evidenca 84: Praktika e ndjekur për punësimin e personelit akademik Evidenca 85: Plani i trajnimeve të personelit</p>
<p>Kriteri 2 Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>Dokumenti “Rregullorja themelore e KU Bedër” neni 26 përcakton përzgjedhjen dhe emërimin e personelit me kohë të plotë/të pjesshme, duke u bazuar në një procedurë të konkurrimit të hapur duke garantuar një proces transparent, të paanshëm dhe objektiv.</p> <p>A. Për personelin akademik me kohë të plotë nga KU Beder vepron:</p>
<p>Kriteri 3 Institucioni i arsimit të lartë harton procedura e kritere të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Përgjegjësi i departamenti përkatës propozon kriteret për vendet e lira të punës që duhet të plotësojnë kandidatët për personel akademik me kohë të plotë dhe paraqet kërkesën për personel të ri akademik me kohë të plotë për aprovim pranë Dekanit të Fakultetit përkatës.
<p>Kriteri 4 Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<ol style="list-style-type: none"> 2. Dekani i Fakultetit vlerëson kërkesat e paraqitura për rekrutim të stafit të ri akademik me kohë të plotë dhe kërkesa e miratuar i dërgohet Rektorit për vlerësim. 3. Pas aprovimit nga ana e Rektorit, i përcillet për ndjekjen e mëtejshme të procedurave për shpalljen e vendeve të lira të punës, Zyrës së Burimeve Njerëzore. Kjo e fundit publikon vendet vakante në web-in e Kolegjit Universitar “Bedër” dhe/ose pranë Zyrës së Punës. 4. Përzgjedhja e kandidatëve, nëpërmjet vlerësimit të dosjeve të aplikimit, bëhet nga një komision i përbërë nga Dekani i fakultetit përkatës, Përgjegjësi i Departamentit përkatës (i cili është dhe relatori i komisionit), si dhe një nga personeli akademik i njësisë bazë (i cili është dhe relatori i komisionit). Përgjegjësi i Burimeve Njerëzore ndjek procedurën e përzgjedhjes së kandidatëve pa të drejtë vote dhe në rast konstatimi të parregullsive në procedurë, përpilon relacionin përkatës drejtuar Rektorit.

	<p>5. Komisioni analizon përshtatshmërinë e aplikimit me vendin e lirë të punës dhe vendimin e miratuar me shumicë të thjeshtë ia paraqet për miratim Rektorit i cili miratón një prej tyre.</p> <p>B. Për punësimin e personelit të ri akademik me kohë të pjesëshme nga KU Beder ndiqen hapat e parashikuara në Rregulloren e punësimit dhe vlerësimit të performancës së stafit akademik.</p> <p>Media dixhitale dhe marketimi dixhital janë degë e reja dhe me një zhvillim të vrullshëm nga viti në vit. Në Shqipëri, personeli akademik në programe të tilla studimi me grada shkencore është i kufizuar në numër, konkretisht në tematikat e medias dixhitale. Ndërkohë që tendencat e mediave dixhitale, komunikimit dixhital dhe marketimit dixhital, nevojitet të pasqyrohen edhe në programet mësimore. KU Beder përdor formatet e seminareve dhe workshop-s me tematika të caktuara, për të ndihmuar studentët në njohjen e këtyre tendecave dhe zhvillimeve të reja dixhitale. Kjo u theksua nga drejtuesit e departamentit edhe gjatë vizitës së GVJ në institucionin. KU Beder nxit pedagogët e tij që në kuadër të marrëveshjeve të bashkëpunimit me Universitetin e Tiranës, pedagogët të fitojnë grada shkencore dhe të rrisin kualifikimin e tyre profesional.</p> <p>Kjo vihet re edhe në Raportet Vjetore të Departamentit të Shkencave të Komunikimit. Janë një numër seminaresh MarCom dhe “<i>Studenti dhe profesioni</i>” të cilat i shërbejnë pikërisht njohjes me tendencat e reja.</p> <p>Evidenca 3: Rregullorja themelore e KU Beder Evidenca 24: Raporti Vjetor i Departamentit të Shkencave të Komunikimit, viti akademik 2019-2020 Evidenca 83: Procedura e punësimit të personelit Evidenca 84: Praktika e ndjekur për punësimin e personelit akademik Evidenca 85: Plani i trajnimeve të personelit</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				x

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efçente dhe efektive

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni angazhohet për krijimin e mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p>	<p>Krijimi i mjedisit dhe mundësive të përshtatshme për kryerjen e detyrave të stafit në mënyrë profesionale lidhet sa me infrastrukturën fizike dhe materiale, aq edhe me ofrimin e mundësive për pjesëmarrje në aktivitete kurikulave dhe ekstrakurikulare.</p> <p>Nga pikëpamja e infrastrukturës fizike, KU Beder ka krijuar mundësinë për funksionim profesional. (Do të përshkruhet më poshtë)</p> <p>Në kuadrin e krijimit të mundësive të barabarta për kryerjen e detyrave në funksion të mësimdhënies, stafi akademik nxitet të marrë pjesë në aktivitete/workshope/seminare në drejtim të forcimit dhe diversifikimit të</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

	<p>metodave të mësimdhënies. (Plani i trajnimeve të personelit) Po kështu stafi akademik inkurajohet të përfshihet edhe në projekte të ndryshme sipas specifikave të lëndëve dhe kualifikimeve të tij. Gjithashtu i gjithë stafi përfshihet në trajnime si për metodologjinë e mësimdhënies, ashtu edhe për zbatimin e programeve të reja të Teknologjisë së Informacionit, përfshirjen në projekte, etj.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.</p>	<p>KU Beder e ka të shprehur në dokumentet e tij themelore synimin për të ofruar arsimin cilësor në programet e tij. KU Beder është i angazhuar në zhvillimin profesional të burimeve të tij njerëzore, sidomos akademike. Janë disa aktivitete ku nxiten pedagogët të marrin pjesë, si në aktivitete trajnuese edhe në aktivitetet extarkurrikulare.</p> <p>Sikurse është e saktësuar edhe në Strategjinë e Kërkimit Shkencor 2012-2017</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>“... synon të arrijë objektivat e saj arsimorë përmes kërkimit shkencor, një game të mirë balancuar dhe të larmishme të programeve të studimit dhe një mjedisi ambicioz arsimor. Për t’ua rritur studentëve tanë dëshirën e përhershme për njohuri dhe për t’i inkurajuar ata në mbajtjen e një qëndrimi inovativ të pavarur dhe aspiratës për të arritur përparim dhe sukses brenda dhe jashtë institucionit.”</p> <p>GVJ, gjatë vizitës në institucion, u njoh me platformat që përdor institucioni për të komunikuar në distancë me studentët. Për përdorimin sa më komod të këtyre platformave janë zhvilluar trajnime nga zyra e TI. GVJ u njoh nga Zyra e Burimeve Njerëzore me trajnimet e zhvilluara (i) mbi metodologjinë didaktike; dhe (ii) mbi metodologjinë e kërkimit shkencor.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.⁵</p>	<p>Personeli akademik është përfshirë në trajnime edhe nga akademi dhe institucione të tjera të huaja në kuadër të marrëveshjeve të bashkëpunimit. Kështu në sajë të një projekti “ETHICS IN Higher Education for Teaching Professionals Course”. Programi zgjat 10 javë dhe ka filluar në mars 2021. Sikurse përshkruhet edhe në fishën e projektit, ai synon forcimin prespektivës etike në mësimdhënie.</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>“Analyse, interpret and evaluate relevant information and ideas, and propose solutions from different theoretical ethical perspectives or approaches and apply them in their area of study or work in higher education.</i> • <i>The key learning outcomes of this course centre on the knowledge of core ethical principles, standards and competence in executing a detailed analysis of ethical dilemmas, and skills relevant for employability in constructing a framework for a higher education institution's code of ethics.”</i> <p>Kolegji Universitar Bedër bëhet pjesë e projektit "Bologna Hub Peer Support". Projekti synon nxitjen dhe përmirësimin e zbatimit të elementeve kryesore të procesit të Bolonjës në institucionet e arsimit të lartë në të gjithë Zonën Evropiane të Arsimit të Lartë (EHEA).</p>

	<p>Projekti koordinohet nga Ministria Gjermane e Arsimit dhe Kërkimit dhe Agjencia Gjermane e Shkëmbimit Akademik (DAAD) në bashkëpunim me Erasmus+.</p> <p>Ekspertët ofrojnë këshillim gjatë vizitave/takimeve online ose në terren në tre pika kryesore:</p> <ul style="list-style-type: none"> ➤ Implementimi i strukturës së në tre cikle Bachelor-Master-Doktoratë; ➤ Njohja e kualifikimeve në përputhje me Kartën e Bolonjës; ➤ Sigurimi i cilësisë në përputhje me Standardet dhe Udhëzimet për Sigurimin e Cilësisë në Zonën Evropiane të Arsimit të Lartë. <p>KU Beder kujdeset që si stafi akademik ashtu edhe ai mbështetës të jetë tërësisht i angazhuar në realizimin e programit të studimit.</p> <p><u>Referenca për Standard IV.2</u></p> <p>Evidenca 3: Rregullorja themelore e KU Bedër</p> <p>Evidenca 83: Procedura e punësimit të personelit</p> <p>Evidenca 84: Praktika e ndjekur për punësimin e personelit akademik</p> <p>Evidenca 85: Plani i trajnimeve të personelit</p> <p>Dokumentacioni shtese pas vizitës:</p> <p>2. ETHICS IN Higher Education for Teaching Professionals Course</p> <p>2. screenshot emaili i konfirmimit per trajnimin me Educators without borders</p> <p>5. Application_form_bologna_hub_peer_support_heis_daf.</p> <p>5. Bologna Hub project ECTS discussion and objectives</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi IV.3</p>	
<p>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/eve të studimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>KU Beder e filloi vitin akademik 2020-2021 në godina të reja, të sapo ri konstruktura, me mjedise të dedikuara këtij programi studimi. Nga vëzhgimi i mjediseve të mësimin, u pa se ato janë mjaft mirë të pajisura edhe nga pikëpamja teknologjike për të plotësuar kushtet e studentëve të komunikimit. Ku Beder kishte një newsroom, muzeu i medias dhe komunikimit, laborator i gjuhëve të huaja dhe kompjuterave, etj.</p> <p>Fakulteti përgjegjës për programin e studimit Master Profesional në “Komunikim Marketingu” ka një sipërfaqe 3,000 m² dhe qe llogaritet me një normë rreth 5 m² për student. Fakulteti ka 5 salla të mëdha leksionesh dhe 9 salla seminaresh. Gjithashtu ka 2 salla interneti, laborator profesional, laborator për lëndët praktike, salla aktivitetesh promovuese, etj.</p> <p>Nga vizita e GVJ në mjediset e reja të institucionit u vu re se ambientet mësimore ishin të pajisura me të gjithë mjetet e domosdoshme për zhvillimin e një orë interaktive mësimore. Ambientet ishin me hapësira të mjaftueshme,</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

51

	dhe komode për studentët. Të gjitha ambientet mësimore përshtateshin me numrin e studentëve që frekuentojnë programin. Shtojca 1. Tabelat (Tabela 16_Infrastruktura e BEDER)			
Kriteri 2. Mjediset mësimore, si: klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Mjediset mësimore ishin të pajisura edhe nga pikëpamja teknologjike, me kompjutera, tabelë projektimi, tabela interaktive dhe internet, të nevojshme për zhvillimin e një orë mësimi interaktive. Në ambientet e mësimi dhe kudo brenda institucionit kishte internet dhe mjediset ishin të gjitha të pajisura me kondicionim dhe ndriçim të plotë edhe natyral edhe artificial. Personeli akademik dhe studentët programet kompjuterike dhe software në kuadër të plotësimi të kërkesave të procesit mësimor. Gjithashtu çdo individ (pedagog, student) është i pajisur me llogarinë e tij të postës elektronike @beder.edu.al me memorie të pakufizuar të Google Drive dhe sharing, Google Classroom, etj. Ky email u mundëson studentëve të aksesojnë llogarinë e tyre personale në Sistemin Interaktiv Bedër (BIS) të sistemit të brendshëm nga ku mund të ndjekin notat e tyre G-SUITE me shërbimet e saj është platforma online, e përdorur për më tepër për realizimin e procesit mësimor dhe komunikimin me studentët gjatë periudhës së pandemisë COVID-19. Gjithashtu, përmes G-Suite çdo pedagog ndan materialet e leksioneve, studentët dorëzojnë projektin e tyre ose detyrat e ndryshme dhe aktivitete të tjera të ngjashme, të nevojshme për lëndën specifike.			
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimi teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Aksesi në Internet, tek të dyja godinat dhe laboratorët e kompjuterëve është i pandërprerë. Gjithashtu institucioni ka siguruar disa software si MS Office, Adobe, SAP2000, ETABS, .Net Visual Studio C ++, Matlab, GNS3 e fundit, Multisim 11, VMWare Workstation, MySQL \ Workbench, Eclipse, Python (x, y), Rhinoceros 4 SR8 + Vray, 3DMAX dhe SPSS.			
Kriteri 4. Institucioni siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/eve të studimit që ofron.	KU Beder u jep rëndësi praktikave profesionale dhe për këtë ka lidhur edhe marrëveshje bashkëpunimi me institucione, mediatike për zhvillimin e praktikave. Një ndihmesë e mirë për praktikat është edhe www.objektiv.al si edhe zyra e marrëdhënieve me publikun e vetë KU Beder.			
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe /ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike				
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
			X	

Standardi IV.4 Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
-----------------	-------------------------------

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

52

<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>KU Beder ka një bibliotekë të pasur dhe mjaft funksionale për studentët e tij. Syllabuset e lëndëve kanë të saktësuar literaturën e nevojshme për lëndët e ofruara, e cila u bëhet e ditur studentëve në fillim të semestrit dhe prezantimit me lëndën.</p> <p>Biblioteka e KU Bedër, e cila është në dispozicion të studentëve çdo ditë të javës nga e hëna në të shtunë, ofron një gamë të gjerë titujsh, në total rreth 26 000 libra dhe revista.</p>
<p>Kriteri 2. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p> <p>Kriteri 3. Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët, në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.</p> <p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>Pedagogët e lëndëve kërkojnë nga departamenti që të sigurohen në bibliotekë të paktën disa kopje nga literatura e nevojshme. Biblioteka zotëron tituj kryesorë të përfshirë në literaturën e domosdoshme të lëndëve mësimore. Këta tituj janë të përzgjedhur dhe klasifikuar në përputhshmëri me programet e studimit të ofruara nga KU Bedër duke mbuluar nevojat e parashikuara sipas këtyre programeve të studimit</p> <p>KU Beder ka marrëveshje dhe ka akses të plotë, si për studentët ashtu edhe për stafin në JSTOR, një nga platformat më të mëdha akademike në botë. Studentët mund ta aksesojnë atë thjeshtë duke qenë të lidhur me internetin e KU Beder. Aksesit në fondin e bibliotekës është i njëjtë për të gjithë.</p> <p>Biblioteka e KU Bedër është e pajisur me programe kompjuterike dhe kompjutera për t'u mundësuar studentëve realizimin e detyrave dhe mundësi për akses online në varësi të nevojave të tyre. Po ashtu, databaza e Bibliotekës së KUB gjendet online, duke i ndihmuar studentët në gjetjen e literaturës.</p> <p>Gjatë vizitës së GVJ në institucion u vërejt klasifikimi i titujve sipas metodikës së librarisë së Kongresit Amerikan. Gjithahstu po në bibliotekë ruheshin edhe punimet e diplomave të studentëve të Master ne vitet e kaluara për të gjitha programet.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë e të zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje të programit.</p>	<p>Sipas dokumentit “Buxheti i Departamentit të Shkencave të Komunikimit” secili departament përcakton dhe planifikon një buxhet të caktuar për blerje librash dhe literature të nevojshme për programin e studimit.</p> <p>Mënyra të tjera të pasurimit të bibliotekës janë edhe nëpërmjet donacioneve, projekteve dhe bashkëpunimit me aktorë të tjerë publikë apo privatë. Kështu projekti studentor “Libri është i vetmi kopsht që mbillet për të tjerët”, i organizuar përmes një fushate sensibilizuese për mbledhjen e librave, nga studentët e departamentit të Shkencave të Komunikimit, realizoi që të mbledhen rreth 10, 000 libra. Një pjesë e tyre u përdor për pasurimin e bibliotekës së institucionit, ndërsa pjesa tjetër u dhurua për shkolla, institucione të tjera dhe grupe në nevojë.</p> <p>Në pasurimin e bibliotekës së KU Beder ka ndihmuar edhe dhurimi i 318 librave nga Ambasada Amerikane në Tiranë, tetor 2018, nga të cilët më shumë se 70% e tyre ishin botime specifike për Departamentin e Shkencave të Komunikimit.</p>

<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj</p>	<p>Oraret e punës të bibliotekës janë nga ora 8:30 deri në orën 19:00 të mbrëmjes. Në periudhë provimesh, biblioteka qëndron e hapur edhe gjatë fundjavës.</p> <p>Në funksion të bibliotekës, KU Bedër ka vënë në dispozicion edhe sistemin e automatizimit. Sipas këtij sistemi, kërkesa për sigurimin e literaturës dhe regjistrimet e studentëve bëhen në formë elektronike.</p> <p>Biblioteka ofron sigurimin e materialeve edhe në rrugë elektronike. Kjo mundësohet nga abonimi që është bërë në bibliotekën online JSTOR - një bibliotekë digjitale për punime akademike, libra dhe burime informacioni sipas fushave specifike të studimit.</p> <p>Referenca për Standard IV.4 Evidenca 16: Marrëveshja me JSTOR Evidenca 49: Raporti vjetor i Departamentit të Shkencave të Komunikimit, viti akademik 2018-2019 Evidenca 60: Buxheti i Departamentit të Shkencave të Komunikimit Evidenca 61: Udhëzim mbi funksionimin e bibliotekës</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>KU Beder ka sistemin Bedër Information System (BIS) si platformë e menaxhimit të brendshëm të informacionit. Ky sistem shërben si për studnetët ashtue dhe për pedagogët. Aty ruhet informacioni për dtudnetin, duke filluar që nga të dhënat bazë sic janë gjeneralitetet e përgjithshme por edhe email data e rregjistrimit, transkriptet, rregjistri lëndëve, komunikimi me bibliotekën dhe librat gjendje, etj.</p> <p>Ky sistme Bedër Information System (BIS) i shërben edhe sekretarisë mësimore si edhe Zyrës së Burimeve Njerëzore, për të përfshirë informacionet e tyre. Në sistem bëhet edhe shpërndarja e orëve mësimore për pedagogët.</p> <p>Info për këtë sistem gjendet edhe në “Udhëzues i sistemit informativ (BIS)”.</p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Secila nënjësi apo zyrë administrative ka një ndërfaqe të sajën në sistemin BIS të KU Beder.</p> <p>Sekretaria mësimore, është njësi që e përdor cdo ditë dhe e ka shumë efektiv përdorimin e këtij sistemi. I gjithë procesi dhe dokumentacioni mësimor doërzohet aty dhe sekretaria e përfshin këtë në sistemin e saj BIS. Po kështu, nënfaqe të vecantë kanë studentët, stafi akademik, burimet njerëzore, Zyra e Burimeve Njerëzore, departamentet, NJSBC, etj.</p>

<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Informacioni i siguruar në sistemin BIS është më vete si për pedagogët, ashtu edhe për studentët duke pasur një ID dhe fjalëkalimi. Sistemi gjithashtu edhe ruan të drejtën e privacisë për përdoruesit e tij studentë. Ata mund të marrin të gjitha notat, lëndët, vlerësimet, dhe komunikimet e nevojshme të stafit pedagogjik me studentët si dhe komunikimet e këtyre të fundit me departamentet mbështetëse në institucion.</p>			
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>KU Beder përdor platformën Google classroom për të mundësuar komunikimin interaktiv të brendshëm midis studentëve dhe pedagogëve. Ky sistem ka qenë i integruar në platformat e komunikimit edhe përpara Pandemisë COVID -19 në dy vitet e fundit akademikë. Por ai është bërë mjaft i përdorshëm sidomos gjatë kësaj periudhe.</p> <p>Nëpërmjet një adrese email @bedër.edu.al mundësohet shkëmbimi interaktiv i informacionit me studentët përsa i përket përmbajtjes së lëndëve, orëve të mësimi, ruajtjes së detyrave të studentëve, dorëzimit e vlerësimit.</p> <p>KU Beder përdor edhe platforën G-suite për të aksesuar materialet në Cloud.</p>			
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.</p>	<p>Sistemi BIS, duke pasur ndërhyrjen e gjithë informacionit nga të gjitha zyrat, mundëson kontrollin automatik të informacionit dhe kryqëzimin e tij nga njëra zyrë në tjetrën. Kjo krijon mundësinë e shmangies së gabimeve rastësore. Informacioni i dalë nga sistemi, përpunohet dhe shkon tek rektorati për ti shërbyer vendimmarrjes sa më efektive.</p>			
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe</p>	<p>www.beder.edu.al është faqja elektronike e universitetit e cila përmbledh të gjithë infon e nevojshme. Informacioni në faqe ofrohet në dy gjuhë dhe përmban gjithë informacionet për programet e studimit, aktivitetet e institucionit, stafit akademik, departamenteve të tjera mbështetëse etj.</p> <p>Nga diskutimi gjatë vizitës së GVJ në institucion, na u treguan planet për rinovimin e faqes web. Kjo lidhej më shumë me faktin se desinjimi i faqes ishte bërë në fillesat e universitetit dhe tashmë kanë shumë më tepër për prezantuar tek studentët si nga pikëpamja e materialeve, ashtu edhe e aktiviteteve të organizuara në ndihmë të studentëve.</p> <p><u>Referenca për Standard IV.5</u> Evidenca nr. 58 Udhëzues i sistemit informativ (BIS).pdf</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi IV.6

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të

Sipas dokumentin “Buxheti i Departamentit të Shkencave të Komunikimit” secili departament ka të përcaktuar disa prej zërave të shpenzimeve të cilët

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

55

<p>programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>lidhen me aktivitetet e lidhura me kurikulën, por që i japin departamentit një profil më të gjerë si pjesëmarrës në kërkimin shkencor. Ndërkohë që në tabelën e të ardhurave dhe shpenzimeve në anekset e RVB jepen edhe bilanci i të ardhurave në tre vitet e fundit akademike. Burimet kryesore të të ardhurave janë: (i) Tarifat e shkollimit; (ii) Donacionet, aktivitetet siguruese, fondacioni; (iii) konsulenca dhe shërbimet.</p> <p>Planifikimi i shpenzimeve dhe të ardhurave bëhet çdo fill viti, duke pasur mbështetjen e fondacionit që e ka ndërtuara. Ndërkohë që KU Bedër është institucion i arsimit të lartë jofitimprurës.</p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë, sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p>Planifikimi i financimit për zërat kryesorë bëhet për të gjithë institucionin dhe nuk ka planifikim të të ardhurave dhe shpenzimeve në nivel programesh studimi. Kjo pasi edhe kostoja për realizimin e një planifikimi të tillë të detajuar nuk do të justifikonte informacionin që do të vinte nga kjo analizë e detajuar dhe përparësitë e një informacioni të tillë.</p> <p>Vetëm një pjesë e shpenzimeve, kryesisht ato të lidhura me kërkimin shkencor dhe konferencat, janë të detajuar për departamentet. Por sërish departamentet mund të kenë disa programe studimi.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifrat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p> <p>Kriteri 4. Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p>	<p>KU Beder organizon edhe auditim të brendshëm. Auditimi i brendshëm përfshin disa aspekte të punës së institucionit. Një ndër departamentet që ka kaluar edhe auditimin e brendshëm është edhe Zyra e Financës dhe Shërbimeve Administrative. Aty janë analizuar (i) procedurat; (ii) projektbuxheti dhe realizimi; (iii) bilanci dhe analiza e dy viteve; (iv) procesverbalet; (v) analiza e shpenzimeve.</p> <p>Gjithashtu, institucioni/ fondacioni harton një raport financiar nga një Kontabilist i Miratuar, sipas standardeve të miratuar të kontabilitetit. Ky raport ruhet pranë Fondacionit që mbështet KU Beder. Raporti është vjetor dhe përmban pasqyra të hollësishme të të ardhurave dhe shpenzimeve. Një raport vjetor institucional me buxhetin e vitit të kaluar, projektbuxhetin e vitit të ardhshëm si edhe një buxhetimin afatmesëm, dërgohet pranë Ministrisë së Arsimit, në përfundim të vitit akademik.</p> <p>Programi i studimit Master Profesional në “Komunikim Marketingu” nuk e ka mbyllur diplomimin e studentëve të tij dhe ky është viti i parë i përfundimit të ciklit të këtij programi.</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

56

<p>Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen</p>	<p>Shpërndarja e burimeve financiare dhe përdorimi i tyre hartohet bazuar në legjislacionin aktual për “Për organizatat jofitimprurëse”, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, si edhe ligjin “Për arsimin e lartë”.</p> <p>Mbështetja e donatorëve, krahas edhe tarifave të studimit, kanë garantuar qëndrueshmërinë financiare të programit të studimit.</p> <p>Referenca për Standard IV.6 Evidenca 60: Buxheti i Departamentit të Shkencave të Komunikimit RVB - Tabela 18: Të ardhurat Evidenca 94: Njoftim për fillimin e auditimit të brendshëm</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X
<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</p>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

<p>Standardi V.1 Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>KU Beder ka hartuar një rregullore të programit të studimit “Master professional” në “Komunikim Marketingu” e cila në Nenin 14 përcakton edhe kushtet e pranimit në këtë program studimi “<i>Për t`u pranuar në programin e studimeve “Master Profesional në Komunikim Marketingu”, çdo shtetas shqiptar apo i huaj që aplikon nevojitet të ketë përfunduar studimet për një diplomë universitare të nivelit Bachelor. Preferohen ata studentë që kanë mbaruar ciklin e studimeve të nivelit Bachelor në programet e studimit në Komunikim Marketingu, Shkenca Komunikimi, ose të ngjashëm me këtë program.</i>”</p> <p>Gjithashtu, KU Beder ka përcaktuar edhe një grup dokumentacioni dhe procedurash për të gjithë ecurinë e studenteve gjatë programit të studimit. Kështu është përcaktuar (i) Vendimi i këshillit të departamentit për përcaktimin e përfaqësuesit të karrierës; (ii) Vendimi i këshillit të departamentit për caktimin e këshilltarëve akademike; (iii) Guida e Studentit; (iv) Procedura e Praktikës Profesionale; (v) Rregullorja për disiplinën e studenteve; (vi) Vendim për ngritjen e jurive të tezave master; (vii) Praktika e ndjekur për miratim të kriterëve të pranimit të studentëve.</p>

	<p>Institucioni kujdeset që nga regjistrimi i studentëve dhe pajisja e tyre me numër matrikullimi, krijimi i dosjes së plotë të studentit dhe deri në dalje duke u kujdesur për diplomimin dhe suplementin e diplomës.</p> <p>GVJ kërkoi disa dosje studentësh (random) dhe konstatoi se ishin në përputhje me kërkesat ligjore.</p> <p>I gjithë seti i dokumenteve dhe procedurave i shërben studenteve, krahas edhe kontakteve të drejtpërdrejta me Zyrat e këshillimit të karrierës, dekanin e studenteve si edhe drejtpërdrejtë me departamentin e shkencave të komunikimit për gjatë gjithë ecurisë së programit të studimit.</p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Politikat e hartuara nga KU Beder, përgjatë ciklit të studimit janë të qarta ashtu sikurse përshkruhet edhe në “Rregulloren e programit të studimit Master profesional në Komunikim Marketingu. Ky dokument garanton mos-diskriminimin dhe gjithëpërfshirjen.</p> <p>Siç u diskutua edhe me Dekanin e Fakultetit të Shkencave Humane dhe përgjegjësin e departamentit, KU Beder ka në politika të përcaktuar edhe për kategori të veçanta, studentët me aftësi ndryshe. Kuota të veçanta jepen në disa nga programet e studimit edhe për studentët nga trojet shqiptare jashtë kufirit, sidomos Medvegja dhe Presheva, duke dhënë bursa studimi të plota ose të pjesëshme. Gjatë vizitës së GVJ u prezantua edhe me përpjekjet për thithjen e studentëve nga Mali i Zi.</p>
<p>Kriteri 3. Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë ndjekjes së programit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesëshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>KU Beder saktëson që me fillimin e programit të studimit, cilat do të jenë kriteret e hyrjes dhe kushtet e nevojshme për përfundimin dhe diplomimin në një program specifik studimi. Një pjesë e kritereve janë të përgjithshme për të hyre në KU Beder, ndërsa Këshilli i Departamentit përcakton kriteret e qarta për pranimin e studentëve, në programin specifik të studimit, të cilat më pas firmosen nga Shefi i departamentit, Dekani/Rektori si dhe dërgohen pranë institucioneve përkatëse në Ministrinë e Arsimit.</p> <p>Kriteret specifike dhe të përgjithshme pasqyrohen edhe në faqen e website të institucionit për studentët apo kandidatët për studentë.</p> <p>Një mundësi shumë efektive për të marrë informacionin e duhur është edhe kontakti i drejtpërdrejtë me departamentin dhe zyrën e këshillimit të studentëve.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret e veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t’u pranuar në ciklin e dytë të studimeve.</p> <p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit</p>	<p>KU Beder harton dhe publikon kriteret për pranimin e studentëve të rinj, përpara fillimit të vitit të ri akademik. Kriteret e përgjithshme janë të përcaktuara dhe të përfshira edhe në Rregulloren e programit dhe ato i përcillen Ministrisë së Arsimit, në respekt të legjislacionit përkatës/akteve nënligjore në fuqi.</p> <p>Departamenti për pranimin e studentëve të rinj në këtë program ka dy kriteret (i) nota mesare e shkollës së mesme; (ii) intervistimi i studentit nga komisioni i vlerësimit.</p> <p>Oferta e KU Beder për programet e studimit behet publike si nëpërmjet takimeve të drejtpërdrejta, ashtu edhe nga faqja web, broshurat, guida e</p>

	<p>studentit si edhe në baza vjetore në panaire, konferenca shkencore, apo kontakte mediatike që zhvillohen përgjatë vitit akademik nga institucioni.</p> <p>Referenca për Standard V.1 Evidenca 3: Rregullorja themelore e KU Bedër Evidenca 7: Rregullorja e programit të studimit “Master professional” në “Komunikim Marketingu” Evidenca 86: Praktika e ndjekur për miratim të kriterëve të pranimit të studentëve Evidenca 87: Rregullorja mbi zbritjet e tarifave të studimeve</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht	
			X	

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Rregullorja e programit të studimit “Master professional” në “Komunikim Marketingu” dhe Guida e Studentit janë një bazë shumë e mirë informacioni për studentët në KU Beder për të filluar procesin e njohjes dhe hapat që duhet të ndjekë studenti nga fillimi i programit të studimit deri në përfundim dhe diplomim.</p> <p>Një bazë shumë e mirë për studentin pas regjistrimit janë edhe syllabuset e të gjitha lëndëve mësimore të cilat japin edhe kriteret e kalimit dhe vlerësimin me notë për studentët.</p> <p>Gjithashtu, sekretaria mësimore dhe koordinatori i programit të studimit janë një mundësi shumë e mirë që u jepet studentëve për të marrë informacione mbi ecurinë dhe performancën e tyre në program.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjeshme.</p>	<p>Rregullorja e programit të studimit “Master professional” në “Komunikim Marketingu” jep edhe kriteret dhe mundësitë për njohjen e kualifikimeve të mëtejshme dhe transferimin e studimeve. Ky program është vetëm dy semestra. Procedura e njohjes, ekuivalentimit dhe pajisjes me diplomë mund të bëhen vetëm në rast se studenti ka ndjekur jo me pak se dy semestra. Kështu që për këtë program studimi nuk është e mundur të bëhet transferim studimesh.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Vlerësimi i studentëve është qartësisht i përcaktuar në çdo syllabus të lëndëve që studentët marrin gjatë semestrave të studimit në këtë program. Ndarja e raporteve në vlerësim bëhet bazuar në udhëzimet dhe aktet nënligjore të përcaktuara nga Ministria e Arsimit. Syllabuset janë publike edhe nëpërmjet sistemit të brendshëm BIS. Informacioni mbi vlerësimet e studentëve shpjegohet edhe nga pedagogët në fillim të çdo semestri.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës</p>	<p>Rregullorja e programit të studimit “Master professional” në “Komunikim Marketingu” dhe Guida e Studentit janë burimet e rëndësishme dhe kryesore të informacionit.</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.a

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

59

<p>dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Për përcaktimin temës së diplomimit dhe gjithë procedurën që lidhet me të, studentet kanë edhe një lëndë me vete që titullohet “Teza”. Kjo lëndë zhvillohet në semestrin e dytë dhe është e detyrueshme.</p> <p>Manuali që KU Beder ka hartuar “Manuali për përgatitjen e tezës dhe kriteret e vlerësimit të tezës për studentët e ciklit të dytë” është një material i vlefshëm dhe shumë i konsoliduar, dhe jep edhe rrugën strategjike për të arritur deri në shkrimin e tezës së diplomimit në Master Profesional. Ai jep edhe elementet teknike që nevojiten për cilësinë dhe mënyrën e të shkruarit.</p> <p>Për ti shërbyer rezultateve të larta të studentëve, diplomimit të suksesshëm të tyre dhe një të nxëni sa më aktiv, KU Beder ka zhvilluar në mënyrë periodike konferenca të shkencore.</p> <p>Kështu në 15 qershor 2021 u organizua konferenca e 6-të studentore e Departamentit të Shkencave të Komunikimit, në të cilin kishte edhe pjesëmarrës nga studentët e Masterit Profesional në Komunikim Marketingu. Ata prezantonin edhe pjesë të veçanta nga punimet e tyre të diplomës, ashtu edhe punime të veçanta.</p> <p>Po ashtu departamenti i ka ftuar studentet të bëhen pjesë e “Multimedia Lab 2021”</p> <p>Një tjetër konferencë e rëndësishme në nivel ndërkombëtar si një bashkëpunim i disa departamenteve të KU Beder ishte edhe ajo e zhvilluar më 16 qershor “Transformimi digjital, gjatë dhe pas periudhës së pandemisë” e cila u zhvillua online.</p>			
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit</p>	<p>Promovimi i KU Beder dhe programeve të studimit për të gjithë të interesuarit bëhet me disa etapa dhe mënyra. Institucioni zhvillon edhe iniciativa të ndryshme edhe me publikimet në faqen zyrtare. Një format i mirë për të promovuar programet e studimit, sidomos ato të nivelit Master janë edhe aktivitetet ekstrakurikulare dhe konferencat e ndryshme me tematika të gjera, që e vendosin KU Beder në rolin e një promotori edhe të kërkimit shkencor. Gjithashtu, promovimi i këtij programi studimi realizohet tek studentët e Bachelor të cilët mund të përfshihen edhe në masterin Profesional. KU Beder ka bërë edhe promovimi te tarifave të studimit, ne zbritje nëse nga programi bachelor kalon në Master po brenda KU Beder.</p> <p><u>Referenca për Standard V.2</u></p> <p>Evidenca 7: Rregullorja e programit të studimit “Master professional” në “Komunikim Marketingu”</p> <p>Evidenca 34: Rregullorja e Studimeve dhe Provimeve të Ciklit të Dytë</p> <p>Evidenca 35: Guida e Studentit</p> <p>Evidenca 78: Manuali për përgatitjen e tezës dhe kriteret e vlerësimit të tezës për studentët e ciklit të dytë</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.</p>	<p>Në praktikën e KU Beder, java e parë e vitit akademik është javë orientuese për studentët. Gjatë kësaj javë janë disa proceduar me të cilat duhet të njihen studentët, siç janë njohja me stafin akademik dhe administrativ, njohja pranë sekretarisë mësimore, orari, organizimi i programit, etj. Gjithashtu një informim mjaft i mirë për studentët është “Guida e studentit” dhe kontakti me këshilltarin akademik të studentëve.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p> <p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Nëpërmjet sistemit BIS çdo student ka email e tij të dedikuar dhe merr prej saj mjaft informacione të vlefshme.</p> <p>Studentët gjithashtu marrin informacion të përditësuar për proceset mësimore edhe nëpërmjet takimeve me departamentin dhe prezantimin e lëndëve nga secili pedagog në seancat e para të mësimt. Gjithashtu, në vazhdimësi, përgjatë vitit akademik, sistemi BIS është burim informacioni për studentët dhe procesin mësimor, si edhe sekretarinë mësimore. Sistemi BIS si edhe platformat online të mësimdhënies u provuan të jenë efektive edhe gjatë pandemisë.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Në dokumentacionin e përcjellë nga KU Beder është edhe “Vendimi i këshillit të departamentit për përcaktimin e përfaqësuesit të karrierës” Sipas mbledhjes së departamentit, në fillim të çdo viti akademik përcaktohet edhe “Këshilltari i Karrierës nga Departamenti i Shkencave të Komunikimit për studentet. Zyra e këshillimit të karrierës informon studentët për mundësitë e punësimit. Gjatë bisedës së GVJ me studentët ata e vlerësonin këtë si një ndihmë në gjetjen e mundësive të punësimit. Edhe kontakti i drejtpërdrejtë me pedagogët si edhe praktikave profesionale i ndihmon studentet në gjetjen e mundësive të punësimit.</p> <p>Për të asistuar studentët mbi mundësitë e punësimit, GVJ u njoh gjatë vizitës në institucion edhe me dy projekte të zhvilluara nga vetë studentët në formatin e <i>start up</i> që ishin “Dritarja e mundësive” dhe “Dritarja e maturës”. Të dyja këto projekte kanë filluar si projekte studentore nga orë mësimore dhe tashmë menaxhohen krejtësisht nga studentët.</p> <p>“Dritarja e mundësive” është një platformë online për të rinjtë që ofron: (i) këshillim kariere për studentët; (ii) seminare online (çdo të martë) me të ftuar të ndryshëm; (iii) biseda interaktive me të ftuar për ecurinë e tyre për profesionit. Për të qenë ndryshe dhe sa më pranë ideve të studenteve, “Dritarja e mundësive” është përpjekur që edhe të ftuarit të jenë të një moshe të përafërt me studentët e Masterit, për t’u demonstruar atyre shembuj konkretë të <i>start-up</i> në karrierë nga një këndvështrim i ngjashme me atë të studentëve.</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

61

<p>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë</p>	<p>Që prej momentit të regjistrimit të studentit dhe nënshkrimit të kontratës, nga Zyra e TI çdo student merr një adresë e-mail individuale që përdoret për komunikim si për procesin mësimor, ashtu edhe për anën organizative. Një adresë të tillë institucionale emali kanë edhe pedagogët dhe stafi administrativ që lejon komunikimin e brendshëm.</p> <p>Sipas sistemit të informimit të Beder, BIS, studentët marrin të gjithë informacionin e nevojshëm nga sekretaria mësimore si edhe mund të komunikojnë me pedagogët për lëndët e ndryshme. Sistemi BIS dhe email është i lidhur me Gmail dhe pra informacionin me anën e email, studentët mund ta marrin edhe kur janë në distancë. Kjo u provua shumë e frytshme sidomos gjatë kohës së pandemisë kur edhe mësimi zhvillohej në distancë.</p> <p><u>Referenca për Standard V.3</u> Evidenca 7: Rregullorja e programit të studimit “Master professional” në “Komunikim Marketingu” Evidenca 21: Vendimi i këshillit të departamentit për përcakimin e përfaqësuesit të karrierës Evidenca 32: Vendimi i Këshillit të Departamentit për Emërimin e Koordinatorit të Programeve Master Evidenca 34: Rregullorja e Studimeve dhe Provimeve të Ciklit të Dytë Evidenca 35: Guida e Studentit Evidenca nr. 58 Udhëzues i sistemit informativ (BIS).pdf</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>		<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve në programin e studimit.</p>	<p>Pranë sekretarisë mësimore krijohet arkiva edhe fizike edhe online për të gjithë studentët e KU Beder. Çdo student ka një dosje ku gjendet dokumentacioni i kërkuar në hyrje të programit të studimit si edhe plotësimi i mëtejshëm me informacione mbi ecurinë e procesit mësimor dhe të dhënat e studentëve gjatë tij.</p> <p>Sipas “Rregullores së Zyrës së Sekretarisë Mësimore”, Neni 3 ka të përcaktuar të gjithë detyrat që ka Sekretaria mësimore. Në regjistrat themeltarë gjenden të gjitha informacionet për studentët. Në rregulloren e Sekretarisë mësimore i kushtohet kujdes edhe ruajtjes së të drejtës së privatisë për informacionet që i takojnë studentëve.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë, tërheqet nga programi,</p>	<p>Rregjistri themeltar i studentëve ka të gjithë informacionin për studentin, që nga momenti i fillimit të studimit, marrja e numrit të matrikullimit, provimet e kaluara, diplomimin dhe largimet nga programi nëse kjo ndodh. Të dhënat janë si më poshtë:</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

<p>si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<table border="1" data-bbox="687 215 1289 315"> <thead> <tr> <th>Numri i studentëve të regjistruar</th> <th>Per here të parë</th> <th>Nota mesatare</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2020-2021</td> <td>19</td> <td>7.6</td> </tr> </tbody> </table>	Numri i studentëve të regjistruar	Per here të parë	Nota mesatare	2020-2021	19	7.6
Numri i studentëve të regjistruar	Per here të parë	Nota mesatare					
2020-2021	19	7.6					
<p>Kriteri 3. Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi, deri në diplomimin e tyre.</p>	<p>Gjatë vizitës së GVJ në institucion u bënë me zgjedhje verifikimet e disa studenteve dhe ecuria e tyre në regjistrat e programit të institucionit. Në dosje ndodheshin informacioni si (i) formulari i vetëdeklarimit; (ii) kopje e kontratës; (iii) Diploma e Bachelor dhe lista e notave; (iv) Diploma e maturës; (v) fotokopje e ID; dhe (vi) CV.</p> <p>Në programin Master Profesional “Komunikim Marketingu të gjithë te regjistruarit vijnë nga Shqipëria dhe nuk ka të regjistruar nga vende të tjera.</p> <p>Në regjistrin themeltarë u panë studentet e programit Master Profesional “Komunikim Marketingu” u panë informacione për studentët. Ndërsa, mungonte fizikisht regjistri i notave vjetore, për arsye të mos tenderimet nga autoritetet publike pasi këto regjistra vijnë nga autoritetet rregullatore (Ministria e Arsimit) Gjithsesi, informacioni gjendej në sistemin BIS të universitetit dhe në procesverbalet e notave, të ruajtura fizikisht pranë sekretarisë mësimore.</p>						
<p>Kriteri 4. Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Sistemi BIS është në themel të informacionit dhe komunikimit me studentët. Ai administron të gjitha të dhënat e studenteve që nga fillimi i regjistrimit të tyre në universitet. Eficenca e këtij sistemi u provua sidomos edhe gjatë kohës së pandemisë.</p> <p>Edhe gjatë vizitës së GVJ në KU Beder u shikua mirëmbajtja dhe funksionimi i këtij sistemi.</p>						
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë të punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve</p>	<p>Sekretaria mësimore dhe Departamenti i Shkencave të Komunikimit mbajnë komunikim të rregullt për ecurinë e studentëve në programet mësimore. Bazuar mbi informacionin e përmbledhur nga sekretaria mësimore dhe nga zyra të tjera si ajo e Dekanit të studentëve apo Zyra e Këshillimit të Karrierës, Departamenti harton një raport vjetor që jep informacion të plotë për të gjithë studentët, sipas programeve të studimit që janë në këtë departament. Të dhënat statistikore përmbledhin edhe informacione për notën mesatare si edhe kufijtë në të cilët ajo luhet.</p> <p>Në shtojcat e RVB, tabela 21 prezantohet cilësia e studenteve në hyrje të programit të studimit. (Ky është viti I parë dhe nuk ka ende student të diplomuar në këtë program – për të dhënë edhe info për cilësinë në dalje të studentëve). Nota mesatare në hyrje për studentet e programit Master Profesional “Komunikim Marketingu” ishte 7.60</p> <p>Po kështu edhe Zyra e të Diplomuarave përgatit Raportin e saj “Raporti i zyrës së të diplomuarve”.</p> <p>Referenca për Standard V.4 Evidenca 12: Raport i Zyrës së të Diplomuarve Evidenca 21: Vendimi i këshillit të departamentit për përcakimin e përfaqësuesit të karrierës</p>						

	Evidenca 24: Raporti vjetor i Departamentit të Shkencave të Komunikimit, viti akademik 2019-2020 Evidenca 33: Rregullorja e Zyrës së Sekretarisë Mësimore Evidenca 40: Rregullorja e Organizimit Administrativ Evidenca nr. 58 Udhëzues i sistemit informativ (BIS) Raporti i Vlerësimit të Brendshëm, Shtojca, tabela 21 Evidence: Shenime nga vizita ne KU BEDER			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.</p> <p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Përfshirja e studentëve në organet vendimmarrëse në KU Beder është e sanksionuar që në statutin e KU Beder. Në nenin 10 të tij theksohet përbërja e Senatit Akademik me 11 anëtarë që përfshijnë:</p> <ol style="list-style-type: none"> <i>Rektori i Kolegjit Universitar "Bedër";</i> <i>Zv.rektori;</i> <i>Dekanët e fakulteteve të Kolegjit Universitar "Bedër";</i> <i>Përfaqësuesit e fakulteteve, nga 3 (tre) për çdo fakultet që zgjidhen drejtpërdrejtë nga asamblëta e personelit akademik me kohë të plotë të njëjësive kryesore;</i> <i>Përfaqësuesi i studentëve.</i> <p>Po kështu pjesëmarrja e studentëve është e garantuar edhe në Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Neni 28 i Statutit sanksionon pjesëmarrjen e studentëve ... "Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë, nga të cilët 1 (një) kryetar, 2 (dy) janë përfaqësues të personelit akademik të njëjësive kryesore një për çdo fakultet, 1 (një) përfaqësues i Këshillit Studentor dhe 1 (një) ekspert i jashtëm. Anëtarët e njëjësive miratohen nga Senati Akademik me propozim të rektorit.</p> <p>Studentët janë të organizuar edhe në Këshillat studentorë (sipas Nenit 99 të Statutit të KU Beder).</p> <p>Instrumentet për përfshirjen e studentëve në organizmat vendimmarrëse të KU BEDER ishin të ndryshme. Mendimi i të gjithë studentëve merrej në mënyrë anonime nëpërmjet pyetësorëve online. Rezultatet e pyetësorëve për pedagogët u jepen atyre dhe shërbejnë si një pikë orientuese. Anketimet e studenteve bëhen çdo semestër.</p> <p>Gjithashtu studentët janë pjesëmarrës në mbledhjet e departamentit sipas vendimit të marrë nga Senati për "Përfshirjen e Studentëve në Këshillin e Departamentit." Sikurse u cilësua edhe nga Përgjegjësi i departamentit në</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

64

	<p>takimin me GVJ, në mbledhjet e departamentit, çdo dy javë, ka gjithnjë studentë të pranishëm nga programet në varësi edhe të tematikave që trajtohen.</p> <p>Një nga studentët e Master i Profesional ka qenë pjesë e hartimit të Raportit të Vlerësimit të Brendshëm për këtë program studimi.</p> <p>Gjatë takimit të GVJ me grupin e studenteve në program, ata u shprehën pozitivisht për mundësitë që u ofron KU Beder në diskutime dhe kontakte shumë të afërta me pedagogët dhe departamentin.</p> <p>Gjithashtu KU Beder ka edhe zyrën e Dekanit të Studentëve e cila “... angazhohet në zgjidhjen e problemeve të studentëve në lidhje me jetën universitare, në bashkëpunim me njësitë administrative dhe akademike.”</p>
<p>Kriteri 3. Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, duke përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>Programet mësimore si edhe tërësia e lëndëve dhe syllabuseve përditësohen dhe përshtaten me nevojat e zhvillimit të programeve mësimore, duke u bazuar në legjislacionin aktual. Në ndërtimin dhe shpërndarjen e ngarkesës mësimore, programi është shpërndarë në ngarkesë të njëtrajtshe midis dy semestrave, duke konsideruar si një pjesë shumë të rëndësishme të formimit profesional pjesën e praktikës dhe punimit të diplomës. (60 kredite në çdo semestër).</p> <p>Departamenti sigurohet që ngarkesa akademike e studentëve të jetë kriter, kur bëhen rishikime të programeve të studimit, në mënyrë që barra të mos bjerë mbi studentët.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimin të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>Institucioni organizon fokus grupe, pyetësorëve online dhe mbledhje të hapura në departament për të marrë <i>feedback</i> dhe për të shikuar mundësitë e përmirësimin të programit të studimit.</p> <p>Studentët janë pjesëmarrës edhe në këshillin e departamentit që organizohen gjatë semestrit.</p>
<p>Kriteri 5. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Rregulloret e brendshme përcaktojnë edhe mënyrën e vlerësimit të studentëve. Më specifikisht kjo është detajuar edhe në syllabuset e secilës lëndë. Provimet janë të sekretuara dhe pas nxjerrjes së rezultateve, studentët kanë mundësinë të marrin sqarime nga pedagogët lidhur me procesin e vlerësimit. KU Beder ka hartuar edhe një procedurë për ankimin e notës e cila lehtëson mundësinë për të rikontrulluar dhe vlerësuar njohuritë në rast se studentët kanë çështje lidhur me vlerësimin në provime.</p> <p>Anketimet e studentëve plotësohen përpara hyrjes në sezonin e provimeve. Plotësimi i anketimeve bëhet online në sistemin BIS dhe është individual dhe anonim.</p> <p><u>Referenca për Standard V.5</u> Evidenca nr. 2 Statuti i Kolegjit Universitar Beder Evidenca 24: Raporti vjetor i Departamentit të Shkencave të Komunikimit, viti akademik 2019-2020 Evidenca 39: Vendimi i Senatit për Përfshirjen e Studentëve në Këshillin e Departamentit</p>

	Evidenca 64: Rregullorja për funksionimin dhe organizmin e NJSBC Evidenca 90: Procedurë për ankimimin e notës		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi V.6 Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve.	Për t'i shërbyer transparencës dhe informimit sa më të mirë të studentëve, KU Beder përdor si faqen online me informacionin respektiv sipas programeve të studimit, rrjetet sociale, guidat e studentit. Një tjetër mënyrë është edhe kontakti i drejtpërdrejtë me të gjitha zyrat duke nisur që nga Sekretaria Mësimore, Dekani i studentëve që ka në brendësi Zyrën e Këshillimit të Karrierës, Zyrën e të diplomuarve / Alumni etj.
Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit. .	Kontakt i drejtpërdrejtë i studentëve është edhe me këshilltarin akademik, departamentin dhe pedagogët për të marrë informacion mbi lëndët specifike, praktikat mësimore si edhe aktivitetet jashtë kurrikulare. Këshilltari Akademik dhe i Karrierës funksionon pranë çdo departamenti. Kjo i lehtëson studentet për t'u orientuar si në procesin mësimor ashtu edhe në programet e tjera dhe pjesëmarrjet në konferenca apo workshope.
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	Zyra e Këshillimit të Karrierës, e cila është pjesë e Zyrës së Dekanit të Studentëve iu siguron atyre mundësinë të marrin shërbime siç janë: praktika profesionale me kompani të njohura në vend, trajnime të paguara, apo pjesëmarrja në workshope që lidhen me hartimin e cv dhe përgatitjen për një intervistë pune. Zyra ka kontakt me studentët edhe nëpërmjet e-maileve që dërgonte më informacione, si edhe me takime të drejtpërdrejta.
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve, organeve dhe autoriteteve drejtuese përkatëse	Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Zyra e të Diplomuarve në mënyrë periodike përgatisin raporte mbi mundësitë e punësimit të studenteve. Gjatë takimit me studentë edhe në GVJ një pjesë e mirë e tyre ishin të punësuar. Sipas raportit të zyrës së të diplomuarve 84% e studentëve të programit Master janë të punësuar brenda dhe jashtë vendit si në institucione publike dhe private. Ndërkohë që KU Beder herë pas here është edhe pjesëmarrës në programe/panaire punësimi. <u>Referenca për Standard V.6</u> Evidenca 12: Raport i Zyrës së të Diplomuarve

	Evidenca 21: Vendimi i këshillit të departamentit për përcakimin e përfaqësuesit të karrierës Evidenca 24: Raporti vjetor i Departamentit të Shkencave të Komunikimit, viti akademik 2019-2020 Evidenca 40: Rregullorja e Organizimit Administrativ Raporti i Vlerësimit të Brendshëm, Shtojca, tabela 21			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X
Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT MASTER PROFESIONAL

Standardi VI.1

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	<p>KU Beder ka ndërtuar një sistem të sigurimit të brendshëm të cilësisë bazuar në aktet rregullatore të aprovuara si: (i) Statuti i Kolegjit Universitar Beder; (ii) Plani strategjik Institucional i KU “Bedër” 2018-2023; (iii) Procedura e vlerësimit të performancës së stafit akademik; (iv) Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e KP për garantimin e standardeve të cilësisë; (v) Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e NJSBC.</p> <p>Bazuar në rregulloren për funksionimin e “Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë e Kolegjit Universitar Bedër”, (NJSBC): Njësia është përgjegjës për monitorimin dhe koordinimin e veprimtarive të ndërmarra në kuadër të menaxhimit dhe vlerësimit akademik dhe administrativ, përmirësimin e cilësisë, planifikimin strategjik, vlerësimin institucional, vlerësimin e jashtëm, kontrollin periodik, si edhe ndjekjen e përmirësimit të cilësisë në Kolegjit Universitar “Bedër”.</p> <p>Në nenin 6 të kësaj rregullore është përcaktuar edhe përbërja e njësisë:</p> <p><i>Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë, nga të cilët 1 (një) kryetar, 2 (dy) janë përfaqësues të personelit akademik të njësisë kryesore një për çdo fakultet, 1 (një) përfaqësues i Këshillit Studentor dhe 1 (një) ekspert i jashtëm. Anëtarët e njësisë miratohen nga Senati Akademik me propozim të rektorit.</i></p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

67

	<p>Edhe “Plani strategjik Institucional i KU “Bedër” 2018-2023” ka të përfshira masa për ruajtjen dhe rritjen më tej të cilësisë.</p> <p>E gjithë kjo bazë rregullatore mbështetet në Ligjin “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në ILA, në Republikën e Shqipërisë”.</p> <p>KU Beder i kushton vëmendje zbatimit të bazës ligjore rregullatore për cilësinë në universitet.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>KU Bedër ka ndërtuar Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë si edhe Komisionin e Përhershëm për Vlerësim Institucional. Në NJSBC, nëpërmjet Këshilli Studentor është pjesëmarrës edhe një student. Edhe grupet e vlerësimit të brendshëm kanë në përbërjen e tyre studentë.</p> <p>Sipas evidencave të përcjella nga KU Beder, dhe bazuar në rregulloren për funksionimin e “Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë e Kolegjit Universitar Bedër”, Neni 14 përcaktohet edhe periudha dhe kalendari i vlerësimit të brendshëm</p> <p><i>“Kryhen të gjitha punimet e “Vlerësimit të brendshëm” në të gjitha njësitë, në bazë të modelit dhe rregullave të vlerësimit të brendshëm të përcaktuara në udhëzuesin mbi vlerësimin dhe zhvillimin e cilësisë. Raportet e vlerësimit të brendshëm të njësive dhe raporti i vlerësimit të brendshëm të Kolegjit Universitar “Bedër” përgatiten çdo vit brenda afateve ligjore”</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni i arsimit të lartë përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>Sigurimi i jashtëm i cilësisë realizohet në saj të bashkëpunimit me Agjencinë e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, ASCAL.</p> <p>KU Beder është akredituar institucionalisht për një afat 4 vjeçar sipas vendimit të Bordit të Akreditimit të ASCAL nr. 101 datë 10.11.2017, për akreditimin e KU Beder.</p> <p>Përveç akreditimit institucional, KU Beder ka vijuar edhe me akreditimin e programeve të studimit.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të SBC-së. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.</p>	<p>KU Beder ka të ndërtuara procedura të qarta për sigurimin e cilësisë së programeve që ofron. Ai ka të hartuar Planin Strategjik institucional të Zhvillimit ku përfshihen edhe elementë për sigurimin e Brendshëm të cilësisë, 20180 - 2023.</p> <p>Plani strategjik institucional i KU Beder jep si objektiva strategjik për një arsim më cilësor:</p> <ol style="list-style-type: none"> <i>Sigurimi i një arsimit cilësor që promovon nëpërmjet vlerësimit mendim kritik dhe përgatitjen e studentëve për identifikimin, ndërtimin dhe vlerësimin e argumenteve;</i> <i>Sigurimi i një cilësie arsimore që i pajis studentët me aftësi praktike për një përshtatje më të mirë me mjedisin e ardhshëm të punës</i> <i>Kritja e mundësive dhe përvojave ndërkombëtare për studentët</i>

	<p>Strategjia përshkruan edhe nismat për konkretizim që duhet realizuar për të realizuar objektivat strategjikë.</p> <p>Referenca për Standard VI.1</p> <p>Evidenca 2: Statuti i Kolegjit Universitar Beder</p> <p>Evidenca 6: Plani strategjik Institucional i KU "Bedër" 2018-2023</p> <p>Evidenca 24: Raporti vjetor i Departamentit të Shkencave të Komunikimit, viti akademik 2019-2020</p> <p>Evidenca 40: Rregullorja e Organizimit Administrativ</p> <p>Evidenca 47: Procedura e vlerësimit të performancës së stafit akademik</p> <p>Evidenca 63: Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e KP për garantimin e standardeve të cilësisë</p> <p>Evidenca 64: Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e NJSBC</p> <p>Evidenca 65: Shkresa nga NJSBC te HR</p> <p>Evidenca 91: Vendim i BA Nr. 101, datë 10.11.2017 "Për akreditimin periodik të Institucionit të Arsimit të Lartë, Kolegji Universitar "Bedër"</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të dytë.</p>	<p>KU Beder ka të ngritura dy njësi me qëllim sigurimin e cilësisë në programet e studimit. Këto janë: "Njësia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë" NJSCB dhe Komisioni i Përhershëm për garantimin e standardeve për sigurimin e cilësisë institucionale dhe të programeve të studimit, KP.</p> <p>Komisioni i Përhershëm, ka funksionet si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Miraton politikat dhe procedurat për sigurimin e cilësisë. 2. Miraton standarde dhe procedura që zbatohen në mënyrë uniforme në njësitë e institucionit, duke marrë për bazë profilin e IAL. 3. Përcakton kritere dhe masa që mundësojnë të identifikohet suksesi dhe mos përmbushja e objektivave në veprimtarinë e institucionit. 4. Miraton, monitoron dhe kryen vlerësime periodike të programeve, në bashkëpunim me njësitë e tjera të Kolegjit. 5. Monitoron sigurimin e cilësisë së stafit akademik. 6. Koordinon ndërlidhjen me njësitë e tjera kryesore dhe bazë të institucionit dhe menaxhon sistemin e informacionit ndërmjet këtyre njësive. 7. Nxjerr urdhra dhe direktiva që i zbaton Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al



	<p>Detyrat dhe kompetencat e NJSBC janë të përcaktuara në rregulloren përkatëse, neni 11.</p> <p>Ndërkohë që një rol të rëndësishëm në sigurimin e cilësisë ka edhe secili departament ku mbështetet programi i studimit</p> <p><i>Çdo departament cakton një asistent me vendim të Këshillit të Departamentit pranë NJSBC me qëllim që të ofrojnë asistencën e tyre në mbarëvajtjen e veprimtarisë së NJSBC. Asistenti i departamentit koordinon punët në departament lidhur me sigurimin e brendshëm të cilësisë, ai ushtron detyrën e tij në bashkëpunim me njësitë e tjera nën varësinë e NJSBC". Ai drejton dhe koordinon punën e tij, njofton departamentin përkatës për vendimet e marra, mbikëqyr zbatimin e procesit të punës në kuadrin e sigurimit të cilësisë dhe monitoron rezultatet e kësaj pune si dhe informon NJSBC për mbarëvajtjen e punëve në departamentin përgjegjës.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>Në KU Beder ka të zhvilluara një sërë formash anketimi të cilat e masin cilësinë e programit nëpërmjet disa pikëpamjeve: atë të studentëve, stafit pedagogjik dhe stafit administrative. Këto instrumente anketuese janë të miratuara si format, por me një përmbajtje e cila përditësohet sipas programeve të anketuara dh kërkesave të reja që sjell zhvillimi institucional.</p> <p>Në KU Beder dhe po kështu në Departamentin e Shkencave të Komunikimit, si edhe me studentët dhe pedagogët e “Master Profesional në Komunikim Marketing” zhvillohen në mënyrë periodike 5 anketa: anketa e stafit administrativ për vlerësimin e institucionit; anketa e pedagogëve për vlerësimin e institucionit; anketa e studentëve për vlerësimin e lëndëve; anketa e studentëve për vlerësimin e institucionit si dhe këtë vit ishte shtuar edhe anketa e studentëve për vlerësimin e cilësisë së mësimit të zhvilluar online.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni i arsimit të lartë përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të studimeve.</p>	<p>Në KU Beder dhe po kështu në Departamentin e Shkencave të Komunikimit, si edhe me studentët dhe pedagogët e “Master Profesional në Komunikim Marketing” zhvillohen në mënyrë periodike 5 anketa: anketa e stafit administrativ për vlerësimin e institucionit; anketa e pedagogëve për vlerësimin e institucionit; anketa e studentëve për vlerësimin e lëndëve; anketa e studentëve për vlerësimin e institucionit si dhe këtë vit ishte shtuar edhe anketa e studentëve për vlerësimin e cilësisë së mësimit të zhvilluar online.</p>
<p>Kriteri 4. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Gjithashtu për vlerësimin e programit të studimit, në fillim të çdo viti akademik, departamentet e KU Beder bëjnë seancat për rishikimin e syllabuseve dhe vlerësimin e tyre. Ky proces realizohet edhe në bashkëpunim me Zyrën e Zhvillimit të Kurikulave e cila ka si funksion monitorimin e këtij procesi ndryshimi.</p> <p>Rezultatet e anketimeve, përcillen si në nivel departamenti për programet edhe profesoratin, ashtu edhe në nivel Dekanati dhe Rektorati. Rezultatet për profesorët, u jepen profesorëve të lëndës dhe përgjegjës të departamentit, por duke treguar kujdes në respektimin e të drejtave të privatësisë.</p>
<p>Kriteri 5. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë</p>	<p>Informacioni i mbledhur si pasojë e vlerësimeve publikohet në faqen online të KU Beder. http://qac.beder.edu.al/</p> <p>Kjo nënfaqe është e dedikuar sigurimit të cilësisë dhe aty jepen edhe rezultatet e anketimit. Në të janë të publikuara edhe Raporti Vjetor i NJSBC, sie dhe mjaft materiale informuese për NJSBC.</p> <p>http://qac.beder.edu.al/pages.php?s=14&cid=19 në këtë format janë edhe rezulttet e anketimit.</p> <p>Dokumentet e përcjellë përfshijnë edhe komunikimin me email midis zyrave për transmetimin e informacionit të mbledhur nga komisioni i sigurimit të cilësisë KSBC drejt rektoratit.</p>

	<p>Masat për ndryshim realizohen në mbledhjet e departamenteve dhe më tej, në vendimet e Dekanit dhe Rektorit.</p> <p>Gjatë vizitës së GVJ në KU Beder dhe takimit me zyrën e Burimeve Njerëzore dhe me NJSBC GVJ u informua se nuk ka patur vlerësime negative, dhe për rrjedhojë as raste për t'u evidentuar në masa të marra ndaj stafit.</p> <p><u>Referenca për Standard VI.2</u></p> <p>Evidenca 2: Statuti i Kolegjit Universitar Beder</p> <p>Evidenca 6: Plani strategjik Institucional i KU "Bedër" 2018-2023</p> <p>Evidenca 24: Raporti vjetor i Departamentit të Shkencave të Komunikimit, viti akademik 2019-2020</p> <p>Evidenca 40: Rregullorja e Organizimit Administrativ</p> <p>Evidenca 47: Procedura e vlerësimit të performancës së stafit akademik</p> <p>Evidenca 63: Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e KP për garantimin e standardeve të cilësisë</p> <p>Evidenca 64: Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e NJSBC</p> <p>Evidenca 65: Shkresa nga NJSBC te HR</p> <p>Evidenca 91: Vendim i BA Nr. 101, datë 10.11.2017 "Për akreditimin periodik të Institucionit të Arsimit të Lartë, Kolegji Universitar "Bedër""</p> <p>http://qac.beder.edu.al/uploads/pdocs/raportivjetorinjbscse20172018288</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3

Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësi e brendshme e cilësisë që lidhet me këtë program studimi. Institucioni i arsimit të lartë e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p>	<p>NJSBC që vepron në KU Beder që prej vitit 2014 është e angazhuar për vlerësimin edhe të performancës së programeve të studimit, edhe për cilësinë dhe mësimdhënien dhe programin akademik. Neni 11 i rregullores për funksionin dhe organizimin e NJSBC jep të gjitha detyrat dhe kompetencat e saj.</p> <p>Si një ndër instrumentet kryesorë të matjes së performancës janë edhe pyetësorët dhe anketimet që bëhen me stafin dhe studentët. Vlerësimet për lëndët bëhen në fund të semestrit, pasi lënda është ofruar për studentët. Vlerësimi për pedagogët, bazohet në rregulloren e anketave dhe vlerësimeve. Ata vlerësohen nga studentët, nga përgjegjësi i departamentit, si edhe me procesin e vetëvlerësimit. Për pedagogët e rinj, apo edhe në rast se ka problematika me studentët që janë evidentuar, përgjegjësi i departamentit ku zhvillohet programi i studimit, mund të hyjë edhe të asistojë/vëzhgojë një orë mësimi së bashku me një koleg të fushës përkatëse të studimit.</p> <p>Gjetjet e anketimeve, raportohen në mënyrë individuale te pedagogët dhe përgjegjësi i departamentit, ndërsa tek zyra e Zhvillimit të Karrierës dërgohen</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

71

	<p>informacion përmblledhës nëse do të duhet të ndryshohet diçka si propozim ne kurikulën e një programi.</p> <p>GVJ iu prezantuan nga përgjegjësi i departamentit të Shkencave të Komunikimit edhe fokus grupe të zhvilluara nga KU Beder, si metodë e vlerësimit.</p> <p>Një metodë efikase e vlerësimit të ecurisë së punës, është ndërtimi i Raportit Vjetor të secilit departament dhe raporti në mbledhje të zgjeruara i kësaj ecurie. Këto analiza shërbejnë edhe për të përmirësuar punën në të ardhmen dhe për të planifikuar aktivitete të ndryshme në vitin e ardhshëm akademik.</p> <p>KU Beder ka ngritur grupin për vlerësimin e brendshëm të këtij programi, i cili vlerësohet për herë të parë. Grupi ka në përbërje të tij, si pedagogë ashtu edhe studentë, duke përmblusur kështu kërkesat ligjore. Raporti i Vlerësimit të Brendshëm është i plotë me të gjitha komponentët e tij.</p>
<p>Kriteri 2. Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>Metodat e vlerësimit të përdorura për matjen e cilësisë në këtë program janë kryesisht anketimet. Si metodë e tërthortë përdoret edhe performanca dhe pjesëmarrja e studentëve në konferenca të hapura dhe workshope dhe prezantimi atje i punimeve të ndryshme. Kjo është e lidhur më tepër edhe me natyrën e programit të studimit që është Master Profesional dhe është i lidhur ngushtësisht edhe me detyra konkrete praktike të studentëve.</p> <p>Për më gjerë studentët e kanë të mundur komunikimin e drejtpërdrejtë me departamentin dhe pedagogët individualë.</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni i arsimit të lartë, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit, përdor metoda të drejtpërdrejta, si: vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>Për shkak të situatës me pandeminë Covid-19, KU Beder ka realizuar anketim për çështje të cilat të paplanifikuara dhe mësimin tërësisht online.</p> <p>Sikurse përshkruhet te rregullore, por edhe në RVB, në rast të problematikave të caktuara, KU Beder mund të ngrejë komisioni ad-hoc. Edhe këto komisione kanë të drejtë të përdorin instrumente te drejtpërdrejta të vlerësimit si vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies, kurikulës, vlerësime me sondim të disa provimeve apo edhe testimet e tjera jashtë radhe.</p> <p>Bazuar në Rregulloren e NJSBC “...Standardet përcaktohen në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe të Bashkimit Europian dhe zbatimi i tyre pasqyrohet në planet e veprimit të Kolegjit Universitar “Bedër” dhe të të gjitha njësive. Aktivitetet që do të zbatohen në kuadër të aplikimit të standardeve të kontrollit të brendshëm, do të përgatiten në mënyrë periodike dhe do të parashikohen në planin e veprimit të kontrollit të brendshëm. Planet e veprimit për vitin pasardhës përgatiten në muajin dhjetor të vitit paraardhës. Zbatimi i sistemit të kontrollit të brendshëm, si dhe i monitorimit dhe vlerësimit, pasqyrohen në raportet e kontrollit të brendshëm. Afati i dorëzimit të raporteve përcaktohet me vendim të NJSBC-së.”</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit, përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e</p>	<p>Përfshirja e studentëve është kryesisht nëpërmjet kontakteve të drejtpërdrejta me pedagogët dhe përgjigjësin e departamentit si edhe anketimet e standartizuara dy herë në vit për mësimin dhe institucionin.</p> <p><u>Referenca për Standard V1.3</u> Evidenca 2: Statuti i Kolegjit Universitar Beder</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

72

<p>institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</p>	<p>Evidenca 6: Plani strategjik Institucional i KU “Beder” 2018-2023 Evidenca 24: Raporti vjetor i Departamentit të Shkencave të Komunikimit, viti akademik 2019-2020 Evidenca 40: Rregullorja e Organizimit Administrativ Evidenca 42: Formulari i vlerësimit të performancës së stafit Evidenca 43: Rregullorja e anketave dhe vlerësimeve Evidenca 44 Anketa e posaçme realizuar në kushtet e pandemisë Covid-19 Evidenca 45: Anketa vlerësuese për lëndën dhe pedagogun nga studentët Evidenca 46: Raport i Këshillit studentor Evidenca 47: Procedura e vlerësimit të performancës së stafit akademik Evidenca 63: Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e KP për garantimin e standardeve të cilësisë Evidenca 64: Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e NJSBC Evidenca 65: Shkresa nga NJSBC te HR Evidenca 66: Anketa Vlerësuese nga Staf Akademik ndaj institucionit.pdf Evidenca 89: Formulari i vetëvlerësimit për stafin akademik. Evidenca 90: Procedurë për ankimimin e notës.pdf</p>						
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="564 770 778 842">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="778 770 983 842">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="983 770 1187 842">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="564 842 778 880"></td> <td data-bbox="778 842 983 880"></td> <td data-bbox="983 842 1187 880" style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht					
		X					

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, stafin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>KU Beder ka si anëtar të NJSBC dhe një ekspert të jashtëm që shërben për të sjellë në institucion edhe frymën e tregut të punës dhe një këndvështrim më të gjerë për një arsimin cilësor. Po ashtu në NJSBC është anëtar edhe një student i zgjedhur në Këshilli studentor</p> <p>Njësia e Sigurimit të Cilësisë, është operacionale dhe zhvillon rregullisht procese të matjes së cilësisë në institucion duke përfshirë të gjitha grupet e interesit, si: studentë, stafin pedagogjik, stafin administrative. Anëtarët e saj zgjidhen çdo dy vjet nga Senati i KU Beder.</p> <p>Hartimi i politikave dhe monitorimi i zbatimit të tyre realizohet nga Komisioni i Përhershëm i Sigurimit të Cilësisë si organ më i lartë i sanksionuar edhe në Statutin e KU Beder.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Në dokumentin “Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e NJSBC” jepen edhe detyrat dhe përgjegjësitë e anëtarëve të saj. Ndërkohë në garantimin e mbarëvajtjes së procesit mësimor një rol shumë të rëndësishëm luajnë edhe njësi të tjera të KU Beder sipas programeve të studimit si departamenti dhe koordinatori i programit. (Rregullorja Nenet 12-16)</p> <p>Ndërsa KP (Komisioni i Përhershëm – sipas “Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e KP për garantimin e standardeve të cilësisë.”) është një organ kolegjal dhe shtrihet në nivel institucional. KP ngarkohet të koordinojë</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

73

	<p>procesin e sigurimit të brendshëm të cilësisë, duke pasur përgjegjësitë e tij në:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Organizimin e një rrjeti cilësie të brendshëm; 2. Nxitjen e shkëmbimit të informacionit ndërmjet njërive; 3. Zhvillimin e procesit të nxënies në tre hapa: mëso, apliko, shpërndaj; 4. Riorganizimin e aftësive specifike në institucion; 5. Promovimin e ideve inovatore me qëllim zgjidhjen e problemeve; 6. Matjen dhe evidentimin e përmirësimeve në arritjen e cilësisë; 7. Sigurimin e cilësisë; 8. Analizimin e raporteve të përvitshme që vijnë nga çdo njësi rreth aktiviteteve të kryera, në bashkëpunim me Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë; 9. Auditimin e aktiviteteve në bashkëpunim me Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Në proceset e vlerësimit të cilësisë në KU Beder marrin pjesë shumë individë dhe përfaqësues të grupeve që përfshijnë: studentët, stafin akademik dhe stafin administrativ. NJSBC realizon një bashkëpunim dhe koordinim të punës për vlerësimin e brendshëm të cilësisë dhe bashkëpunon me njësinë baze dhe kryesore. Disa ndër kompetencat kryesore të saj përfshijnë edhe:</p> <p><i>Të vlerësojë, në mënyrë periodike, rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore shkencore në njësitë kryesore të Kolegjit, në përputhje me standardet.</i></p> <p><i>Të kryejë studime gjurmuese për të vlerësuar ecurinë e punësimit të studentëve dhe efikasitetin e programeve të ofruara nga Kolegji, në bashkëpunim me njësitë përkatëse.</i></p> <p><i>Të hulumtojë në lidhje me modelet e ndryshme, në kuadër të përmirësimit të cilësisë, që mund të merren si shembull, si edhe shpërndarjen e tyre në njësitë e tjera akademike dhe administrative.</i></p>
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Departamenti analizon në fund të çdo vitit akademik analizën e punës përgjatë vitit dhe duke evidentuar problematikat dhe sfidat e kapërcyera.</p>
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vëra në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj</p>	<p>Disa nga instrumentet/format e tjera që përdoren në KU Beder për vlerësim janë përmendur edhe më lart në kriteret e tjera. Të përmblodhura janë: (i) Vlerësimi i personelit në fund të çdo semestri/viti akademik; (ii) Njësia bazë organizon prezantime të hapura dhe analizat vjetore; (iii) Organizimi nga departamentet i seminareve për përditësimin e syllabuseve; (iv) takimet konsultative me profesionistë të fushave respektive për të përcjellë kërkesat e tregut të punës dhe zhvillimet e reja dhe për ti bërë ato pjesë të kurikulës.</p> <p>Respektimi i integritetit akademik dhe shmangja e proceseve diskriminuese apo pabarazie mes stafit apo studentëve realizohet edhe nëpërmjet anonimitetit që ruhet në plotësimin e pyetësorëve. Të dhënat janë të</p>

	<p>drejtpërdrejta për secilin anëtar të stafit, dhe instancën raportuese të drejtpërdrejte por nuk kalojnë nga një pedagog tek tjetri. Vlerësimi që bëjnë studentët është tërësisht anonim.</p> <p>Siç u citua në kriteret më sipër, “Rregullorja e Njesisë për Sigurimin e Cilësisë” në KU Beder përcakton anëtarësinë e një eksperti të jashtëm dhe anëtari tjetër student. Të dy këta anëtarë, i janë shtuar njesisë në fund të vitit 2020 (23.12.2020)</p> <p><u>Referenca për Standard VI.4</u> Evidenca 24: Raporti vjetor i Departamentit të Shkencave të Komunikimit, viti akademik 2019-2020 Evidenca 42: Formulari i vlerësimit të performancës së stafit Evidenca 43: Rregullorja e anketave dhe vlerësimeve Evidenca 44 Anketa e posaçme realizuar në kushtet e pandemisë Covid-19 Evidenca 45: Anketa vlerësuese për lëndën dhe pedagogun nga studentët Evidenca 47: Procedura e vlerësimit të performancës së stafit akademik Evidenca 63: Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e KP për garantimin e standardeve të cilësisë Evidenca 64: Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e NJSBC Evidenca 66: Anketa Vlerësuese nga Stafi Akademik ndaj institucionit Evidenca 89: Formulari i vetëvlerësimit për stafin akademik.</p> <p><u>Dokumentet shtesë pas vizitës së GVJ në KU Beder</u> 1.Procesverbal i një mbledhje te departamentit ku është diskutuar për rishikimin e syllabuseve 3.2 Konkluzionet dhe sugjerimet ne baze te rezultateve te anketës</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të SBC për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>Bërja publike dhe transparenca e proceseve të vlerësimit dhe rezultateve të vlerësimit realizohet në disa mënyra duke pasur parasysh edhe ruajtjen e konfidencialitetit dhe të drejtën e privatisë.</p> <p>http://qac.beder.edu.al/uploads/pdocs/raportivjetorinjbcse20172018288 Në këtë nënfaqe janë të publikuara raportet vjetore të NJSBC si dhe më tej publikohen rezultatet e anketimit. Studentët dhe publiku mund të njihet me rezultatet e përmbledhura të anketimit si pasojë e vlerësimeve publikohet në faqen online të KU Beder. http://qac.beder.edu.al/.</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>Sigurimi i cilësisë dhe rezultatet e anketimit janë të publikuara edhe Raporti Vjetor i NJSBC, si edhe mjaft materiale informuse për NJSBC. http://qac.beder.edu.al/pages.php?s=14&cid=19 në këtë format janë edhe rezultatet e anketimit.</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

75

	<p>Gjithashtu një grup i rëndësishëm dokumentesh dhe rregulloresh gjenden në faqen web të KU Beder</p> <p>https://www.beder.edu.al/sh/fcontent/default/rregulloret-akademike-administrative-3/187/204</p>
<p>Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>Rezultatet nga anketimet analizohen dhe diskutohen në njësinë bazë dhe kryesore për të nxjerrë një plan masash veprimi për ndryshimin e pikave që mund të jenë të dobëta.</p> <p>Të dhënat nga pyetësorët vetë-vlerësues shfrytëzohen edhe të bërë krahasime në periudha kohore dhe për të bërë vlerësim të performancës.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Departamenti i përdor rezultatet e anketimeve edhe individualisht për çdo pedagog për të dhënë info, edhe në departament duke i analizuar ato me studentët në mbledhjet e hapura në semestër.</p> <p>Sikurse përshkruhet edhe në Rregulloren e NJSBC, për problematika të veçanta ngrihen komisione ad-hoc, ose grupe pune.</p> <p>Shembulli i dhënë me dokumentacioni është ai i hartimit të plan veprimit për kërkimin shkencor. Dokumenti përcakton masat që duhet të merren, personat përgjegjës dhe afatet kohore. (Evidenca 92)</p> <p>Evidenca 94: “Njoftim për fillimin e auditimit të brendshëm” është një shembull i ndërtimit të modaliteteve dhe procesit vetkontrollues të KU Beder për të gjitha njësitë me synim përmirësimin e procedurave dhe rritjen e cilësisë. Ky proces tërësor që auditoi si zyrat administrative ashtu edhe pjesë të edukimit akademik, përfundon me një raport të detajuar që i shërben përmirësimin të cilësisë në të gjitha njësitë e audituara.</p> <p>NJSBC e KU Beder ndjek me kujdes zbatimin e rekomandimeve të lëna edhe nga grupet e vlerësimit të jashtëm.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin e afatgjatë të cilësisë së programit të studimit</p>	<p>KU Beder ka dy guida/udhërrëfyes shumë të detajuar, për studentin dhe personelin/Stafin në mënyrë që ata të marrin informacionin e nevojshëm. Këto materiale janë informuese mbi proceset vlerësuese në institucion.</p> <p>Rol mjaft të rëndësishëm për sigurimin e cilësisë në programin e studimit kanë edhe koordinorët e programeve dhe përgjegjësit e departamenteve. Këtu ofrohen një informacion më specifik në varësi të programeve të studimit. Kjo realizohet edhe nëpërmjet pjesëmarrjes së gjithë stafit të departamentit dhe grupeve studentore në mbledhje të hapura dhe këshillat e departamenteve.</p> <p><u>Referenca për Standard VI.5</u></p> <p>Evidenca 22: Vendimi i këshillit të departamentit për caktimin e këshilltarëve akademike</p> <p>Evidenca 24: Raporti vjetor i Departamentit të Shkencave të Komunikimit, viti akademik 2019-2020</p> <p>Evidenca 35: Guida e Studentit</p> <p>Evidenca 42: Formulari i vlerësimit të performancës së stafit</p> <p>Evidenca 43: Rregullorja e anketave dhe vlerësimeve</p> <p>Evidenca 44 Anketa e posaçme realizuar në kushtet e pandemisë Covid-19</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”, Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

76

	Evidenca 45: Anketa vlerësuese për lëndën dhe pedagogun nga studentët Evidenca 47: Procedura e vlerësimit të performancës së stafit akademik Evidenca 54: Guida e Stafit Evidenca 63: Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e KP për garantimin e standardeve të cilësisë Evidenca 64: Rregullorja për funksionimin dhe organizimin e NJSBC Evidenca 66: Anketa Vlerësuese nga Stafi Akademik ndaj institucionit Evidenca 89: Formulari i vetëvlerësimit për stafin akademik. Evidenca 92: Plan veprimi për vlerësimin institucional të kërkimit shkencor Evidenca 94: "Njoftim për fillimin e auditimit të brendshëm"			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional në "Komunikim Marketingu" të "KU Beder"

Pikat e forta dhe afirmime

1. Megjithëse në vitin e parë akademik të implementimit në KU Beder, programi i studimit MP "Komunikim Marketingu" tregon se bazohet mbi një vizion dhe objektiva të qarta strategjike, si dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës.
2. Gërshetimi harmonik mes aspektit teorik dhe atij praktik gjatë realizimit të programit të studimit. Për nga vetë natyra e programit është e rëndësishme që studentët të marrin në mënyrë të koordinuar dijet teorike që parashikohen në kurikula me shprehitë aplikative që zhvillohen gjatë praktikës profesionale.
3. Qëndrueshmëria e personelit akademik të brendshëm. Personeli akademik efektiv i angazhuar në realizimin e programit të studimit "Master Profesional në Komunikim Marketingu" kontribuon me nivel të lartë të përgatitjes profesionale dhe eksperiencë në fushën e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor në profilin përkatës.
4. Personeli me kohë të pjesshme dhe lektorët e ftuar që vijnë nga institucione të ndryshme si ato të medias, marrëdhënies me publikun dhe marketingut, sjellin në auditor një qasje praktike e aplikative, duke i orientuar më mirë studentët drejt përvetësimit të kompetencave profesionale.
5. Mundësitë për bursa studimi si dhe tarifat jo të larta të studimit në raport me IAL-të e tjera jo publike, u jep mundësi për të studiuar në këtë program edhe grupeve të ndryshme shoqërore.
6. Sistemi i automatizimit (BIS) lehtëson aktivitetin mësimdhënës dhe mësimnxënës. Sistemi i automatizimit krijon mundësi për të realizuar leksione, projekte, aktivitete kreative duke përdorur multimedien dhe aplikuar interaktivitetin, si një element shumë i rëndësishëm për të rritur aftësitë perceptuese dhe përvetësuese tek studentët.

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel:+355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

7. Diskutimet dhe puna në grup mbi interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave të ndryshme si dhe çështjeve sociale apo në lidhje me komunitetin, ku ftohen edhe përfaqësues të studentëve. Përdorimi i metodave të avancuara të mësimdhënies dhe aplikimi i vazhdueshëm i teknologjisë si nga ana e stafit akademik, ashtu dhe e studentëve në komunikime gjatë orëve të mësimit dhe jashtë tyre e bën shumë të lehtë kalimin nga leksionet fizike në ato online në kushtet e gjendjes së jashtëzakonshme të shkaktuar nga pandemia Covid-19, duke siguruar një proces të vazhdueshëm mësimor në kohë reale.
8. Bashkëpunimi me agjencitë e marketingut dhe komunikimit, institucionet mediatike dhe të llojeve të tjera që i mundësojnë studentëve përfshirjen në jetën profesionale që gjatë kohës së studimeve. Institucioni ka vendosur marrëdhënie të qëndrueshme me aktorë të jashtëm në mbështetje të përfimitit të studentëve për praktika pune.
9. Biblioteka e KU Bedër është një burim shumë i mirë literature si klasike ashtu dhe online. Marrëveshja me një ndër platformat më të mëdha në botë, siç është "JSTOR" ka rritur mundësinë e studentëve për të konsultuar literature bashkëkohore në fushën përkatëse.
10. Planifikimi i mirë i karrierës profesionale, i cili nis që me praktikat e gjetura dhe të organizuara nga departamenti në bashkëpunim të ngushtë me Zyrën e Planifikimit të Karrierës. Angazhimi i përfaqësuesit të departamentit pranë Zyrës së Planifikimit të karrierës përbën një avantazh për studentët. Media online www.objektiv.al një mundësi më shumë për të bërë praktikë dhe për studentët për të patur njohuri nga tregu mediatik

Pikat e dobëta

1. Literaturë e pamjaftueshme në gjuhën shqipe (origjinale dhe e përkthyer). Ndonëse në disa raste ekzistojnë botime në gjuhën shqipe, mbetet sërish shqetësim përditësimi i tyre me zhvillimet më të fundit të fushës.
2. Nevoja për forcimin e komponentit të pjesëmarrjes në projekte ndërkombëtare universitare dhe futja në network-e universitare, duke respektuar statusin e Kolegjit Universitar (që është i ndryshëm nga ai si Universitet);
3. Rënie e interesit të studentëve ndaj librit dhe të lexuarit në përgjithësi. Të ndikuar nga zhvillimet teknologjike dhe stili i komunikimit në hapësirën virtuale, studentët e rinj nuk tregojnë interesin e duhur për librin dhe të lexuarin.
4. Ndryshimet që pëson herë pas here tregu i punës krijojnë pasiguri tek të rinjtë ndaj shkencave shoqërore.

Rekomandime:

1. Vijimi i përpjekjeve të Fakultetit të Shkencave Humane dhe Drejtësi, si dhe Departamenti i Shkencave të Komunikimit për të rritur numrin e personelit akademik me kohë të plotë me grada dhe tituj shkencorë (sidomos "Profesor" dhe "Profesor i Asociuar"), që përfshihen dhe në programin e studimit MP "Komunikim Marketingu".
2. Pasurimi i fondit të bibliotekës në KU Bedër, që nevojitet për studentët që ndjekin programin e studimit MP "Komunikim Marketingu", duke shtuar publikime (print ose dixhital) të viteve të fundit dhe nga autorë prominentë të fushës.
3. Institucioni duhet të vijojë më tej përpjekjet për të tërhequr studentë shqipfolës nga treva jashtë Shqipërisë, për t'u bërë pjesë e programit.

Adresa: "Rruga e Durrësit", Nr. 219 Tiranë

E-mail: info@ascal.al

Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al


78

4. Institucioni duhet të forcojë më tej mobilitetet e studentëve me universitetet jashtë vendit, në kuadër të projekteve, për të kapërcyer edhe ndikimin nga pandemia COVID-19 e këtyre dy viteve. Departamenti i Shkencave të Komunikimit dhe KU Beder në tërësi duhet të forcojë komponentin e pjesëmarrjes në projekte ndërkombëtare, për kërkimin shkencor si edhe projektet e BE. Kjo është sidomos e nevojshme në ato të projekteve universitare dhe shkëmbimit të studentëve dhe pedagogëve.

Conclusions of the Evaluation of the study program of the second cycle Professional Master "Marketing Communication" of the " University College "Beder" "

Strengths and affirmations

1. The study program MP "Marketing Communication" demonstrate that it is based on a clear vision, and strategic objectives, although it is in its first academic year of implementation in UC "Bedër". It shows as well as that is in accordance with the requirements of the labor market.
2. There is a harmonious interplay between the theoretical and the practical aspect during the implementation of the study program. Due to the nature of the study program, it is important for students to receive in a coordinated way the theoretical knowledge provided in the curricula with applied skills that are developed during professional practice.
3. Sustainability of the full-time academic staff. Effective academic staff engaged in the implementation of the study program "Professional Master in Marketing Communication" contributes and has a high level of professional preparation and expertise in the field of teaching and research in the relevant profiles.
4. Part-time staff and guest lecturers are coming from various institutions such as media, public relations and marketing, bring to the auditorium a practical and applied approach, better orienting students towards the acquisition of professional competencies.
5. Opportunities for scholarships and low tuition fees in comparison with other non-public HEIs, gives the opportunity to study in this program for various social groups.
6. Beder Information System (BIS) facilitates teaching and learning activities. This system creates opportunities to realize lectures, projects, creative activities using multimedia and applying interactivity, as a very important element to increase the perceptual and acquisition skills in students.
7. Discussions and group work during the study program that are focused on the interpretation and solution of various problems (social or community issues) where student representatives are also invited. The use of advanced teaching methods and the continuous application of information technology by both academic staff and students, inside the classrooms and outside the working class hours makes it very easy to switch from physical lectures to online ones in conditions of emergency caused by the Covid-19 pandemy. This has created the continuity of learning process in real time.
8. Close cooperation with marketing and communication agencies, media institutions and others enable students to get involved in professional life in their early days of their studies. The institution has established sustainable relationships with external actors in support of students' benefit from internships.
9. UC "Bedër" Library is a very good source of literature both classical form of a book and online sources. The agreement with one of the largest world platform "JSTOR" has increased the opportunity for students to consult contemporary literature in the relevant fields.



79

10. Professional career planning for students, which starts with their internship placement organized by the Communication Department in close cooperation with the Career Planning Office. Communication Department works closely with representatives of the Career Planning Office and that is turn in an advantage for students. Online media www.objektiv.al is another good opportunity for students to practice and have knowledge from the media market

Weak points

1. The study program literature in Albanian language (original and translated) is not sufficient. Although in some cases there are publications in the Albanian language, updating thme with the latest developments in the field, remains a concern.
2. The need to strengthen the participation in international university projects and involvement in the universities networks, while respecting the status of the University College (which is different from that as a University in regard to research and partecipation in EU projects).
3. A downwarding trend of interest from the students towards books and reading in general. Mainly influenced by technological developments and cyberspace communication, young students do not show proper interest in books and reading.
4. The frequent changes the labor market undergoes from time to time, create insecurity among young people towards the social sciences.

Recommendation

1. The need for continuing efforts of the Faculty of Humanities and Law, as well as the Department of Communication Sciences to increase the number of full-time academic staff with degrees and scientific titles (especially "Professor" and "Associate Professor"), to be involved in the study program MP "Marketing Communication".
2. Enrichment of the UC "Bedër" library collection with titles and number of copies needed for students who attend the study program MP "Marketing Communication", thus adding publications (print or digital) of recent years and by prominent authors in the field.
3. The institution should continue its efforts to attract Albanian-speaking students from areas outside Albania, to become part of the program.
4. The institution should further strengthen the mobility of students with universities abroad, as part of international projects, to overcome the impact of the COVID-19 pandemic of these past two years. The Communication Department and UC "Bedër" need to strengthen the component of participation in international projects, for scientific research as well as other EU projects. This is especially necessary in university projects and student and professors exchange.

Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Përbushen plotësisht	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X